



# INTERKULTURA

**Komunikimi interkulturore**

# 3

ARSIMI INTERKULTURORE





# INTERKULTURA

Komunikimi interkulturore

## 3

Përmbledhje punimesh nga Konferenca III Shkencore  
Ndërkombëtare për Interkulturën me temë: “Arsimi interkulturore”  
mbajtur më datën 26.10.2020 në UNT- Shkup.

Shkup, 2020

# INTERKULTURA

Komunikimi interkulturor

## 3

**Botues**  
Universiteti "Nënë Tereza" Shkup  
Aziz POLLOZHANI - rektor

**Editor**  
Mother Teresa University , Skopje  
Aziz POLLOZHANI - rector

**Redaktori përgjegjës**  
Mustafa IBRAHIMI

**Editor-in-chief**  
Mustafa IBRAHIMI

**Këshilli botues:**  
Rizvan SULEJMANI  
Sunaj RAIMI  
Agron KURTISHI  
Blerim SAITI  
Denko MALEVSKI  
Rubin ZEMON

**Editorial board:**  
Rizvan SULEJMANI  
Sunaj RAIMI  
Agron KURTISHI  
**Blerim SAITI**  
Denko MALEVSKI  
Rubin ZEMON

Botimi i kësaj reviste është mbështetur nga:



---

Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë

Shtypur në shtypshkronjën "GRAFODEN" – Shkup, 2020

Tirazhi: 300 kopj

## PËRMBAJTJA

<b>FJALA PËRSHËNDETËSE .....</b>	<b>5</b>
<b>AZIS POLLOZHANI</b>	
SISTEMI ARSIMOR FAKTOR I RËNDËSISHËM NË NDËRTIMIN E NJË SHOQËRIE INTERKULTURORE .....	5
EDUCATION SYSTEM IMPORTANT FACTOR IN BUILDING AN INTERCULTURAL SOCIETY .....	7
<b>DON LUSH GJERGJI</b>	
NËNA TEREZE - SIMBOLI I PAQES DHE DASHURISË, MISHËRIMI DHE PARADIGMA E INTERKULTURALIZMIT UNIVERSAL.....	9
МАЈКА ТЕРЕЗА – СИМБОЛ НА МИРОТ И ЛЪУБОВТА, ОТЕЛОТВОРЕНИЕТО И ПАРАДИГМАТА НА УНИВЕРЗАЛНИОТ ИНТЕРКУЛТУРАЛИЗАМ .....	9
MOTHER THERESA - THE SYMBOL OF PEACE AND LOVE, THE EMBODY AND PARADIGM OF UNIVERSAL INTERCULTURALISM .....	9
<b>RIZVAN SULEJMANI</b>	
ARSIMI INTERKULTUROR DHE KULTURA NË KOHË PANDEMIE.....	17
ИНТЕРКУЛТУРНОТО ОБРАЗОВАНИЕ И КУЛТУРАТА ВО ВРЕМЕ НА ПАНДЕМИЈА.....	17
INTERCULTURAL EDUCATION AND CULTURE IN THE TIME OF PANDEMIC.....	17
<b>MUSTAFA IBRAHIMI</b>	
REFORMAT GJUHËSORE NË ARSIMIN E SHOQËRIVE SHUMËKULTURORE - RASTI I МАQEDONISË SË VERIUT .....	29
ЈАЗИЧНИТЕ РЕФОРМИ ВО ОБРАЗОВАНИЕТО НА МУЛТИКУЛТУРНИТЕ ОПШТЕСТВА – СЛУЧАЈ СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА .....	29
LANGUAGE REFORMS IN THE EDUCATION OF MULTICULTURAL SOCIETIES - THE CASE OF NORTHE MACEDONIA .....	29
<b>RUBIN ZEMON</b>	
ИСТОРИЈАТА, АНТРОПОЛОГИЈАТА И ИНТЕРКУЛТУРНИТЕ КОМПЕТЕНЦИИ .....	43
HISTORIA, ANTHROPOLOGJIA DHE KOMPETENCAT NËRËKULTURORE .....	43
HISTORY, ANTHROPOLOGY AND INTERCULTURAL COMPETENCES.....	43
<b>AJTEN HAJDARI-QAMILI</b>	
ITERKULTURALIZMI NË INSTITUCIONET PUBLIKE NË RMV .....	55
ИНТЕРКУЛТУРАЛИЗМОТ ВО ЈАВНИТЕ ИНСТИТУЦИИ НА РСМ.....	55
INTERCULTURALISM IN PUBLIC INSTITUTIONS IN RNM .....	55

**ISMET OSMANI**

INTERKULTURALIZMI NË PROCESIN EDUKATIVO-ARSIMOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT .....	75
ИНТЕРКУЛТУРАЛИЗМОТ ВО ВОСПИТНО-ОБРАЗОВНИОТ ПРОЦЕС НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА .....	75
INTERCULTURALISM IN THE EDUCATIONAL PROCESS IN THE REPUBLIC OF NORTHE MACEDONIA.....	75

**BERTON SULEJMANI**

INTERKULTURALIZMI GJUHËSOR NËPËRMJET FRAZELOGJIZMAVE NË GJUHËN SHQIPE DHE MAQEDONASE .....	85
ЈАЗИЧНИОТ ИНТЕРКУЛТУРАЛИЗАМ НИЗ ФРАЗЕОЛОГИЗМИТЕ ВО АЛБАНСКИОТ И МАКЕДОНСКИОТ ЈАЗИК .....	85
LINGUISTIC INTERCULTURALISM THROUGH PHRASEOLOGIES IN ALBANIAN AND MACEDONIAN .....	85

**SUNAJ RAIMI**

DISA KOMPONENTË INTERKULTUROR NË FOLKLORIN E HELENËVE TË LASHTË DHE SHQIPTARËVE TË SOTSHËM .....	101
НЕКОИ УНТЕРКУЛТУРНИ КОПМОНЕНТИ ВО ФОЛКЛОРОТ НА ДРЕВНИТЕ ХЕЛЕНИ И ДЕНЕШНИТЕ АЛБАНЦИ.....	101
SOME INTERCULTURAL COMPONENTS IN THE FOLKLORE OF THE ANCIENT HELLENES AND MODERN ALBANIANS.....	101

**MIXHAIT POLLOZHANI**

ARTI SI VEPRIMTARI E KULTIVIMIT TË INTERKULTURALIZMIT .....	115
УМЕТНОСТА КАКО ДЕЈНОСТ ВО НЕГУВАЊЕТА НА ИНТЕР-КУЛТУРАЛИЗМОТ .....	115
ART AS AN ACTIVITY OF CULTIVATION OF INTERCULTURALISM.....	115

## Fjala përshëndetëse

**Azis POLLOZHANI**

### **SISTEMI ARSIMOR FAKTOR I RËNDËSISHËM NË NDËRTIMIN E NJË SHOQËRIE INTERKULTURORE**

Ndryshimet demokratike që kanë ndodhur në tri dekadat e fundit në Maqedoninë e Veriut dhe rajon, në procesin e transformimit socio-ekonomik si drejtim kanë pasur Evropën dhe vlerat që ajo ngërthen. Kontrata shoqërore e drejtuar nga principe që asociohen me ato evropiane dhe nevoja për krijimin e shtetit që mbështet diversitetin e shoqërisë ka imponuar poashtu nevojën për adaptimin dhe mishërimin e sjelljeve dhe vlerave evropiane në jetën dhe politikën e përditshme sikurse janë të drejtat e njeriut, mirëkuptimi ndërnjërëzor dhe ndërkomunitar.

Zhvillimet globale si dhe nevoja e përshtatjes së diversitetit shoqëror shpeshherë nuk përcillen me dinamikën e duhur nga politikat e shtetit dhe nga institucionet që ndryshojnë më ngadal dhe mbështeten mbi koncepte më të fiksuara të shoqërisë. Kjo mospërputhje shpesh krijon mungesë të politikave të mirëfillta që adresojnë nevojat e qytetarëve. Prandaj, është e rëndësishme që parimet si dhe shembëlltyra e shoqërisë të jetë e reflektuar nga institucionet që të avancojnë dhe të kultivojnë interkulturalizimin.

Arsimi paraqet një nga elementet kryesore që mund të përparojë mënyrën se si mendojmë dhe si e interpretojmë botën rreth nesh. Prandaj reformat në arsim si dhe zhvillimi i një sistemi arsimor që

është i përgatitur për ndryshime është shumë i rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie interkulturore.

Si nevojë themelore e arsimit është të shtrohet rëndësia e zhvillimit të kompetencave interkulturore në sistemin arsimor dhe institucional të vendit tonë jo vetëm si një nevojë për të lehtësuar hapërimin drejt kultivimit të vlerave evropiane si synim i jonë programor por edhe si nevojë e jonë për forcimin e kohezionit social dhe kapitalit social në nivel të shtetit.

Një kontribut të vetin në këtë frymë jep edhe Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup me organizimin e konferencave me temë që lidhet me interkulturalizmin. Këtë vit, për të tretën herë para nesh është konferenca mbi interkulturalizmin me temë “Arsimi interkulturor”.

Kumtesat e Konferencës dhe përmbledhjet e punimeve që do të botohen në numrin e e tretë të radhës të revistës “Interkultura”. Pjesëmarrësit ftohen për të shkëmbyer përvojat e tyre me të tjerët dhe për të prezantuar përvojat dhe njohuritë e tyre për temat të planifikuara në kuadër të Konferencës së sivjetme .

**Azis POLLOZHANI**

Rektor i UNT-së

## **EDUCATION SYSTEM IMPORTANT FACTOR IN BUILDING AN INTERCULTURAL SOCIETY**

The democratic changes that have taken place in the last three decades in North Macedonia and the region, the process of socio-economic transformation has been guided by Europe and the values it embodies. The social contract guided by principles associated with European ones and the need to create a state that supports the diversity of society has also imposed the need to adapt and embody European behaviors and values in everyday life and politics, such as human rights, interpersonal and intercommunity understanding.

Global developments and the need to adapt to social diversity are often not followed with the proper dynamics by state policies and by institutions that change slowly and rely on more fixed concepts of society. This inconsistency often creates a lack of authentic policies that address the needs of citizens. Therefore, it is important that the principles as well as the image of society to be reflected by institutions to advance and cultivate interculturalism.

Education is one of the key elements that develops in us a perspective of looking at life and helps to interpret the world around us. For this reason, reforms in education as well as the development of an educational system that is planned for changes is very significant in building an intercultural society.

The basic need of education is to raise the importance of developing intercultural competencies in educational and institutional system of our country not only as a need to facilitate the move towards the cultivation of European values, as our program goal, but also as our need to strengthen social cohesion and social capital at the state level.

“Mother Teresa” University in Skopje contributes in this aspect by organizing conferences on topics related to interculturalism. This year, for the third time, I present the conference on interculturalism with the theme “Intercultural education”.

Conference papers and summaries of papers that would be published in the third consecutive issue of the journal “Interculture”. Participants are invited to share their experiences with others and to present their experiences and knowledge on the topics planned within this year’s Conference.

Azis POLLOZHANI  
The Rector of MTU

ISSN 2671-3004

UDC 929  
Punim studimor**Don Lush GJERGJI****NËNA TEREZE - SIMBOLI I PAQES DHE DASHURISË, MISHËRIMI  
DHE PARADIGMA E INTERKULTURALIZMIT UNIVERSAL****МАЈКА ТЕРЕЗА – СИМБОЛ НА МИРОТ И ЉУБОВТА,  
ОТЕЛОТВОРЕНИЕТО И ПАРАДИГМАТА НА УНИВЕРЗАЛНИОТ  
ИНТЕРКУЛТУРАЛИЗАМ****MOTHER THERESA - THE SYMBOL OF PEACE AND LOVE, THE  
EMBODY AND PARADIGM OF UNIVERSAL INTERCULTURALISM**

Nënë Tereze Bojaxhiu e kam takuar shumë herë gjatë njohjes, shoqërimit dhe bashkëpunimit me të, në meridianët të ndryshme të botës, që nga takimi im i parë personal në Romë më 29 mars 1969. Unë atëherë isha student i vitit të dytë të filozofisë në Universitetin "Urabanian". Atë e kam shoqëruar në pesë vizitat e saja në Kosovë dhe në Maqedoninë Veriore, 1970, 1978, 1980, 1982, 1986; isha me të gjatë Shpërblimit Nobel për Paqe, në Oslo, (10 dhjetor 1979); në shumë vende të Evropës Lindore; sidomos në Kalkutë dhe në rrethinë (1989)...

Çdo takim ishte si i pari dhe i fundit, që më bënte përshtypje thjeshtësia, çiltëria, mirësia, bujaria, duresa, shenjtëria, kujdesi dhe dashuria për të varfër ndër më të varfër, të gërbulur, ata që askush nuk i donte, sidomos kujdesi, vëmendja, shërbimi dhe dashuri shembullore për çdo njeri, aftësia e saj për të vuajtur dhe vepruar për kthimin e dinjitetit dhe personalitetit bazik të çdo njeriu, veçmas të atyre në buzë të vdekjes, për të gërbulur dhe të përjashtuar, për mbarë njerëzimin.

Gjithnjë kam studiuar dhe hulumtuar për rrënjët, burimin, zanafillën e këtij përkushtime dhe dashurie kaq prekëse dhe tërheqëse për mbarë botën. Përfundimi im është ky: janë dy burime unike që e kanë përgatitur dhe dhuruar atë gjithë botës:

- tradita dhe përvoja kombëtare ilire, arbërore dhe shqiptare dhe familjare, që mbështetet në këto parime të shenjta dhe domethënëse: “Bukë, krip dhe zemër”, dhe: “Shtëpia është e Zotit dhe mysafirit”; “S’ka shtëpi pa pleq dhe pa fëmijë”

- si dhe përvoja dhe jeta e dashurisë së krishterë në familje dhe në bashkësi famullitare, porosia e Jezusit i cili identifikohet me çdo njeri: “Çka do bëtë për njërin ndër këta vëllezër të mi më të vegjlit, e bëtë për mua” (Mt 25, 40).

- Ajo ishte Dashuria në veprim, siç e kam definuar unë. Me 17 libra kushtuar Nënës Tereze, të përkthyer në shumë gjuhë botërore, jam munduar t’i dokumentoj dhe argumentoj këto dy burime të pashtershme për Nënë Tereze: Zotin - Dashuri dhe Vëllaun apo Motrën Njeri.

Nëna Tereze është paradigmë e interkulturalizmit, shkëmbimit dhe pasurisë gjithnjëzore, sepse ajo na ka mësuar dhe dhuruar tri shkallë themelore të lidhjeve dhe marrëdhënieve ndërnjëzore, si parakusht thelbësor për takim, bisedim, dialog, komunikim dhe bashkim.

1. Për Nënë Tereze, çdo njeri është para së gjithave Njeri, si unë dhe si ti, pra, me dinjitet dhe personalitet që duhet ta çmojmë, nderojmë, pranojmë, pa asnjë përjashtim etnik, gjuhësor, gjinor, kastor, fetar, ashtu si është, në kërkim të mirës, vërtetës, jetës, mirësisë dhe dashurisë universale.

2. Hapi i dytë i Nënës Tereze është edhe më cilësor dhe përmbajtësor: çdo njeri është Vëllai apo Motra ime, sipas mësimin dhe frymëzimit të krishterë. Feja matet nëpërmjet dashurisë, dhe dashuria për Zotin kalon nëpër “shkallët” e dashurisë për kryeveprën e tij, njeriun. Nëse Zoti është Krijuesi dhe Shpëtimtari i çdo njeriu, pra, i njerëzimit, atëherë ne duhet ta shohim, njohim, duam dhe shërbejmë çdo njeri – si vetë Zotin.

3. Kjo bindje, përcaktim dhe orientim i Nënës Tereze, sjell të shkalla e tretë: çdo njeri nuk është vetëm njeri, Vëlla apo Motër, por vetë Jezu Krishti, dhe çka do që bëjmë, ana pozitive, apo nuk bëjmë, ana negative, për Njeriun, bëjmë apo nuk bëjmë, për vetë Zotin. Ky është vlerësimi i Zotit për jetën dhe veprimtarinë tonë, tani dhe në amshim. Masa e Zotit është vetëm një – dashuria, si dhe gjuha e Zotit,

është po ashtu një - ajo e dashurisë. Jemi të lumtur vetëm kur jetojmë në dashuri – marrim dhe japim dashuri njëri – tjetrit.

Prandaj, Dashuria është sinonim i Zotit, do të duhej të ishte edhe i Njeriut.

Këto pesë shkallë, të mbështetura në takim, bisedim, dialog, komunikim dhe bashkim në dallime, kanë krijuar dy shtyllat bazike të jetës dhe veprës së Nënës Tereze: kulturën e jetës dhe qytetërimin e dashurisë. Pa këtë dy elemente thelbore, nuk ka interkulturim, integrim, harmoni mes njerëzve, etnive, feve, botëkuptimeve të ndryshme, në krijimin e asaj që është detyra dhe mundësi për të gjithë: bashkimi në dallime. Ose do ta synojmë dhe krijojmë këtë, ose do të rrëshqasim në skajshmëri të ndryshme, gjithmonë në dëm tonë dhe të tjerëve.

Pa takime, bisedime, dialogje, komunikime dhe bashkime në dallime, mendjen tonë e ngarkojnë dhe robërojnë paragjykimet, vlerësimet intuitive, tashethënat, përgojimet, ngurrtesia e mendjes dhe akulli i zemrës, kështu që jetojmë pa ndonjë shije dhe kuptim, domethënie, kënaqësi, lumturi, mbi të gjitha pa dashuri.

Bota e sotme nuk është e lirë nga robëritë e ndryshme, dhe si e tillë, as e mirë, sepse mungon hapësira e jetës së përbashkët, njerëzimi në kohën tonë është i robëruar nga pesë “diktatorë” të pavetëdijëshëm, që janë: materializmi, konsumizmi, hedonizmi, relativizmi dhe ateizmi praktik, që rrënojnë vlerat dhe virtytet njerëzore, morale dhe fetare, me këtë vetë njeriun, duke ia marrë “frymën” e shpirtit, qenësoren, thelbësore, kryesoren, të Vërtetën dhe Dashurinë.

Nëna Terze me jetën dhe veprimtarinë e saj të bujshme, ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillimin dhe përmbajtjen e interkulturit universal, duke u bërë dhe mbetur rrugë, frymëzim, paradigmë e një botës së re, më njerëzore, ku ka vend, hapësirë, mbi të gjitha kujdes dhe dashuri për të gjithë.

Ja pesë pikat dhe risitë kryesore të jetës dhe veprimtarisë së Nënës Tereze për ne dhe për mbarë njeëzimin.

## **1. Feja - kërkim, shpresa - veprim dhe dashuria – flijim dhe dhurim**

Ndër risitë më të rëndësishme që kam hetuar unë janë këto: feja - që për Nënë Tereze ishte kërkim i Zotit në Njeriun dhe i Njeriut në Zotin, në çdo fazë të jetës së saj dhe për çdo njeri pa dallime dhe përjashtime. E kishte kërkuar Zotin dhe thirrjen, planin e tij prej

moshës 12 deri 18 vjeçare, kur kishte vendosur plotësisht t'i kushtohet atij: "Dua të bëhem motër misionare për t'i ndihmuar të varfrit e botës" (Letnicë, 14 gusht 1928). Gjatë 18 viteve si "Motër e Loretos", dhe së fundi prej vitit 1950 e deri te kalimi në amshim, 5 shtator 1997. Kurrë nuk e ka ndarë Zotin prej Njeriut dhe Njeriun prej Zotit dhe mu për këtë jetonte me Zotin dhe për Zotin, me Njeriun dhe për Njeriun.

Shpresa – veprim, gjithnjë dhe kudo, me dashuri dhe për dashuri, me parimin: "Kudo që jeta është në rrezik, aty duhet të jemi ne."

Dashuria – flijim dhe dhurim pa kursim për t'u bërë dhe mbetur Nëna e Dashurisë, sipas tri parime të shenjta: "Pa dashuri dhe flijim, jeta s'ka kuptim." "Vetëm dashuria do ta shpëtojë botën." "Veprat e dashurisë janë vepra të paqes."

## **2. Nëna universale – universalizmi i jetës dhe dashurisë**

Misioni i Nënës Tereze është Dashuria, vend-veprimi është bota, mbarë njerëzimi, metodologjia është dëshmia e krishterë, qëllimi është lehtësimi dhe pakësimi i vuajtjeve, mënyra është pjesëmarrja e plotë dhe e lirë në jetën e tyre, të privilegjuar janë të braktisurit dhe të dëbuarit e botës.

Risia e dytë e Nënës Tereze ishte UNIVERSALIZMI në çdo kuptim dhe drejtim kohor dhe hapësinor në dy parime themelore: Për Zotin – Dashuri dhe Njeriun – Vëlla apo Motër, pra, i jetës dhe dashurisë. Askush në historinë e njerëzimit, as në atë të krishterimit, nuk kishte nisur dhe zbatuar një vepër të tillë pa kurrfarë përjashtimi kombëtar, fetar, gjinor, kastor, shoqëror, dhe vetëm ajo kishte arritur që t'i bashkonte të gjithë, hinduistët, budistët, myslimanët, të krishterët, ateistët, agnostikët, me fuqinë e fesë dhe frymëzimin e dashurisë. Ajo nuk kishte për qëllim kthimin e të tjerëve në fenë e krishterë, në Kishën Katolike, por "që të jetë në mesin e tyre rrezja e Pranisë dhe e Dashurisë së Zotit, që t'ua dhurojnë të gjithëve Zotin – Dashuri – Atë."

Qëllimi i saj, pra, ishte diçka tjetër, dashuria dhe prania e Zotit në botën e sotme, sidomos ndër të varfrit më të varfër, të braktisur, të gërbulur, njerëz të përbuzur dhe të përjashtuar nga jeta e rëndomtë, për të drejtën më madhe dhe shenjta: për lumturi dhe dashuri.

Kjo nevojë, e drejtë, mundësi, detyrë, synim, qëllim, sot shkelet anekënd botës me shumë mënyra dhe mekanizma, duke mos e

kuptuar dhe pranuar se dallimet janë begati, pasuri, përplotësim, mundësi pozitive dhe konstruktive për të gjithë.

### 3. Vuajtja – bekim e jo mallkim

Risia e tretë e Nënës Tereze është kjo: vuajtja, pësimi, mjerimi, varfëria, gërbula, Sida, si dhe çdo pësim tjetër, nuk është mallkim, dënim i Zotit, por hir, mundësi për ta treguar dashurinë ndaj Jezusit që vuan në njerëz të tillë. Ajo thoshte kështu: "Të varfrit na japin ne shumë më tepër, na dhurojnë mundësinë që konkretisht ta duam dhe ta shërbejmë Jezusin i cili pëson në ta. Ata na japin falënderimin... Paqja do të vijë në botë nëpërmjet të varfërve. Të varfrit janë të detyruar të jenë të tillë, ndërsa ne jemi të varfra për dashuri ndaj Jezu Krishtit dhe për t'i kuptuar deri në fund ata që nuk kanë asgjë duke jetuar si ata dhe me ata... Jepni duart tuaja për shërbim të varfërve, zemrën tuaj për t'i dashur të varfrit. Dashuria e vërtetë është gjithmonë flijim dhe dhurim. Kur nuk kam asgjë, atëherë jap gjithçka, sepse dhuroj vetveten"

### 4. Dhurim falas dhe në tërësi

Risia e katërt e Nënës Tereze është dhurimi falas dhe në tërësi, me dashuri dhe për dashuri, me hare dhe falënderim. Ajo shpeshherë thoshte kështu: "Nëse nuk mund të bësh asgjë për të tjerët, atëherë së paku buzëqeshu, sepse kjo nuk të kushton asgjë, por jep shumë. Gëzimi duhet të jetë një ndër thesaret e jetës sonë... Kështu më thoshte Nëna Loke: "Gonxhe Gjyli, bija ime, ose bëre këtë punë me zemër, ose mos e bën aspak!".

Dhe vazhdon kështu: "Unë ju kam thënë motrave përgjegjëse për bashkësitë tona: Bota është plot mjerime, vuajtje, pikëllime. Ne duhet të dalim në botë për ta pakësuar vuajtjen, për të qenë rrezja e Dashurisë së Zotit... Jepe pjesën më të mirë të vetvetes, zemrën, dashurinë..."

Dhe ja, prapë mrekullia e dashurisë dhe e shenjtërisë: Më e varfra e botës, Nëna Tereze, më së shumti i ka ndihmuar të varfrit e botës, jo vetëm në anën materiale, por edhe më tepër në atë shpirtërore, sepse është dhuruar falas dhe tërësisht, me gëzim dhe me dashuri të plotë Zotit nëpërmes njeriut.

## 5. Kontemplative - aktive në botë

Risia e pestë e Misionareve të Dashurisë është kjo: të jenë kontemplative aktive në botë. Kjo do të thotë të jenë tërësisht të kushtuara Zotit në lutje, meditim, adhurim, pendesë, dhe si pasojë e kësaj jete shpirtërore, të jenë edhe aktive në botë me dashuri vepruese.

Kontemplative- aktive domethënë ta kërkojmë, gjejmë, shërbejmë Zotin jo vetëm në çaste të kushtuara atij, në jetën tonë shpirtërore, por gjithkund dhe gjithnjë, pikërisht me fuqinë e fesë dhe me frymëzimin e dashurisë.

Nëna Tereze thoshte: "Nëse e njohim, duam, adhurojmë, ushqehemi me Jezu Krishtin vetëm në meshë, në Kungim, është tepër pak. Ne lutemi, meditojmë, adhurojmë, marrim pjesë në meshë, e marrim Jezusin në Kungim në zemër për ta vazhduar këtë kërkim dhe shoqërim me të në përditëshmëri. Nëse e gjejmë dhe shërbejmë Jezusin në të varfërit tanë, atëherë jemi kontemplative në mesin e botës.. Prej Jezusit në Eukaristi, kalojmë në Jezusin Vëlla apo Motër – Njeri..."

Ndërsa bashkësitë tjera rregulltare ndahen në dy kategori, aktive apo vepruese në botë, nëpër famulli, shkolla, spitale, institucione të ndryshme, dhe kontemplative, të mbyllur dhe të kushtuar tërësisht vetëm jetës shpirtërore, Nëna Tereze ka gjetur modelin e ri që këto dy lloje jete dhe kushtimi të bashkohen në një me harmoni dhe veprimtari mahnitëse.

Për këtë Nëna jonë Tereze ishte dhe gjatë do të mbesë "Ungjilli i gjallë", risia ungjillore dhe "Misionarja e Dashurisë", Nëna e botës së mjerimit, tash Shenjtëresha e Dashurisë.

Ajo bindshëm ka dëshmuar që krijimi i njeriut, familjes, shoqërisë së re, është i mundshëm dhe ka dy shtylla, binare, orientime: Zotin dhe Njeriun, kurse mënyra e realizimit është prapë e dyfishtë: feja dhe dashuria.

Të besosh në Zotin, e mos të besosh në njeriun, është utopi, vetëmashtrim, tradhti, si dhe ta duash Zotin, e mos ta duash Njeriun, është lëshim gabim, mëkat.

Me Zotin Dashuri dhe Vëllain apo Motrën Njeri – çdo gjë është ndryshe, më e mirë, më njerëzore, më e bukur, burim lumturie dhe frymëzim dashurie.

---

Veprat e Don Lush Gjergji-t kushtuar Nënës Tereze:

- Nëna jonë Tereze, shqip, 1980; 1990; kroatisht, 1982; 1990; sllovenisht , 1983; italisht, 1983; 1985, 1988; frëngjisht, 1985; spanjollisht, 1988, 2016; hungarisht, 1990; anglisht, 1992.
- Lule për Nënën, shqip, 1986; italisht, 1987.
- Dashuria në vepër: Nëna Tereze, shqip, 1992; kroatisht, 1995.
- Gonxhja jonë – Nëna e botës, 1998.
- Madre della carità, italisht, 1990, ribotohet për çdo vit; anglisht, 1991; 2010; frëngjisht, 1993; spanjollisht, 1993, 2010; polakisht, 1994; gjermanisht, 1995; shqip, 2000; 2010; kroatisht, 2007; sllovenisht 2009.
- Gonxhe Bojaxhiu – Nënë Tereza, Poezi dhe Uratë, zgjedhi: Dr. don Lush Gjergji, 1998; 2000.
- Vivere, amare, testimoniare, La spiritualità di Madre Teresa, dy vëllime, italisht, 1995, ribotohet për çdo vit; anglisht, 1998; polakisht, 199; shqip, 2016.
- Živjeti s Kristom, kroatisht, 1997.
- Ljubiti s Marijom, kroatisht, 1997.
- Svjedočiti s Crkvom, kroatisht, 1998.
- Zraka Božje Ljubavi, kroatisht, 1998.
- Madre Teresa, L'amore in azione, italisht, 2002; 2003, 2007; 2009; polakisht, 2002; 2003; litvuanisht, 2003; anglisht 2008; 2010.
- Bog ljubi danas preko nas, kroatisht, 2003, sllovenisht, 2009.
- Nëna Tereze, dashuria në veprim, 2010; anglisht, 2010; italisht, 2010; polakisht, 2010.
- Nëna Tereze, Shenjtëresha e Dashurisë, shqip, 2010; italisht, 2010; anglisht, 2010; polakisht, 2010; rumanisht, 2010.
- Shenjtëresha e Dashurisë. Prej Shën Palit te Shën Nëna Tereze, italisht, shqip, kroatisht, 2017.
- E kam në zemër popullim tem Shqiptar, 2019.



ISSN 2671-3004

UDC 37.017:316.723-021.463:[616-036.21  
Punim studimor

**Rizvan SULEJMANI**

**Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup**

**rizvan.sulejmani@unt.edu.mk**

**ARSIMI INTERKULTUROR DHE KULTURA NË KOHË PANDEMIE**

**ИНТЕРКУЛТУРНОТО ОБРАЗОВАНИЕ И КУЛТУРАТА ВО ВРЕМЕ  
НА ПАНДЕМИЈА**

**INTERCULTURAL EDUCATION AND CULTURE IN THE TIME  
OF PANDEMIC**


Hyrje

Njerëzimi ballafaqohet me rrezikun më të madhe nga lufta e Dytë botërore. Janë “sulmuar” nga një armik i panjohur, por pasojat pritet të jenë të një lufte serioze botërore. Këto parashikime për momentin janë në nivel spekulativ, për faktin se pandemia vazhdon, nuk ka një kohë të saktë kur mund të mbarojë ato edhe mund të tejkalojnë çdo paralajmërim. Për momentin gjitha forcat janë orientuar në evitimin e dëmeve në viktima njerëz dhe ekonominë dhe aty këtu mund të lexohet ndonjë vlerësim për pasojat psikologjike, gjeopolitike e posaçërisht në arsim. Termin “bota është sulmuar” e nxjerrim nga të dhënat që jep Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), për shpërndarjen e pandemisë nëpër shtete. “Bota” duke mos qenë e përgatitur për një “sulm” të tillë, ajo nuk kishte as përgjigje nga sulmohet dhe si të përballet apo mbrohet nga ky sulm. Në mungesë të një përgjigje kredibile për natyrën e virusit

politika si më përgjegjëse për mbrojtjen e sigurinë e popullatës gjithë barrën ia barti shkencës, më saktë mjekësisë. Për një moment njerëzit me mantele të bardhë u popullarizuan bile edhe ministra e burrështetas u ngritën në pedestalin e popullaritetit. Por shkenca as kishte përgjigje as kishte armë efikase, vaksinë për të shpëtuar të sëmurit andej shpejt do të kompromitohet që do të krijoj hapësirë për spekulime dhe teori konspirative. Kuptohet, këto të fundit janë karakteristike e politikës kur fenomenet janë të komplikuar dhe shumë vështirë shpjegohen para popullatës. Politikanët preferojnë paraqitje publike bardh e zi, gjegjësisht, nga injorimi total me deklarime se kjo nuk paraqet kurrfarë rreziku deri te akuzimi i shteteve rivale. Në këtë luftë propagandistike u kyçën dy fuqitë kryesore botërore SHBA-ja dhe Kina e para e akuzonte Kinën për mos-sinqeritet dhe fshehje të të dhënave kurse kjo e dyta SHBA-t se ata e kanë bartur atë në Vuan, qytet kinez ku për së pari herë u shënuar ky virus.

**Vdekjet ekesuale gjatë COVID -19: Numri i të vdekurve nga gjitha shkaqet, krahasuar me vitet paraprake nga gjitha gjeneratat.**

Grafiku paraqet numrin e të vdekurve në javë në vitin 2020 (si përqindje) nga mesatarja e vdekjeve në të njëjtën javë gjatë viteve paraprake (2015-2019). Kjo paraqet P-raportin, që duhet cekur se është e mundur të ketë devijime për shkak të vonesave në raportim.




Graf 1. Rritja e vdekjeve nga të gjitha shkaqet krahasuar me vitet paraprake<sup>1</sup>

Vetë kryetari Donald Tramp demonstronte guximin se korona nuk është aq e rrezikshme sa e paraqesin propaganduesit e atyre që duan ta dobësojnë ekonominë amerikane andej edhe refuzonte të paraqitje në publik me maskë që rekomandohej nga ekspertët e lëmis, dhe veçanërisht mbylljen si masë preventive kundër përhapjes pasi ajo e dëmtonte ekonominë. Por situata dhe numrat flasin diçka tjetër. Grafiku nr.1 flet për rritje drastike të vdekjeve për muaj krahasuar në vitin paraprak. Kështu në Spanje në kulmin e

<sup>1</sup> Burimi: <https://ourworldindata.org/coronavirus#which-countries-are-making-progress-against-the-pandemic>

pandemisë diku në prill të vitit 2020 numri i të vdekurit nga gjitha shkaqet ishte afro 140% më i lartë se vitin paraprak kurse në Angli dhe Vels rritja e vdekshmërisë ishte mbi 110%. Këto të dhëna dhe prekja e disa figurave kyçe nga ky virus si vet kryeministri britanik ai kanadez dhe së fundi edhe presidenti Tramp, tregoj se nga kjo sëmundje nuk kurseheshin as më të fuqishmit e as më të



pushtetshmit. Se sëmundja nuk njihet nga grafiku nr.2 e përpiluar nga OBSH-ja e cila shpalos të dhënat në kohë reale për disa shtete. Nga grafiku lehtë mund të nxirret konstatimi se sëmurja ka kapluar gjitha kontinentet kuptohet shtete dhe kontinente të caktuara më pakë apo më shumë.

Grafiku. 2 Paraqitja grafike e rasteve të konfirmuara me COVID 19 brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes nëpër shtete të ndryshme të botës<sup>2</sup>













Nëse analizohet pik së pari mund të identifikohen disa të dhëna: Pik së pari shtet e paraqitura në grafik pothuajse janë nga gjitha kontinentet me përjashtime të vogla, që na bën të konstatojmë se kjo është një “luftë” globale, dy, se shikuar sipas nivelit të zhvillimit ajo nuk i ka kursyer edhe shtetet më të zhvilluara si SHBA-ja, Britania, Gjermani por edhe Indinë, Meksikon, Afrikën e Jugut deri tek Zelanda e Re e Kongo. Për më tepër në nivel të njëjtë shihet të jetë numri i të infektuarve si India një shtet në zhvillim dhe Amerika një nga shtet më të zhvilluara në botë. Shikuar nga ky grafik lihet përshtypja se virusi nuk është “diskriminues”, që do të thotë se i godet vetëm

<sup>2</sup> Burimi:

[file:///C:/Users/Rizvan%20Sulejmani/Desktop/Konferenca%20e%20III%20Interkulturore%202020/Coronavirus%20Pandemic%20\(COVID-19\)%20-%20Statistics%20and%20Research%20-%20Our%20World%20in%20Data.html](file:///C:/Users/Rizvan%20Sulejmani/Desktop/Konferenca%20e%20III%20Interkulturore%202020/Coronavirus%20Pandemic%20(COVID-19)%20-%20Statistics%20and%20Research%20-%20Our%20World%20in%20Data.html)

shtetet e varfra. Por megjithatë një konstatim i tillë nuk është gjithaq i qëndrueshëm nëse analizojmë të dhënat nga studimet e ndryshme brenda Shteteve të Bashkuara të Amerikës por edhe brenda Britanisë nga disponojmë me më tepër të dhëna.

Në tabelën Nr. 1 janë të dhënat raporti i të infektuarve sipas racës në Shtete e Bashkuara të Amerikës varësisht nga mënyra se si janë infektuar pacientët që kanë qenë çështje e studimit. Nga tabela shihet se raporti i të infektuarve, të hospitalizuarve dhe të vdekurve ka variacioni varësisht nga grupi racor, etnik apo kulturorë. Diku 5.3 më i lartë është numri i të infektuarve nga ndenja në grupe i Indian amerikanëve apo nga Alaska, gjegjësisht persona joespanik në raport me amerikanët e bardhë.

RASTET E KORONA VIRUSIT-SHKALLA E INFECTIMIT DHE VDEKJEVE NË BAZA RACORE								
Shkaqet që ndikojnë në përhapjen në komunitet dhe ndër individët		Ndenja në grupe		Kontaktet të afërta fizike		Hapsira të mbyllura		Koha e ekspozimit
Raporti i rasteve krahasuar me të bardhit, njerëzit jo espanik		Indian amerikan apo vendas nga Alasaka, persona jo-espanik		Azijatik, njerëz jo-espanik		Të zi, apo Afro-amerikan, jo-espanik		Espanik apo persona Latino
Numri i rasteve		2.8x më i lartë		1.1X më i lartë		2.6X më i lartë		2.8X më i lartë
Të hospitalizuar		5.3X më i lartë		1.3X më i lartë		4.7X më i lartë		4.6x më i lartë
Të vdekur		1.4X më i lartë		Nuk ka ndryshim		2.1X më i lartë		1.1X më i lartë
Veprimet për të zvogëluar numrin e rasteve		Mbajtja e maskave		Rruajtja e distancës		Larja e duarve		Dezinfektimi
<b>Burimi:</b> <a href="https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/covid-data/investigations-discovery/hospitalization-death-by-race-ethnicity.html">https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/covid-data/investigations-discovery/hospitalization-death-by-race-ethnicity.html</a>								

Tabela<sup>3</sup>: 1Rastet e Korona Virusit-Shkalla e infektimit dhe vdekja sipas racave

Dallime serioze ka në mes të afro-amerikanëve, apo njerëzit e zi prej jo-espanikëve, Deri më 4.7 herë është më i madh numri i të hospitalizuarve afro-amerikan nga jo-espanikët. Këto të dhëna janë tregues se kjo epidemi nxori në sipërfaqe një hartë të re të Amerikës sa i përket pozitës në shoqëri të grupeve të caktuara racore dhe sociale. Kjo për rastin tonë ka rëndësi për tu vetdisuar se adresimi i çështjeve ndërretnike, ndërkulturore dhe të dallimeve klasore duhet marrë në konsideratë kur duet studiuar ky fenomen pa marrë parasysh se çka është temë boshe një studimi. Nëse i kemi këto parasysh në fillim të shohim se si ndikojnë masat e mara për


<sup>3</sup> <https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/covid-data/investigations-discovery/hospitalization-death-by-race-ethnicity.html>

parandalimin e përhapjes së CORONA 19, veçanërisht mbyllja e shkollave apo edhe universiteteve.

Zhvillimi i mësimin në kohën e krizës së pandemisë, alternativat

Duke marrë parasysh rekomandimet nga institucionet shëndetësore se mënyra më e mirë për parandalimin e përhapjes së virusit CORONA 19, janë mbajtja e maskave, ruajtja e distancës, larja e duarve dhe dezinfektimi (shih tabelën 1.), nga shumë shtete përfshi edhe vendin tonë, Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim zbatimin më efikas të këtyre masave u morën më tepër masa. Gjegjësisht, institucionet arsimore aprovuan forma të ndryshme alternative për zhvillimin e procesit arsimor. Ndër format më të përhapura në RMV ishin mësimi online dhe transmetim në TV. Por të dhënat nga Banka Botërore dhe Qendra për Zhvillim Global janë analizuar format e ndryshme të mbajtjes së mësimin nëpër botë varësisht prej nivelit të të ardhura në shtete dhe pozitës gjeografike apo të grup-shteteve në botë.

**Paraqitja grafike alternativave si i përgjigjen shtetet mbylljes së shkollave me format e ndryshme të mësimin në distancë, sipas nivelit të të ardhurave**



Burimi: Qendra për Zhvillim Global dhe Banka Botërore

Graf. 3<sup>4</sup>. Paraqitja grafike alternativave si i përgjigjen shtetet mbylljes së shkollave me format e ndryshme të mësimin në distancë, sipas nivelit të të ardhurave


Në grafikun nr.3 janë dhënë format e vijimit të mësimin në shtete e ndryshme të botës varësisht nga të hyrat për kokë banori edhe atë, online, TV ose radio, vetëm TV, vetëm radio, online dhe përmes

<sup>4</sup> <https://www.brookings.edu/research/school-closures-government-responses-and-learning-inequality-around-the-world-during-covid-19/>

transmetim TV/ose radio. Shtet janë ranguar si shtete më hyra të ulëta, të ulëta të mesme, të mesme të larta dhe të larta. Grafiku qartë nxjerr në pah se shtet më të zhvilluar mbi 65% kanë aprovuar mësim online, dhe online me transmetim në TV apo radio, dhe mësimi është zhvilluar me mbi 85% në total. Kurse shtet me të hyra më të ultë kanë mbajtur mësim në onlin dhe TV, vetëm TV apo të kombinuar por që në total pak kanë tejkaluar 20%. Gjegjësisht në këto vende mësimi është mbajtur shumë pak. Kurse shtet me të hyra të mesme kanë zhvilluar mësim online apo online përmes transmetimit në TV por që ata që kategorizohen si shtete me të hyra të ulëta mesatare në mësim janë përfshi diku 65% të nxënësve kurse shtetet që kategorizohen si shtete me zhvillim të mesëm të lartë kanë realizuar mësim me diku mbi 70%.

Grafiku në vazhdim tregon se cilat regjione botërore çfarë forme është realizuar dhe zhvilluar mësimi. Nga grafiku shihet se nivel më të ulët shprehur në përqindje të zhvillimit të mësimi ka pasur në shtete e Sub-Saharës me vetëm diku 30%, kurse më të lartë me afro 90% mësimi është zhvilluar në Lindje të Mesme&Afrikën Veriore dhe në Azinë Jugore. Në Evropë& Azia Qendrore në mësim janë përfshi diku 80% të nxënësve në një nga format alternative.

**Paraqitja e shteteve si i përgjigjen mbylljes së shkollave me format e ndryshme të mësimi në distancë, sipas regjioneve**



Burimi: Qendra për Zhvillim Global dhe Banka Botërore

Graf. 4<sup>5</sup>. Paraqitja e shteteve si i përgjigjen mbylljes së shkollave me format e ndryshme të mësimin në distancë, sipas regjioneve.

Këto të dhëna dhe varshmëria e zhvillimit ekonomik të shtetit por edhe kulturave do të na shërbejnë për ti pasur në konsideratë kur në vazhdim do të japim përlogaritjet nga dëmet, humbjet që kanë pësuar nxënësit që nuk kanë vijuar mësimin në periudhë 3-7 muaj, të bëra nga Banka Botërore përmes një metodologjie që ata kanë zhvilluar. Pastaj këto të dhëna do të mundohemi të vejmë në korrelacion me situatën në Republikën e Maqedonisë së veriut si shtet multietnik dhe me dallime të mëdha sa i përket të hyrave për kokë banori varësisht prej regjioneve dhe përkatësisë etnike.

Përlogaritjet për humbjet individuale dhe globale për nxënësit e gjeneratës së CORONA 19 dhe botën në tërësi.

Nga studimi i bërë prej .... si konstatim i përgjithshëm është se kur fëmijët humbin arsimin, ata humbin mundësitë në të ardhmen, përfshirë përfitimet ekonomike, siç janë fitimet shtesë, me pasoja të mëdha. Sipas ekspertëve të kësaj lëmie disa modelime sugjerojnë që humbja e të mësuarit gjatë krizës së jashtëzakonshme sistemore të Luftës së Dytë Botërore kishte ndikim negativ në jetën e ish-studentëve edhe rreth 40 vjet më vonë<sup>6</sup>. Për më tepër ndikimi i mësimin të humbur nuk është i kufizuar vetëm në nivelin individual, nga nxirët konstatime se shoqëri të tëra që sot mbyllin arsimin, ka të ngjarë të ketë pasoja të rëndësishme nesër.

Për të demonstruar humbjet e mundshme ekspertët ngritën një metodologji duke u nisur nga supozimi se çdo vit shtesë i shkollimit është e barabartë me 10% të fitimeve shtesë në të ardhmen. Më pastaj duke përdorur numrin e muajve të mbylljes së arsimit kanë përlogaritur fitimet marginale në të ardhmen për një nxënës apo student. Për shembull, nëse Shteti X mbyll shkollat dhe universitetet e tij për katër muaj, humbja në fitimet marginale në të ardhmen do të ishte 2.5% në vit gjatë jetës së punës së një studenti. Nëse këtë supozim e zbatojmë në ekonominë më të madhe në botë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku ka 76 milion studentë, ata modelojnë një jetë pune 45-vjeçare, me një normë zbritje prej 3% duke marrë për bazë fitimet mesatare vjetore në këtë shtet prej 53,490 \$.

---

<sup>5</sup> <https://www.brookings.edu/research/school-closures-government-responses-and-learning-inequality-around-the-world-during-covid-19/>

<sup>6</sup> Andrea Ichino, European University Institute, Rudolf Winter-Ebmer, "The Long-Run Educational Cost of World War II", Burimi: <https://uh.edu/~adkugler/Ichino%26Winter-Ebmer.pdf> and WIFO

Ky vlerësim i aproksimativ sugjeron humbje në fitim prej 1,337 \$ në vit për student: një humbje e vlerës aktuale të fitimeve prej 33,464 \$ (63% e pagës së një viti me normat aktuale të pagave mesatare). Nëse kjo nuk paraqet ndonjë shqetësim krahasuar me çmimin që duhet paguar në luftën kundër COVID-19, një vështrim mbi ndikimin në të gjithë vendin është shumë më i kthjellët.

Në bazë të këtij modeli, kostoja për Shtetet e Bashkuara në fitimet e ardhshme për shkak të humbjes katër muaj arsim është 2.5 trilion dollarë, apo - 12.7% e PBB-së vjetore. Eksplorimi në nivelin global, nëse kemi parasysh se ekonomia amerikane përfaqëson rreth një të katërtën e prodhimit global, të dhënat sugjerojnë që bota mund të humbasë deri në 10 trilion dollarë gjatë gjeneratës së ardhshme si rezultat i mbylljes së shkollave sot<sup>7</sup>.

Këto të dhëna janë një alarm për të bërë një studim edhe për rrethanat tona duke marrë për bazë përbërjen etnike, nivelin e zhvillimit ekonomik dhe disa parametra socio-ekonomik nëpër regjione por edhe mbi baza etnike, si dhe diversitetin kulturor.

### **Gjendja e arsimit në RMV, gjatë CORONA 19, pasojat e mundshme**

Një studim i bërë nga profesor dhe student të Universitetit Nëna Tereza në Shkup me student e tre universiteteve që ligjërohet në gjuhën shqipe Universiteti Fadil Sulejmani, Universiteti i Evropës-Juglindore dhe Nënta Tereza nxori në pah të dhëna interesante sa i përket strukturës sociale nga rekrutohen studentët në këto universitet. Studimi e bëri të qartë se studentët e këtyre universitete, pjesa dërmuese e tyre, me diku 70% janë student të gjeneratës së parë në familje, ngase prindërit e tyre janë me përgatitje shkollore fillore apo të mesme. (Shih Tab. 2). Mbi 85% prej tyre ose ende jetojnë në fshat ose i ardhur në qytet. Të hyrat për kokë të anëtarit të familjes flasin se ata kryesisht janë me të hyra shumë ulëta mujore dhe vetëm një përqindje e vogël mund të llogaritet se i takojnë ndonjë klase të mesme të lartë me mbi 350 euro për anëtarë familje në muaj.

#### **Disa të dhëna mbi statusin social të studentëve të anketuar**

Të hyrat për kokë anëtarit të familjes shprehur në €	50-100 € 17.3%	100-200€ 17.3%	200- 350 € 45.1%	Mbi 350 € 20.4%
Vendbanimi:	Në fshat: 46.8%	I ardhur në qytet: 40.5%	Në para-lagje: 8.6%	Në qytet: 5%
Niveli i arsimit i prindërve:	Arsim fillor: 19.9%	Të mesëm: 50.2%	Të lartë- fakultet 29.9%	
Statusi i besimit fetar:	Besimtarë i devotshëm: 57.9%	Besimtar tradicional: 15.4%	Besimtar që nuk praktikoj ritet rregullisht: 23.7%	Tjetër: 3.4%

Tab. 2<sup>8</sup>. Statusi social i studentëve që studijojnë në UT, UEJL, UNT

Këto të dhëna mund të na nxjerrin konstatimin për parakushtet që mësimi në këto familje të mund të zhvillohet online, nën supozimin se vetëm dy anëtarë të familjes të duhet të zhvillojnë mësim në të njëjtën kohë që nënkupton të kenë dy kompjuterë dhe dy dhoma me kushte minimal për mësim (ndemje dhe të izoluar prej pjesës tjetër të familjes). Mund vetëm të supozohet se sa janë mundësitë që një mësim i tillë të zhvillohet në një familje ku ka tre fëmijë që duhet të zhvillojnë mësimin në kushte dimri dhe me pajisje kompjuterike dhe rrjetë të internetit.

Të dhënat statistikore nuk japin në baza etnike por as në nivel regjionesh për numrin e kompjuterëve në familje, parandej ne do të përdorim të dhëna tjera socio-ekonomike në nivel regjioni që mund të hedhin dritë mbi dallimet që ekzistojnë në nivel regjional por në mënyrë indirekte edhe në mes të komuniteteve në vend duke marrë parasysh se në cilat regjione janë koncentruar pjesa dërmuese e popullatës shqiptare.

Në tabelë me ngjyrë të kuqe janë nënvizuar rezultatet që kanë devijim më të madh nga mesatarja shtetërore kurse me të verdhë ata që janë më afër këtyre devijime, ndërkaq me të gjelbër ata që kanë vlera mbi mesataren shtetërore. Nëse analizohet me kujdes kolona që paraqet të dhënat e regjionit të Pollogut ku pjesa dërmuese e popullatës që jetojnë atje janë shqiptarë, në gjitha indikatorët del se është më shumë se gjithë regjionet tjera në nivelin e mesatares shtetërore. Kuptohet se duke marrë parasysh se të dhëna mbi baza etnike nuk kemi për këtë indikatorë neve vetëm supozojmë se shqiptarët janë në pozitë tejet të disfavorshme sa i përket parakushteve për zhvillim të mësimin me mjete elektronike, internet apo mësim online. Nëse kemi parasysh përlllogaritjet e bëra për Shtetet e Bashkuara të Amerikës për humbjen që do ta kenë nxënësit por edhe shteti nëse nxënësit mungojnë, apo nuk mund të ndjekin mësimin për 4 muaj vetëm mund të supozojmë se cilat do të jenë humbjet e nxënësve por edhe komuniteteve tjera, veçanërisht romë dhe turk që nuk e kanë ndjek mësimin apo edhe nuk do ta ndjekin edhe në muajt në vijim për shkak të mungesës së parakushteve elementare për këtë lloj mësimi.

---

<sup>8</sup> Rizvan Sulejmani, të thëna të prezentuara në Konferencën Ndërkombëtare, "Migration, Mobility and Social Welfare in the context of Euro-Atlantic Integration - Demography, economic development and security", 10-11 May 2019, UNT-Shkup.

	Maqedoni e Veriut	Regjioni i Vardarit	Regjioni i Lindjes	Regjioni i Jugper- e	Regjioni Juglindjes	Regjioni i Pelagonis	Regjioni i Pologut	Regjioni Verior	Regjioni i Shkupit
Të dhënat për vitin: 2016									
Bruto prodhim vendor për krye banori	286. 955	302. 286	266. 047	222. 133	341.3 70	282.3 81	132. 538	163.301	411.575
Të dhënat për vitin: 2018									
Fëmijë prej 0- 5 vjet në parashkollorë (%)	26.3	36.0	42.1	18.1	28.0	22.3	9.1	19.8	33.1
Të dhëna për vitin: 2017									
Student të diplomuar në 000 banorë <sup>9</sup>	3.9	3.5	3.8	3.6	3.4	4.7	3.2	3.2	4.6
Të dhëna për vitin: 2019									
Shkalla e papunësisë	20.7	15.9	11.5	21.6	10.9	15.3	29.0	35.9	19.3
Të dhëna për vitin: 2018									
Familjet që përdorin internet (%)	80	75	77	82	77	80	82	91	78
Numri i kompjuterëve në familje	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Tab.3<sup>10</sup> Disa të dhëna socio-ekonomike sipas regjioneve në RMV

Këto të dhëna janë motiv kryesorë për të shtruar studimin më gjerë sa janë humbjet e shqiptarëve në periodë kohore më të gjatë kur gjenerata të tëra deri para vitit 2001 nuk kishin mundësi fare të zhvillojnë mësimin në shkolla të mesme edhe më pak atë sipërorë për arsye politike, ngase nuk lejohej mësim në gjuhën amtare. Kësaj pyetje sigurisht se nuk do ti japim përgjigje por e shtrojmë si provokim për studiuesit e ri për një studim më gjithëpërfshirës, më përmbytësorë dhe me indikatorë më të mirë.

<sup>9</sup>Popullatamë30.06.2016.

<sup>10</sup> Burimi:Enti Republikan i Statistikave, "Regjionet e Republikës së Maqedonisë", 2019

## Konkluzioni

COVID 19 në shikim të parë duket se nuk i kursen askënd nga mundësia e infektimit pa dallim race, gjinie apo statusin social pasi ajo është përhapur në gjitha kontinentet dhe gjitha vendet pa marrë parasysh nivelin e zhvillimit ekonomik, shtrirjen gjeografike e përkatësinë racore.

Megjithatë studimet më të thella brenda një shtetit si për shembull si ato të bëra në Amerikë dhe Britani flasin për atë se megjithatë grupe të caktuar racore dhe nivele të ndryshme në hierarkinë shoqërore tregojnë kapacitete të ndryshme në ballafaqim me pandeminë

Duke marrë parasysh se në RMV ekzistojnë dallime të theksuara në mes të regjioneve në zhvillim ekonomik masat e reja për mësim në format e ndryshme me të cilët zëvendësohet mësimi me prani fizike do të rezultojnë në ngecje në mësim në mos për një numër të caktuar pamundësojnë vijimin e shkollimit

Dallimet kulturore që shoqërohen edhe në dallime në zhvillimin ekonomik në RMV mund të kenë pasoja shumë të mëdha negative për disa grupe të caktuara të komuniteteve pakicë në ndjekjen e mësimin online apo në forma të kombinuara për mungesë kushtesh elementare për zbatim të kësaj forme të zhvillimit të mësimin

Për këtë qëllim institucionet përkatëse, qeveria dhe posaçërisht ministria e arsimit duhet të bëj çmos që të krijoj kushte që kjo kategori e nxënësve dhe studentëve të mund ta ndjekin mësimin nëse nuk dëshiron që ata dhe shoqëria në tërësi të paguaj çmim të rëndë në dekadat me radhë,

Masat duhet të prekin kategoritë më të varfra të popullatës, të jenë të shpejta dhe shoqëruar me ndihmës shtesë për përgatitjen e përdorimit të teknologjive të reja por edhe për krijimin e kushteve për jetesë.

## Abstract

*By the end of 2019 and the beginning of 2020 the world was confronted with a virus which medical workers defined as Covid-19. The healthcare system faced many unknowns and didn't have an efficient mechanism for fighting it. As a result, the virus got widespread among the population and consequently the WHO declared a pandemic. A lot of governments announced emergency state on the grounds that they are facing an invisible enemy. The consequences of this war were a loss of human lives and economic downturn. Despite the fact that on first sight the pandemic affected irrespective of their economic and social status, more profound analysis indicate that cultural and*

*social aspects had an effect on both the infections levels as well as the human and economic losses. Following the guidance by the healthcare institutions, that social distancing and isolation are the most efficient mechanism for containing the spread, a lot of countries, including ours, imposed national lockdown, eventually closing the borders as well as the government and educational institutions. The created situation found the educational institutions unprepared as well as the students and professors. Furthermore, this situation which interrupted the educational cycle of a lot of students, created a huge loss whose price their governments as well as the world will pay in the next generations. In order to see the consequences of the interruption of the educational cycle for a multiethnic and multicultural country as ours, we will use a comparative method of similar studies done in this regard for the USA and Great Britain. Moreover, we try to shed light on the possible consequences of university closure for our country from an ethnic perspective. Lastly, we try to give some conclusions and suggestions for the mitigation of the consequences from this pandemic.*

#### Abstrakti

*Bota në mbarim të vitit 2019 dhe fillim të viti 2020 u ballafaqua me një virus që mjekësia e definoj si COVID 19. Medicina u përball me shumë të panjohura pa mekanizma efikas për ta luftuar atë dhe kur ajo mori përmasa të pakontrollueshme Organizata Botërore e Shëndetësisë e shpalli si pandemi. Shumë prej qeverive shpallën gjendej të jashtëzakonshme me arsyetimin se janë sulmuar nga një armik i padukshëm. Pasojat e kësaj lufte u shprehën përmes humbjes së jetës së njerëzve por edhe humbje në ekonomi. Përsëri faktit se në shikim të parë nuk u kursyen as të varfrit as të pasurit, as të fuqishmit e as të dobëtit, megjithatë studimet më të thella nxorën në pah se dallimet kulturore dhe sociale kanë ndikim në përmasat e infektimit por edhe në humbjet e jetëve njerëzore dhe ekonomisë. Pasi institucionet mjekësore si mekanizëm për parandalimin infektimit sugjeruan izolimin dhe distancimin, politika e pranoj këtë andej shumë shtete përfshi edhe vendin tonë mbyllën kufijtë dhe institucionet përfshi edhe shkollat dhe universitetet. Kjo ishte një përvojë e re që i gjeti të papërgatitur edhe institucionet arsimore por edhe nxënësit, studentët, arsimtarët e profesorët. Situata i largoj nga bankat shkollore shumë nxënës e student për çka ata, nxënësit, shtetet e tyre, por edhe bota do të paguaj çmim për disa dekada. Për të nxjerrë në pah disa nga pasojat e ndërprerjes së mësimin për ne si shtet multietnik dhe multikulturorë me metodë komparative duke përdorë të dhëna nga studimet e bëra në disa shtete si Amerikë e Britani do të mundohemi të zbardhim pasojat e mundshme për shtetin tonë në pikëpamje etnike nga mbyllja e shkollave dhe universiteteve. Në fund të mundohemi të japim disa konstatime dhe sugjerime si të zbuten pasojat nga kjo pandemi.*

ISSN 2671-3004

UDC 81&#39;27:[37:316.723-021.463(497.7)  
Punim studimor

### **Mustafa IBRAHIMI**

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup

Fakulteti i Shkencave Sociale

E-mail: [mustafa.ibrahimi@unt.edu.mk](mailto:mustafa.ibrahimi@unt.edu.mk)

## **REFORMAT GJUHËSORE NË ARSIMIN E SHOQËRIVE SHUMËKULTURORE - RASTI I MAQEDONISË SË VERIUT**

## **ЈАЗИЧНИТЕ РЕФОРМИ ВО ОБРАЗОВАНИЕТО НА МУЛТИКУЛТУРНИТЕ ОПШТЕСТВА – СЛУЧАЈ СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

## **LANGUAGE REFORMS IN THE EDUCATION OF MULTICULTURAL SOCIETIES - THE CASE OF NORTHE MACEDONIA**

### **Hyrje**

Edhe përkundër shumë dallimeve, njerëzit gjithmonë kanë qenë të prirë të komunikojnë nëpërmjet kufijve gjuhësorë dhe kulturorë. Në komunikimin e përditshëm, çdo individ shërbehet me më pak edhe një gjuhë tjetër. Kjo dukuri e dygjuhësisë është e përhapur në të gjitha kontinentet.

Në Evropë dhe kontinentet tjera me vëmendje studiohen rastet e shumëgjuhësisë, bashkë me të shqyrtohet edhe shumëkulturalizmi, edhe pse, deri më tani shumë pak është elaboruar nga ky aspekt. Kohëve të fundit mbahen shumë takime dhe diskutime për dukurinë e shumëkulturalizmit, e cila u jep njerëzve të drejtën dhe mirënjohjen të jenë të ndryshëm. Mirëpo, është për të kritikuar tendenca thelbësore e multikulturalizmit, ku kultura paraqitet si statike dhe i stërmadhon dallimet midis njerëzve dhe rrjedhimisht

ushqen paragjykimet ndaj të "tjerëve". Kjo vjen ngase nuk përdoren drejt termat: njëkulturë dhe shumëkultura, kurse sipas Bugarskit duhet bërë dallim edhe midis: multikulturës, multikulturalitetit dhe multikiulturalizmit. Sipas Bugarskit, *multikultura* është shenja e ndonjë mjedisi; *multikulturaliteti* paraqet orientimin e përgjithshëm, i cili kujdeset për atë çështje dhe *multikulturalizmi* paraqet politikën specifike dhe të përpunuar kulturore dhe arsimore për këtë fushë (Bugarski 2002:166). Në këtë mënyrë të gjitha shtetet moderne janë multikulturore, por nuk janë të gjithë *multikulturale* dhe as *multikulturaliste*.

Gjithashtu me rëndësi është të dallohen në mënyrë sistematike edhe termat *multikulturalizëm* dhe *interkulturalizëm*, të cilët ndonjëherë përzihen në mënyrë të paarsyeshme. Pikërisht për këtë, shpesh herë ballafaqohemi me probleme të ndryshme, sidomos kur një grup shoqëror dominon ndaj grupit tjetër shoqëror, për realizimin e interesave të veta politike apo ekonomike. Është fakt, se ata grupe shoqërore nuk posedojnë fuqi dhe kapacitet të njëjtë, megjithatë konfrontimet janë të paevitueshme. *Interkulturalizmi* nënkupton bashkëveprimin e atyre kulturave. Zakonisht ky lloj veprimi është dinamik, e thekson barabarësinë e të gjitha kulturave në veprimet e tyre të përbashkëta. Në plan të parë është pasurimi i tyre pa marrë parasysh dallimin e marrëdhënieve shumicë-pakicë.

Për shembull në Kanada, mospajtimet paraqiten për shkak të kufijve të dominimit ekonomik të shumicës anglofone mbi Kuebekun frankofon (Breton 1980). Për shkak të kësaj, ekzistojnë edhe përpjekjet kryesore separatiste për pavarësi të Kuebekut frankofon, pra aspekti ekonomik, gjegjësisht relacioni eksploatues – i eksploatuar. Logjikë identike është shënuar edhe në Belgjikë (raporti midis flamanëve dhe valonëve), si dhe në Spanjë, ku rritja e nacionalizmit katalonas koincidon me përfshirjen e Katalonisë në rajonet më të zhvilluara evropiane, të cilët i quajnë "Klubet e të pasurve" (Kimlika 1999:63). Andaj, ky komunikim imponon pyetje të ndryshme, si: *Cilat janë raportet midis gjuhëve, shtrirja e gjuhëve të mëdha në llogari të gjuhëve të vogla; vlerat simbolike dhe komunikuese të gjuhëve; Interkulturalizmi në arsim; globalizimi dhe lokalizimi i gjuhëve etj.*

## 1. Realiteti gjuhësor i Evropës

Gjatë historisë më të re evropiane, raportet midis gjuhëve të Evropës kanë kaluar kryesisht nëpër 3 modele. I pari model mund të

quhet *modelues*, duke u mbështetur në parimet romantike-nacionaliste të “treshit të shenjtë” gjuha, kombi, shteti që ishte tipike për Evropën e fundit të shek.18. (Bugarski 2009:12). Kah mesi i shek.XX, këtë gradualisht e zëvendëson *ekspansioni*, i cili favorizon shtrirjen e gjuhëve të fuqishme, në dëm të gjuhëve të vogla. Ky model më i pranishëm ka qenë në pjesët e ndryshme të botës, por aktiv ka qenë edhe në Evropë (Bugarski 2009:12). Padyshim ky model rrënjët i ka që nga polemikat që kanë ekzistuar në Evropë në shek. XVI, pothuaj nuk ka mospajtime se gjuha hebraike është gjuhë parababilonase, pra gjuha që ka ekzistuar para se të paraqitet dënimi, porse evropianët me çdo kusht janë orvatur të dëftojnë se gjuha e tyre (anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, italishtja etj.) është një nga gjuhët e kohëve më të lumtura, para se zoti ta paraqes dënimin, e me këtë duke lindur edhe çfarëdo lloj gjuhësh. Andaj një nga mënyrat e para për të vepruar me shoqëritë shumëgjuhësore është që dallimet të drejtohen në pabarazinë e gjuhëve, e me këtë edhe të popujve. Me anë të këtyre konceptioneve romantike, ata e kanë matur fuqinë e tyre, pikërisht duke e lartësuar gjuhën e tyre, dhe duke zvogëluar dhe nënçmuar gjuhën e popujve tjerë.

Dhe më në fund gjatë ndërrimit të shekujve dhe në fillim të shek. XXI, afirmohet një model tjetër ai *interaktiv*, që nënkupton komunikimin e folësve të gjuhëve të ndryshëm në bazë të parimeve të barabarta, që do të mundësonte anëtarësim në familjen evropiane në një kulm të përbashkët (Bugarski 2009:12-13). Shumë popuj, që janë pakicë në shtetet shumëgjuhësore, nëpërmjet gjuhës ata shohin ardhmërinë, dhe gjuhën e shohin si armë kundër robërisë së huaj. Nëse në një shtet shumëgjuhësor orvatemi të krijojmë gjuhë të përbashkët, do të vijmë në situata të palakmueshme. Pse? Para së gjithash, ai shtet do të orvatet të garantoj sigurimin e mjeteve për komunikim të gjerë të nacionaliteteve të ndryshme dhe do të mundësoj të gjithë të integrohen në jetën shoqërore. Por, për ata që kjo gjuhë është e huaj do të jenë të detyruar ta mësojnë me qëllim që mos t'i keqësojnë kushtet e jetës së tyre qytetare. Duke iu falënderuar përkthimeve nga njëra palë, sidomos këtë e bëjnë pakicat edhe pala tjetër do të ketë njohuri për ndonjë kulturë të caktuar. Por kjo formë e demokratizimit e bën më pak të mundur përdorimin e gjuhës së përbashkët, sepse çdokush e favorizon gjuhën e tij. Si kompromis për këtë duhet të përdoren të dyja gjuhët, dhe të kategorizohen edhe si gjuhë nacionale dhe si gjuhë zyrtare.

*BE-ja insiston në të drejtën e të gjithë qytetarëve në përdorimin e të gjitha të drejtave kombëtare dhe të pakicës, por në të njëjtën kohë*

*edhe në mësimin e gjuhëve fqinje dhe të huaja.* Qëllimi është që secili të flet nga tri gjuhë (duke përfshirë edhe gjuhën amtare). Realizimi i programeve të tilla, nënkupton vërtetim thelbësor të politikave kombëtare gjuhësore, si dhe reforma të rëndësishme në arsimin gjuhësor, sidomos në çështjen e mësimin të gjuhëve.

### **1.1.Kundërshtimi ndaj “imperializmit lingvistik”**

Shikuar nga aspekti historik, shumëgjuhësia ka qenë e pranishme në shumë pjesë të botës, duke përfshirë edhe Evropën mesjetare lindore dhe të mesme. Mirëpo, në disa raste shumëgjuhësia ka qenë e pranishme vetëm në një shtresë të caktuar të një shoqërie njënacionale. Gjuha zyrtare është gjuha e pushtetit, që mundëson përparimin e individit, i cili paraqitet si çelësi suksesit të një shoqërie, pra si gjuhë të pushtetit duke marrë parasysh numrin e popullsisë dhe shtrirjen gjeografike. Ky problem paraqitet edhe sot pothuaj në të gjitha fushat e bashkëpunimit, qoftë në Bashkimin evropian qoftë në shtetet tjera botërore që janë shumetnike. P.sh. në Francë nuk do ta pranohet anglishten, sepse frikohen se frëngjishtja do ta humb pozitën ndërkombëtare dhe mund të shndërrohet në gjuhë rajonale, se do të largohet nga shtetet frankofone që mund të qoj në amerikanizimin e Evropës.

Sot kur kemi krijimin e institucioneve moderne të tipit të Bashkimit Evropian nuk do të jetë e mundur të funksionojë pa mbështetjen e gjuhëve për komunikim të gjerë (shih Aronin 2007). Këtë mund ta vërtetojmë me faktin se anglishtja në të shumtën e rasteve nuk i zëvendëson gjuhët e tjera por u shtohet. Ndoshta do të tingëllojë paradoksalisht, sepse ekziston bindja se ekspansionizmi i anglishtes në botë në fakt e stimulon shumëgjuhësinë edhe në planin shoqëror edhe në atë individual, në kohën kur gjuhët në botë zvogëlohen.

Pa mëdyshje globalizimi i anglishtes paraqet kanosje për shumë gjuhë që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me të, por kjo pyetje është mjaft e ndërlikuar se sa shihet në shikim të parë. Sepse ekzistojnë raste ku gjuhët e vogla më tepër janë të rrezikuara nga gjuhët më të mëdha rajonale, si në Afrikë dhe Azi. Pra, hovin e anglishtes më tepër e hetojnë gjuhët e mëdha rivale sesa ata të vegjël. Jo përherë anglishtja ka qenë shkaktare për humbjen e pozitës të disa gjuhëve rivale. P.sh. frëngjishtja e humbi pozitën e saj në përdorimin ndërkombëtar, në kohën kur anglishtja sa po filloi të përhapej, nga ana tjetër reduktimi shumë i madh i rusishtes ndodhi për shkak të rrethanave politike të cilët ndodhën pas shkatërrimit të ish-

Bashkimit sovjetik. Mënyra se si mbrohet frankofonia është në kundërshtim me temperamentin francez që nuk pranon përzierje pretencioziteti, konsistencë dhe cikërrima. Kjo pa mëdyshje dëshmon për refuzimin që të shihet situata e vërtetë. Ky problem që ka frankofonia nuk është vetëm problem i gjuhës frënge, por edhe i gjermanishtes, italishtes, spanjishtes e të tjerëve të cilët edhe ata anglishtja i ka shtyrë në marginë. Për çdo rast, edhe vëzhguesit ithtarë të akuzave ndaj anglishtes si bartësi kryesor i “imperializmit linguistik” (Phillipson 1992), përgjegjës për “gjenocidin linguistik” ose “lingvicid” (Skutnabb\_Kangas 2000), tani mund të mbështeten edhe në përfundime më të balancuara dhe qasje më shtresore.

### **1.2. Raporti gjuhë e përbashkët – gjuhë e pakicës**

Shumë popuj, që janë pakicë në shtetet shumëgjuhësore, nëpërmjet gjuhës ata shohin ardhmërinë, dhe gjuhën e shohin si armë kundër robërisë së huaj. Nëse në një shtet shumëgjuhësor orvatemi të krijojmë gjuhë të përbashkët, do të vijmë në situata të palakmueshme. Pse? Para së gjithash, ai shtet do të orvatet të garantojë sigurimin e mjeteve për komunikim të gjerë të nacionalitetëve të ndryshme dhe do të mundësoj të gjithë të integrohen në jetën shoqërore. Por, për ata që kjo gjuhë është e huaj do të jenë të detyruar ta mësojnë me qëllim që mos t’i keqësojnë kushtet e jetës së tyre qytetare. Duke iu falënderuar përkthimeve nga njëra palë, sidomos këtë e bëjnë pakicat edhe pala tjetër do të ketë njohuri për ndonjë kulturë të caktuar. Por kjo formë e demokratizimit e bën më pak të mundur përdorimin e gjuhës së përbashkët, sepse çdokush e favorizon gjuhën e tij. Si kompromis për këtë duhet të përdoren të dyja gjuhët, dhe të kategorizohen edhe si gjuhë kombëtare dhe si gjuhë zyrtare. Edhe pse si rezultat i kësaj zmadhohen veprat me përmbajtje të njëjtë, sidomos në shkencë dhe teknikë, kjo situatë mund të lind nevojën për gjuhë të përbashkët, që mund të jetë më ekonomike. Kjo mund të ndodh në shtetet e ndryshme me ndonjë gjuhë kombëtare, që nuk është zyrtare në atë shtet, kështu ka qenë me latinishten në shek.XVIII, dhe tash mund të jetë me anglishten si gjuhë e përbashkët.

Përdorimi vetëm i një gjuhe, si gjuhë zyrtare në një shoqëri multikulturore, sjellë deri tek ajo që pjesëtarët e gjuhës që janë në numër më të vogël, të mos kenë fuqi administrative në strukturat shoqërore ose njëjtë si ata. Të gjitha këto padrejtësi janë të lidhura me gjuhën, e cila për herë është konsideruar si shtyllë në një shoqëri. Sipas një rregulle, gjuhën zyrtare së pari e pranon klasa sunduese,

pastaj popullsia qytetare e më pas fshati, dhe atje ku gjuha e nënshtruar kundërvihet paraqitet dygjuhësia (Kalve 1981:100).

Në këso rastesh, zakonisht kemi të bëjmë me multikulturalizmin segregues, që Frojdi e quajti *narcizmi i dallimeve të vogla*, të cilat veprojnë në drejtim të gabuar, duke e theksuar dallimin kulturor në vend të ngjashmërive të kulturave të afërta. Sipas kësaj dallohen dy lloje të multikulturalizmit *Multikulturalizmi segregues* në hapësirën ballkanike fillon të dominojë bashkërisht me procesin e krijimit të shteteve nacionale gjatë shek.19, të cilat bazoheshin në njësimin e gjakut dhe tokës. *Multikulturalizmi integrues* e takojmë në ato shtete ku asnjëra prej tyre, nuk ka bazë për të pasur të drejtë ekskluzive ndaj asaj toke, siç është shembulli i Australisë dhe Kanasës (Pavković 1998:155-170).

## **2. Realiteti gjuhësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

Është fakt se nga ana e shtetit është arritur përparim të madh në promovimin e të drejtës për edukim të komuniteteve të ndryshme etnike, sidomos nëpërmjet të sigurimit të arsimit në gjuhën amtare dhe me promovimin e decentralizimit, me çka komunitetet etnike, nëpërmjet të pushtetit lokal, fituan kontrollë më të madhe ndaj shkollave. Po ashtu nëpër shkolla është futur promovimi i multikulturalizmit dhe interkulturalizimit, si koncepte kryesore në arsimin fillor dhe të mesëm që drejtpërdrejt ka të bëjë me promovimin e multikulturalizmit në arsim. Mirëpo përmbajtjet, metodat dhe aktivitetet që u ofrohen nxënësve në shkollë, nuk promovon sa duhet tolerancë dhe respektim të dallimeve dhe respektim të të tjerëve. Shqyrtimi i gjendjes tregon se programet e qeverisë, dhe korniza juridike promovojnë komunikim interetnik. Megjithatë, fokusi është në ndalimin e diskriminimit e jo në promovimin e këtyre parimeve. Në vazhdim, respektimi i dallimeve, tolerancës dhe pranimit shëndrohet në mundësim për përdorimin e gjuhëve të bashkësive të ndryshme etnike në shtetin dhe përkrahje për zhvillimin e identitetit të vet (nëpërmjet të organizimit të mësimin në gjuhë të ndryshme, sigurimit të librave në gjuhë të ndryshme dhe përmbajtjeve që kanë të bëjnë me traditën dhe historinë e identitetit personal). Disa vlera të dëshiruara në frymën e respektit të ndërsjellë janë vetëm të përmendura në kornizën normative, por nuk është dhënë obligim për implementim të këtyre vlerave në sistemin arsimor dhe mungojnë mekanizmat për stimulim/ ndëshkim të respektimit/mosrespektimit të këtyre parimeve, si në nivelin nacional, ashtu edhe në nivel të shkollës.

## 2.1. Mësimi i gjuhës së tjetrit

Sipas planeve mësimore në ciklin e ulët në RMV, nxënësit të cilët ndjekin mësim në gjuhët e tjera fillojnë ta mësojnë gjuhën maqedonase si lëndë të obligueshme që nga klasa e parë, ndërsa nxënësit të cilët ndjekin mësim në gjuhën maqedonase nuk janë të detyruar të mësojnë gjuhë të ndonjë prej bashkësive etnike më të numërta edhe pse janë të obliguar të mësojnë gjuhë të huaj të dytë. Gjithashut, tregohet revolt për shkak se lënda e gjuhës maqedonase është lëndë e domosdoshme për shqiptarët, edhe atë që nga klasa e parë (duke menduar se fëmijët janë shumë të vegjël për atë), bashkë me ndjenjën se tek maqedonasit nuk ka fare vullnet për t'iu mësuar diçka shqiptarëve. “Se sa janë raportet e ashpra tregoj edhe ajo që para dy viteve kur u ofrua që si lëndë zgjedhore të jetë edhe gjuha shqipe...asnjë prind nuk u pajtua që të mësohet në gjuhën shqipe”. (SMMNA 2009:80-100).

## 2.2. Çfarë mësojnë maqedonasit dhe shqiptarët për njëri-tjetrin

Rezultate nga fokus grupet me nxënësit dhe arsimtarët arsimtarët shqiptarë pohojnë se i mësojnë shumë për maqedonasit dhe para se gjithash në lëndën shoqëri dhe histori , por gjithashtu edhe në lëndën e vizatimit, gjuhës maqedonase dhe gjeografisë. ata janë të revoltuar sepse në tekstet shkollore edhe në përkthimet në gjuhën shqipe ka emra maqedonas (për shembull në librat e matematikës). Vetëm një arsimtar haptas deklaroi se përmbajtjet për maqedonasit eliminohen në llogari të shqiptarëve, por e pranojnë se të njëjtën gjë e bëjnë e arsimtarët maqedonas. “Unë personalisht, historinë e sllovenëve, 14 njësi mësimore i eliminoj...por, të tjerat i mësojmë sepse ka shumë”. Theksohet se shqiptarët ende paraqiten si kombësi, me çka vihet në përfundim se maqedonasit mësojnë gjëra të papërshtatshme. Disa nga arsimtarët thonë se përdorin literaturë (kryesisht nga Shqipëria), e cila është e paraparë me programin zyrtarë, sepse materiali që është nëpër librat shkollore është i papërshtatshëm.

Nxënësit më të rritur shqiptarë, se çfarë mësojnë për maqedonasit, zakonisht fokusohen në lëndën e Historisë, prej ku marrin informata për maqedonasit (përmendet Leka i Madh), ndërsa më të vegjëlit në lëndën Shoqëria. Të dy grupmoshat nuk japin hollësi për atë se çfarë mësojnë. arsimtarët maqedonas deklarojnë se nxënësit e tyre mësojnë diçka për shqiptarët në klasën e tretë dhe të katërt (ka disa orë për krahasimin e festave maqedonase dhe atyre

shqiptare, kostumeve popullore dhe instrumenteve), ndërsa në arsimin lëndor përmendet Historia e shqiptarëve dhe kur mësohet për Ballkanin dhe religjionin, kur mësohet Njohja e religjioneve. Thua jse të gjithë mendojnë se është e natyrshme shqiptarët të mësojnë për maqedonasit dhe shpresojnë se kolegët e tyre i ndjekin programet mësimore. Nxënësit maqedonas, të anketuar nuk kanë përvojë identike me bashkëmoshatarët shqiptarë në shkollë, kur bëhet fjalë për atë se çfarë mësojnë të tjerët. Disa shprehen se në lëndën e Historisë mësojnë edhe për festat, madje e mësojnë edhe gjuhën, ndërsa disa mësojnë me ndikim (u përmendën edhe disa dezinformata), ndërsa disa “i tejkalojnë leksionet në lëndën e historisë ku bëhet fjalë për shqiptarët”.

Është shumë e vështirë të krijohet një përshtypje e përgjithshme për këtë çështje, sepse mendimet e përfaqësuesve nga shërbimet profesionale janë shumë heterogjene. Njëra nga të anketuarat mendon se të dyja palët kanë paragjykime të dukshme, tjetra mendon se janë maqedonasit ata të cilët shqiptarët i shohin me përbuzje, ka edhe prej atyre që mendojnë se gjithçka është në rregull dhe se “fëmijët nuk veçohen”.

Arsimtarët shqiptarë të shkollave të mesme e theksojnë rezistencën që kanë nxënësit shqiptarë, sidomos gjatë mësimin të leksioneve që kanë të bëjnë me historinë dhe letërsinë maqedonase, dhe thonë se është shumë e rëndësishme që maqedonasit të mësojnë gjuhën shqipe. ata mendojnë se nxënësit shqiptarë mësojnë shumë për historinë dhe letërsinë maqedonase, përkundrajt nxënësve maqedonas, të cilët nuk mësojnë asgjë për gjuhën dhe kulturën shqipe: “Ne mësojmë gjithçka për ata. Madje e mësojmë gjuhën e tyre” Sipas arsimtarëve shqiptarë, në përmbajtjet që maqedonasit mësojnë për shqiptarët ka shumë gjëra të pasakta dhe të pavërteta që kanë të bëjnë me shqiptarët. (SMMNA 2009:80-100).

### **3. Stereotipat etnike te fëmijët dhe studentët**

Shikuar nga aspekti sociopsikologjik, paragjykimet dhe stereotipat kolektive janë ngulitur thellë në vetëdijen e çdo populli, sidomos tek popujt e Ballkanit. Këtu popujt anojnë kah njëgjuhësia e cila mund të lidhet edhe me nacionalizmin e popullit shumicë. Nga ana tjetër, nëse etnitetet që jetojnë në shtetet shumëgjuhësore kanë status integrues jo segregues, atëherë shumëgjuhësia paraqitet si pengesë e rëndësishme ndaj nacionalizmit dhe dukurive të ngjashme si: *etnocentrizmit, ksenofobisë, shovinizmit dhe racizmit* dhe si një

faktor i cili shumë fortë nxit tolerancën gjuhësore dhe çdo tolerancë tjetër.

### **3.1. Stereotipat te studentët e Fakultetit Pedagogjik në Shkup**

Rezultatet e hulumtimeve empirike të kryera katër herë me radhë (në vitin 1996, 1998, 2000 dhe 2002) me qëllim që të përshkruhet dhe krahasohet pamja për selfin etnik personal dhe për “Tjetrin” etnik te maqedonasit dhe te shqiptarët që studiojnë për t’u bërë edukatorë apo arsimtarë të ciklit të ulët treguan se të dyja grupet e të anketuarve (sidomos ai shqiptar) ndërtojnë pamje të idealizuar për grupin e vet etnik (Petroska-Beshka dhe Kenig, 2002:259-278). Të anketuarit maqedonas e shohin “Tjetrin” etnik si armik, të keq, të fuqishëm dhe aktiv, përkatësisht si të rrezikshëm, ndërsa shqiptarët e përjetojnë “Tjetrin” etnik si kundërshtar të keq (por jo shumë të keq), të pafuqishëm dhe pasiv me të cilin nuk do ta kishin të vështirë të ballafaqohen. Studimi mbaron me përfundimin se pa përpjekje serioze për ndërprerje të spirales së distancimit, të dyja pamjet për “Tjetrin” do të diferencohen qartë në pamje për armikun e papajtueshëm. Hulumtimi kushtuar stereotipave të studentëve të Fakultetit Pedagogjik në Shkup (Petroska Beshka dhe Kenig, 2005:87-99) e vërteton ekzistencën e stereotipave tek arsimtarët e ardhshëm të ciklit të ulët. Studentët maqedonas nëpërmjet prizmit negativ i vështrojnë vetëm shqiptarët (por jo dhe turqit dhe serbët), ndërsa studentët shqiptarë negativisht i stereotipizojnë edhe maqedonasit edhe serbët

### **3.2. Stereotipat etnikë te fëmijët**

Në një sërë hulumtimesh të kryera me rastin e TV-serisë “Mëhalla jonë” (Petroska-Beška V., Kenig N. & Najaevska M. 2001). janë kontrolluar stereotipa etnikë përkundrejt maqedonasve, shqiptarëve, turqve dhe romëve që i kanë fëmijët e moshës dhjetëvjeçare që janë përfaqësues të të katërtave bashkësive etnike. Rezultatet treguan se përveç fëmijëve romë, të gjithë fëmijët e tjerë e shohin grupin e vet etnik në një dritë pozitive, kurse të gjithë të tjerëve ju japin stereotipa negativë. Njëkohësisht, romët janë shënjestër e stereotipizimit negativ më intensiv dhe distancimit social, sidomos prej fëmijëve shqiptarë dhe turq, kurse fëmijët maqedonas u vendosin karakteristikat agresive më negative shqiptarëve dhe turqve.

### **Përfundime**

Nga krejt ajo që thamë më parë, është e qartë se situata gjuhësore në Evropë dhe botë, e në mesin e tyre edhe në Maqedoninë e Veriut aspak nuk është stabile. Nën ndikimin e globalizmit, realiteti gjuhësor është vazhdimisht në një trazim të pandalë. Këtë gjendje e mundësojnë shumë faktorë politikë, ekonomik dhe kulturor, prej të cilëve mund t'i veçojmë dy më të rëndësishëm. I pari është ndarja e gjuhës nga territori duke e dobësuar shtetin tradicional kombëtar. Gjuhët, sidomos ato që janë në përdorim ndërkombëtar nuk u takojnë më aq kombeve apo shteteve sesa atyre që e përdorin. Faktori i dytë është lirimi i gjuhës nga hapësira gjeografike dhe depërtimi i saj në hapësirën virtuale nëpërmjet teknologjive të reja, sidomos në internet. Në shikim të parë kemi dominim të anglishtes, por nga ana tjetër afirmohen edhe shumë gjuhë tjera që nuk kanë status ndërkombëtar, dhe si duket ky konflikt tani për tani nuk ka gjasa të zgjidhet në këtë fushë.

Rritja e ndërjegjes për ndërlíkueshmërinë e theksuar të kësaj situatë midis përfaqësuesve të shkencave shoqërore ka sjellë deri te disa propozime me qëllim të ndriçimit të termit, që viteve të fundit etiketohej si “rendi i ri gjuhësor në botë”. Edhe pse kjo nuk mund të na pëlqej, megjithatë paraqet një emërtim të përgjithshëm për peizazhin gjuhësor global në këtë moment.

Përpjekje për të vënë sadopak ndonjë rend në gjithë këtë kaos gjuhësor e bëri sociologu holandez Abram de Svan, i cili në veprën e tij paraqiti konceptin e tij ndaj sistemit gjuhësor “botëror” ose “global” (De Swaan 2001). Sipas tij gjuhët përbëjnë pjesë të një sistemi mbarëbotëror. Çdo gjuhë prej tyre përfshinë një grup të gjuhëve lokale të lidhur me një gjuhë qendrore, zakonisht me atë gjuhë të cilën e flasin shumica e individëve bilingual (frëngjishtja, gjermanishtja, rusishtja, spanjishtja, kinezishtja, arabishtja etj.). Edhe anglishtja gjithashtu ka konstelacionin e vet, por tani ajo krijon një rrjet global e cila siguron komunikim midis konstelacioneve.

Këtë ide të Svanit e përpunoi edhe sociolinguisti francez Luj Zhan Kalve (Calvet 1999), i cili modelet e tij i përfshinë në kuadër të modelit të “gravitetit” të ekologjisë gjuhësore, ku janë të radhitura 4 lloje kryesore të gjuhës. Anglishtja është e vetmja gjuhë “hiperqendrore”, më tepër ka gjuhë “superqendrore” (p.sh. frëngjishtja, spanjishtja dhe portugalishtja në ish- kolonitë), shumë të tjerë janë gjuhë “qendrore” (gjuhët nacionale dhe lingua franka); të gjithë të tjerët janë gjuhë “periferike” (gjuhët amtare pa status zyrtar dhe

vernakularët). Gjuhët që janë të radhitur në këtë hierarki kryejnë tri funksione kryesore – zyrtare, komunikuese dhe amtare.

Një model tjetër më të ri bazohet në “konstelacionet dominante gjuhësore” e cila u mundëson qytetarëve që të funksionojnë në tërësi në mjediset shumëgjuhësore. Ky model përmban më së paku nga tri pjesë: zakonisht një gjuhë për komunikim më të gjerë (më shpesh anglishtja), një gjuhë zyrtare apo rajonale (gjuhë etnike, të pakicës ose të gjuhës së prejardhjes). Midis shembujve janë anglishtja, spanjishtja dhe katalonishtja në Spanjë; anglishtja, finlandishtja dhe suedishtja në Finlandë; hebraishtja, anglishtja dhe rusishtja në Izrael (Aronin 2007), shqipja, serbishtja dhe anglishtja në Kosovë. Një nismë të tillë kemi në Maqedoninë e Veriut, por me hapa të ngadalta. Gjithsesi në një të ardhme duhet të ndodh, sepse kjo përfshirje të mësimit të gjuhës së tjetrit i ka kapur vetëm shqiptarët dhe pakicat tjera dhe jo edhe maqedonasit. Sipas këtij modeli duhet të përfshihen të gjitha bashkësitë dhe individët që jetojnë në atë shtet. Për dallim të Maqedonisë në Kosovë anglishtja krahas shqipes dhe serbishtes përdoret si gjuhë e dytë zyrtare. Ka përpjekje që, pos në Kosovë, edhe në disa vende fqinje ajo të bëhet gjuhë e dytë zyrtare (Islamaj 2008).

Por një gjë është e evidente, gjuhët e të gjitha këtyre shteteve shumëgjuhësore lidhen me anglishten, duke e konsideruar si një gjuhë të tretë. Sot anglishtja jo vetëm që konsiderohet si *gjuhë e tretë në Evropë* (Cenoz / Jessner 2000), por edhe herë pas here emërtohet edhe si *gjuhë shtesë ose plotësuese* (Bugarski 2004, Aronin 2007:7, Singleton 2007:1). Nëse mund të vërejmë me vëmendje anglishtja nuk i zëvendëson këto gjuhë, por e shtojnë si gjuhë plotësuese. Ekziston bindja se nuk është i mjaftueshme më bilingulizmi (mos flasim më për monolingualizmin), por norma e re parasheh njohjen e tri gjuhëve për secilin e jo vetëm një apo dy. Në uebfaqet e disa ministrive dhe drejtorive në RMV i sheh në dy gjuhë, maqedonisht dhe anglisht, por jo edhe në shqip. Ose në sistemin arsimor, nuk kemi strategji gjuhësore ku edhe fëmijët maqedonas do ta mësonin gjuhën shqipe, edhe pse ka lëvizje shumë të vogla në këtë aspekt.

Andaj gjuhët më të vogla dhe më pak të dobishme se gjuhët më të mëdha, nuk janë më pak të rëndësishme, por edhe ata janë njësoj të çmueshëm se gjuhët e mëdha. Rezistimi i amerikanizimit të Evropës apo botës, nuk do të thotë t’i konkurrosh anglishtes, por së pari të pranohet atje ku është i nevojshëm dhe ti çlirojmë gjuhët e tjerë. Në vend që ndaj gjuhës angleze të zhvillojmë luftë guerile, pse nuk ia pranohet rolin e gjuhës ndërkombëtare, në dy fusha të rëndësishme,

shkencës dhe teknologjisë (Domenak 1991 : 107), dhe paralelisht me të përdoren edhe gjuhët tjera zyrtare, amtare ose nacionale.

Por, për të operacionalizuar një program të tillë, nevojitet një aksion më i gjerë ku planifikimi i gjuhës duhet bërë duke e ngritur mbi nivelin e shtetit nacional, që deri tani ishin të kufizuar vetëm në nivel ndërkombëtar. Me fjalë të tjera, duhet të zhvillohen gjeostrategji sistematike gjuhësore në kuadër të planifikimit të shumëllojshmërisë gjuhësore në kontekstin e lidhjes së ndërsjellë brenda tendencave globale.

### **Rekomandime:**

- 1) Dokumentat e shkollës (Statuti dhe Programet vjetore) duhet të parashohin krijimin e mekanizmave/strategjive për promovimin e respektit, tolerances dhe pranimit dhe masa të ngjashme nëse këto janë të cënuara ose nuk respektohen.
- 2) Disa programe mësimore të redefinohen/ ripërpunohen, ose më konkretisht, duhet ndërmarrë hapa me qëllim që: të futen përmbajtje të obligueshme për “të tjerët”, të cilat do të promovojnë interaksion nëpërmjet të paraqitjes së bashkësive etnike si pjesë e ndodhive të njëjta dhe/ose synimeve të njëjta. •
- 3) Të sigurohet që mësimi i gjuhës shqipe të trajtohet si më e rëndësishme se mësimi i gjuhës së huaj të dytë
- 4) Të krijohen kushte që nxënësi joshqiptarë, mund ta zgjedh gjuhën shqipe që të mësohet gjatë arsimit të rregullt, të paktën në nivel të komunikimit themelor.
- 5) Njohtimi me historinë, kulturën dhe traditën e bashkësive “të tjera” nëpërmjet të sigurimit të prezencës së përmbajtjeve, personazheve, fotografive dhe autorëve (edhe meshkuj edhe femra) që u përkasin bashkësive të ndryshme etnike ose që kanë të bëjnë me to.
- 6) Aktivitete të përbashkëta, sepse të dy palët e nxënësve, maqedonas dhe ato shqiptarë (më shumë në nivelin e shkollës së mesme) janë të stërngarkuar me stereotipe dhe paragjykitime etnike negative për “të tjerët”.
- 7) Kapacitetet e arsimtarëve duhet të zmadhohen nëpërmjet të: sigurimit të programeve adekuate gjatë studimeve si dhe gjatë shërbimit në shkollë për t’u bërë më të ndjeshëm dhe për t’u pajisur për të realizuar qëllimet mësimore që kanë të bëjnë me pranimin dhe respektimin e “të tjerëve” në realitetin multikulturor dhe multietnik të vendit.

## Literatura:

- ARONIN, L. (2017). *Current Multilingualism as a New Linguistic World Order*. Trinity College Dublin: Centre for Language and Communication Studies, Occasional Paper No.67.
- BUGARSKI, Ranko. (2002). *Nova lica jezika*. Beograd: Bibliotek XX vek.
- BUGARSKI, Ranko. (2004). *Engleski kao dodatni jetik*. Philolog:Beograd.
- BUGARSKI, Ranko. (2009). *Evropa u jeziku*. Beograd: Bibliotek XX vek.
- BRETON, Raymond,G, Reitz, Jeffrey and Valentine, Victor. (1980). *Cultural Boundaries and the Cohesion of Canada*. The Institute for Research on Public Policy, Montreal.
- CENOZ, J./ U.Jessner, eds. (2000). *English in Europe: The Acquisition of a Third Language*. Clevedon: Multilingual Matters.
- DE SWAAN, A.(2001). *Words of the World: The Global Language System*. Cambridge: Polity Press.
- DOMENAK, Žan – Mari (1991). *Evropa: kulturni izazov*. Beograd. Biblioteka XX vek.
- IBRAHIMI, Mustafa. (2018). *Sociolingvistika*. UNT: Shkup.
- ISLAMAJ, Shefikije (2008), *Gjuha dhe identiteti*, Tiranë.
- KALVE, Luj - Žan (1981). *Lingvistika i kolonijalizam*. Beograd. Biblioteka XX vek.
- KALVE, Luj - Žan(1995). *Rat među jezicima*. Beograd.
- KIMLIKA, Vil (1999). *Etnički odnosi i zapadna politicka teorija*. Nr. 1.Habitus, Novi Sad,
- PAVKOVIĆ, Aleksandar (1998). *Multikulturalizam kao uvod u rasparčavanju države: slučaj Jugoslavije: Sociološki pregled broj 2*.
- PETROSKA-BEŠKA V., KENIG N. & NAJAEVSKA M. (2001). *Our Neighborhood: Ethnic and Gender Stereotypes among Ten-Year- Old Children*. Search for Common Ground, Washington DC.
- ПЕТРОСКА-БЕШКА В. и КЕНИГ Н. (2002). *Сликата за сопствениот и за другиот етникум кај македонските и албанските студенти на Педагошкиот факултет во Скопје*. Зборник на Филозофскиот факултет-Скопје (55), 259-278
- ПЕТРОСКА-БЕШКА В. и КЕНИГ Н. (2005). *Негативните етнички стереотипи како фактор за формирање предрасуди кај идните воспитувачи и одделенски наставници*. Зборник на Филозофскиот факултет-Скопје (58), 87-99
- PHILLIPSON R. (1992). *Linguistic Imperialism*. Oxford:OUP.
- SINGLETON, D. (2007). *Globalization, Language and National identity: The Case of Ireland*. Trinity College Dublin: Centre for Language and Communication Studies, Occasional Paper No.68.
- SKUTNABB-KANGAS, T.(2000). *Linguistic Genocide in Education – Or Woldwide Diversity and Human Rights?* Mahwah, Nj:Erlbaum.
- SMMNA. (2009). *Studim për multikulturalizmin dhe marrëdhëniet ndëretnike në arsim*. UNICEF Zyra, Shkup Nëntor 2009.

## Abstrakti

*Studimi në lidhje me Interkulturalizmin dhe planifikimi gjuhësor në arsim paraqet një analizë të situatës aktuale në sistemin arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në lidhje me kapacitetet e tij që të promovojë dhe sigurojë respekt, tolerancë duke u bazuar në disa përvoja evropiane. Studimi shqyrton edhe perceptimet dhe nivelin e komunikimit ndërmjet nxënësve, prindërve dhe arsimtarëve maqedonas dhe nxënësve, prindërve dhe arsimtarëve shqiptarë. Qëllimi i studimit mbi Interkulturalizmin dhe adresimi i marrëdhënieve ndëretnike në arsim nëpërmjet reformave gjuhësore, kontribuon në ndërtimin e bazës për mirëkuptim të përbashkët dhe të ndërtimit të shoqërisë kohezive. Nxënësit janë të ngarkuar me stereotipe dhe paragjykime etnike (kryesisht pozitive për grupin e vet etnik, kurse negative për “të tjerët”), për të cilët ekziston mundësi e madhe të jenë të përkrahura prej arsimtarëve të cilët në mënyrë identike i perceptojnë bashkësitë etnike. Nga shteti, duhet të zhvillohen gjeostrategji sistematike gjuhësore në kuadër të planifikimit të shumëllojshmërisë gjuhësore në kontekstin e lidhjes së ndërsjellë brenda tendencave globale. Ndërsa një prej detyrave të shkollës është të përpunojë drejtime edhe për “përforcimin e vetëdijes së nxënësve për përkatësinë e vendit si shoqëri multikulturore”*

## Abstract

*The study on Interculturalism and Language Planning in Education is a detailed analysis of the current situation in the education system in Republic of North Macedonia, regarding its capacity to promote and ensure respect, tolerance based on some European experiences. The study also examines the perceptions and level of communication between Macedonian and Albanian students, parents and teachers. The purpose of the study is to address interethnic relations in education through language reforms, contribute to building the basis for mutual understanding and building a cohesive society. Students are burdened with stereotypes and ethnic prejudices (mostly positive about their ethnic group, and negative about “others”), for whom there is a strong possibility of being supported by teachers who perceive ethnic communities in an identical way. From the state, systematic linguistic geostrategies should be developed in the context of linguistic diversity planning and in the context of interconnectedness within global trends. While one of the tasks of the school is to develop directions for “strengthening students’ awareness of belonging to the country as a multicultural society.”*  
Keywords: interculturalism, multiculturalism, language planning, education, communication.

ISSN 2671-3004

UDC 316.723-021.463:005.336.2(091)  
Punim studimor**Rubin ZEMON**E-mail: [zemon.rubin@gmail.com](mailto:zemon.rubin@gmail.com)**ИСТОРИЈАТА, АНТРОПОЛОГИЈАТА И ИНТЕРКУЛТУРНИТЕ  
КОМПЕТЕНЦИИ****HISTORIA, ANTROPOLOGJIA DHE KOMPETENCAT  
NDËRKULTURORE****HISTORY, ANTHROPOLOGY AND INTERCULTURAL  
COMPETENCES****Увод**

Нацијата и етницитетот се докажаа кај најсилно лепило при градењето во држави во XIX век, но и како „дежа ву“ во последната деценија на XX век. На луѓето им треба мобилизирачки фактор, со што припаѓаат на големи групи, заедници, нации и други колективитети. (Атанасов П., 2017:116) Терминот национализам ја опишува лојалноста кон својата нација, гордост со својата историја и култура, верувањето дека нејзините интереси се од примарна важност и желба да ја остварат или да ја задржат својата независност. Национализмот се појави како политичка сила во доцниот 18-ти век, предизвикани од Француската револуција, и од тогаш идејата дека нациите имаат право да формираат сопствени политички држави ја обликувале мапата на Светот како што го знаеме денес. Во ниту една земја или време "нацијата" не е ништо друго освен моќна споделена идеја и никогаш не била повеќе од една идеја. Една држава може да се

дефинира според нејзините закони или граници, етничките групи можат барем да се сфатат статистички како дел од популација што ги танцуваат истите ора или народни танци, јаде иста традиционална или ритуална храна, зборува на ист јазик и се собира заедно за да се вклучи во тие активности. Нацијата е различна бидејќи постои само во главите на националистите. Првите националисти зборуваа за "заедничка крв", но ова не се вклопуваше добро со биолошкото спознание, иако продолжија да зборуваат за своите нации во квази-генетски услови. Почестото верување беше дека нацијата била духовна реалност - неодредена духовна врска што ги направила луѓето во своите души луѓе да бидат Французи, Германци, Италијанци или други. Пишувањата и говорите на националистите не оставаат сомнеж дека тие веруваат дека нацијата е таква духовна состојба, или можеби заедничка емоција. (McCarthy J, 2001: 38). Една од најприфатените дефиниции за нацијата е онаа на Адам Смит кој ја определува како "именуваната човечка популација со заедничка историска територија, заеднички митови и историски спомени, заедничка масовна јавна култура, заедничка економија и заеднички законски права и обврски на сите членови" (Smith AD, 1991: 30).

Нациите- држави се продукти на еден посебен историски развој во Европа, што беше овозможено со воведувањето и брзиот развој на капитализмот и капиталистичкиот начин на производство. Европските национални држави се развија истовремено со формирањето на модерни (етно) нации од XVI и XVII век. Во овој процес државите имаат стекнато етничка димензија и идентитет. Доминантните етнички заедници на одредени територии обично го одредуваат етничкиот идентитет на националните држави. Државите се сфаќаат како специфични или дури и единствените средства и механизми кои можат да обезбедат реализација на конкретни (национални) интереси на (етно) нациите. Европските држави беа воспоставени и сè уште се сметаат за национални држави на одредени нации - би можеле да речеме "единствени држави-нации". Овој концепт може да се објасни со едноставна равенка: Држава = нација = луѓе. (Žagar M., 2010: 172). Следејќи ги овие логички на националните држави нивната популација верува дека се етнички и културно хомогени ентитети. Како резултат на тоа, се роди митот за етничка хомогеност што го зацврстува верувањето дека нацијата-држава припаѓа на одредена

(етничка) нација. Митот за етничка хомогеност беше моќна сила во градењето на заеднички колективен, етнички заснован идентитет на територијата на одредена држава. Овој мит е основа за политичката идеологија на национализмот и често се експлоатираат од страна на националистичките движења и политичари. (Smith A.D., 1991: 194). Сепак, како што често се случува со митовите, митот за етничка хомогеност на националните држави не одговара на реалноста, а етничката или културната плуралност отсекогаш била реалност на повеќето територии и држави. Национализмот е ексклузивен и / или хегемоничен и е обично непријателски кон „другите“.

Процесот на создавање на нациите во Европа, како општествени и политички појави, е незамислив без развојот на филозофските науки и т.н. наука за антиката (Altertumswissenschaft). Впечатливо е тоа што некои од клучните водачи на полето на лингвистиката и историјата, како на пример Хумболт, Нибур и други, играле активна улога и во науката и како важни политичари на националната сцена. Така на пример тие сметале дека изучувањето на „антиката општо и Грците особено“ е начинот на кој ќе може да се интегрираат студентите и луѓето како целина. Во срцето на науката за антиката била претставата за божествените Грци, уметници и филозофи. Грците морале, како и идеализираната претстава за самите Германци, да се интегрираат со својата родна почва и да бидат чисти. Така, т.н. антички модел на изучување на историографијата, со своите голем број на иновации и чести позајмувања, како и со имплицитните последици од мешањето на расите и јазиците, се помалку можел да опстојува, и да се замени со т.н. Ариејвски модел, како што го нарекува Мартин Бернал во својата епохална книга Црна Атена. Со избивањето на Грчката војна за независност во 1820 година, Западна Европа била преплавена со национал-романтизам и филхеленизам, помешана со антиа-зиска и антиафриканска хеленоманија. (Bernal M., 2009: 263)

За постигнување на културна, верска и етничка разновидност на Балканот, националната идеја и национализмот беа рецепти за прекршување. Дури и австрискиот министер за надворешни работи во 1853 година, предупреди дека "воспоставувањето на нови држави според границите на националноста е најопасниот од сите утопистички шеми" (Mazower M. 2000: 149). Со процесите на создавање национални држави, во исто време се појавија и прашања на малцинствата

(на почетокот беа религиозни, но подоцна етнички или национални) нивните статуси во новите национални држави, заштита на нивните религии, култури и јазици, како и други социјални и политички права.

Во 1997 година Марија Тодорова, професор на Универзитетот во Илиноис во САД, ја објави својата студија "Замислувајќи на Балканот", која предизвика многу дебати меѓу академските, политичките, новинарските и другите кругови. Навистина, нејзината студија се занимава со неконзистентни (но обично негативни) слики за регионот во западната култура, како и со парадоксите на културната референца и нејзините претпоставки. Во неа, таа развива теорија на балканизам или „гнездење на балканизмите“, слично на "ориентализмот" на Едвард Саид и "Гнездниот ориентализам" на Милица Бакиќ-Хајден. Во една прилика Марија Тодорова за книгата рече дека "Централната идеја на "Замислувајќи го Балканот" е во тоа дека постои дискурс, кој го нарекуваме балканизам, кој создава стереотип за Балканот, а политиката е значително и органски испреплетена со овој дискурс. Кога се соочуваат со оваа идеја, луѓето може да се чувствуваат малку непријатно, особено на политичката сцена ... ". [www.1]. Една од предрасудите и стереотипите поврзани со Балканот и балканизмите е релативизмот на невиноста на Западна Европа и префрлањето на одговорноста на Отоманската Империја (наследство) и на Турција како "дежурен виновник" за сите обвиненија и грешки (Todorova M. 1997: 276) кои се случиле на Балканот во XX век.

Всушност најважниот термин кој произлегува од зборот "Балкан" е "балканизацијата". Овој термин што многу често се користи во описите на процесот на национална фрагментација на поранешните географски и политички единици во нови проблематични национални држави, всушност не е создаден во "најдолгиот век на Империја" кога балканските нации чекор по чекор се одделуваат од Отоманската империја. Терминот "балканизација" беше донесен при крајот на Првата светска војна, кога само една балканска држава - Албанија, беше додадена на веќе постоечката мапа на балкански народи, создадени во 19. век (Todorova M., 1997: 46). Различни научници и политичари го користеа терминот "балканизација" по Првата светска војна како процес на фрагментација во мали држави со нарушени политички односи, како што е случајот со Балканот за време на балканските војни. Но, подлабока анализа на

"балканизацијата" се случи во 1921 година, од страна на Пол Скот Моуер, европски дописник на Чикаго Дејли Њуз. Анализирајќи ја политичката ситуација во Австрија, Унгарија, Бугарија, Чехословачка, Полска, Романија, Југославија и Грција, тој заклучи дека овој регион "сега е балканизиран". Неговата оправданост на терминот "балканизација" е дека "во регионот на безнадежни мешани раси, создавање на врски на мали држави со повеќе или помалку назадно население, економски и финансиски слаби, завидливи, со заговорничко однесување, исплашени, постојани жртви на манипулации од моќта на големите, како и насилниот излив на сопствените страсти ". Елементот на странски инволвирања во внатрешните работи на малите држави е толку агресивен што го мотивираше Мајкл Фучер во 1994 година да ја дефинира "балканизацијата во буквална смисла на зборот како постојано вклучување на странските сили (Русија, Австро-Унгарија, Германија, Франција и Велика Британија) насочени кон заштита или воспоставување на нивните сфери на интереси " (Todorova M., 1997: 49).

Поимите припишани на "Балканот" го откриваат процесот на создавање на имиџот во Европа дефинирајќи го "Другиот" како ориентален, непредвидлив, опасен, хаотичен, валкан, мрзлив, примитивен, суров, себичен, некооперативен итн. (Mursic R. & Jezernik B., 2007: 7). Од друга страна, историските докази го потврдуваат присуството на толеранција, соработка, напорна работа, античка култура, цивилизации, урбанизација, класична филозофија, прединдустриска економска ефикасност итн. Со векови Балканскиот Полуостров беше речиси единствениот дел од Европа со традиција на толеранција кон луѓе од различни религии, етничко потекло и култури. Балканските народи живееле во мултикултурно милје долго пред да стане модерно на Запад. Во 1492 година, кога Сефардиските Евреи биле протерани од Иберискиот Полуостров од страна на Католичката црква, Балканскиот Полуостров, кој во тоа време бил под Отоманската Империја, бил толерантно место каде што Евреите ја најдоа новата земја за живеење. (Vembesa E. & Rodrigue A., 2002: 79-96)

Во процесот на "либерализација" на "поборените народи" во XIX век, толеранцијата и мирениот соживот беа првите жртви на наметнувањето на западните концепти како што се либералната демократија, капитализмот, националната држава и слично. Национализмот, плановите за изградба на пост-

отоманската империја и постојаното прецртување на постојните политички граници на Балканот станаа процес на "балканизација". Сепак, се чини дека балканизацијата на регионот е всушност резултат на европеизација и вестернизација. (Mursic R. & Jezernik B., 2007: 8).

Сегашната политичка мапа на Балканот претставува триумф на проектот „држава- нација“ и вклученост во процесите на фрагментација, паралелно со процесите на глобализација и европеизација. Како што вели Петар Атанасов изгледа дека културниот плурализам не е една од победничките категории во овој политичко – историски натпревар. Победникот е политичкото (и културното) единство на малите и средните држави- нации, за чии интереси, во минатото и денес се жртвуваат интересите на повеќе или помалку познати и различни етнички и културни групи. Главната причина за распадот на СФР Југославија беше „натпреварот“ помеѓу српскиот, хрватскиот и словенечкиот национализам. Но, освен националните држави, се појавија и три признати и една полу-признаена, мултикултурни или граѓански држави –Македонија, Босна и Херецеговина, Црна Гора и Косово. Овие четири држави се исклучоци од политичката матрица на Балканот денес. Иднината на Балканот и на овие четири држави зависи од два други контексти: регионалниот и европскиот. Регионалниот контекст не е наклонет кон граѓанскиот концепт и мултикултурното општество, затоа што промовира концепт на држави-нации со етнички предзнак. Од друга страна, европската интеграција ги релаксира политичките и културните групи, а на моделите на кохабитација им се дава шанса за успех. (Атанасов П., 2017:116-119)

Познатиот британски социолог Ентони Гиденс, во својата кратка но влијателна книга „Светот што ни бега“ (“Runaway World”), вели дека ние живееме во времето на глобализацијата, чии контури бледо ги гледаме, но појавите и процесите во Светот се движат и се менуваат толку бргу, што ни бега контролата на нашиот живот од нашите раце, односно живееме во Свет што ни бега. Нашата епоха се разви под влијание на науката, на технологијата и на рационалната мисла, кои потекнуваат од Европа од XVII и XVIII век. Просветителските филозофи дејствуваа по едно едноставно, но моќно упатство: „Колку повеќе можеме рационално да го разбереме Светот и

самите себе, толку повеќе ќе можиме да ја обликуваме историјата за наши сопствени цели“. Карл Маркс пак, оваа идеја ја формулираше многу едноставно: „Ние мораме да ја разбереме историјата, за да можеме да ја создаваме историјата“. (Giddens A., 2003: 1-2)

Од друга страна Франсис Фукујама во 1992 година ќе ја напише епохалната студија „Крајот на историјата и последниот човек“, кој тврди дека Светот го достигнал консензусот за легитимноста дека либерал -демократијата е „најдобар“ систем на владеење, ослободена од тековите и длабоките контрадикции што воделе до пропаѓање. Според него, либерал-демократијата е крајната цел на еволуцијата на идеологиите, водилка на човековите активности и максимумот што современиот човек може да го достигне. Употребата на зборот „историја“ го објаснува дека не треба да се разбере како грешка што излегува за ново маркантно или длабоко дело, како стопирање на времето, или некој вид на апокалиптична катастрофа, со која човештвото ќе замре, туку едноставно е достигнат крајот на историјата како единичен, кохерентен, еволуционен процес, што ќе ги земе во предвид искуството на сите народи од сите времиња. (Fukuяama F., 1994)

На прв поглед, расправите во либералните теории за реконцептуализација на културите и границите помеѓу нив не упатува на пристап кој во либералната парадигма е отворен и теориски неограничен. Се почесто сме склони да заклучуваме дека во услови на развиени општествени мрежи, доминацијата на англискиот јазик и силниот технолошки развој, забрзано се бришат и се потиснуваат разликите помеѓу културните и етничките групи. Логичното продолжување на „Крајот на историјата“, како конечна победа на либералната теорија и пракса, е расправа за почеток на крајот на културните разлики. При тоа, лесно се испушта од вид дека технолошкиот развој, напредните облици на комуникација и современиот транспорт предизвикаа „будење на етницитетот“ во втората половина на XX век, како и тоа дека етницитетот, како облик на општествена организација, кога и да бил загрозен, покажа голема виталност, а често и развојни и креативни аспекти во својата природа. (Башић Г., 2016:51)

Исто така неопходно е да се согледаат процесот на ревитализација на влијанието на религиите и значењето што тие го имаат во зачувувањето и врз современите промени на

етно -културните идентитети и нивните интеракции. Предвидувањата дека секуларната либерална држава, религиите ќе ги смести исклучиво во приватната сфера и дека ќе и им го одземе колективното значење, преку признавање на вероисповеста како човеково право што е предмет на слободен избор, се повеќе е подложно на преиспитување. Ова уште повеќе што поедини групи и заедници, особено во дијаспората, својот етно-културен идентитет го развиваат околу верата. Акултурацијата која се огледува во промената на начинот на исхрана и облека, односот кон бракот и положбата на жената, или заборавање на јазикот на предците, не успеала да влезе во верата и да ја помести од јадрото што е цврсто упориште на одржување на врските со матичната земја и зачувување на етно-културниот идентитет. (Башић Г., 2016:53)

Зигмунт Бауман во суштина се согласува со фактот дека неизвесноста во општеството бара од повеќето поединци постојано да се вклучат во "изградбата на идентитетот", но тој, исто така, укажува дека богатите и моќните се оние што создаваат и имаат корист од нестабилен, брзо менувачки свет и дека овие луѓе се многу способни да се бранат од негативните последици од живеењето во бегство.

Зигмунт Бауман, кој ја претстави идејата за течната модерност, напиша дека неговите карактеристики се однесуваат на поединецот, имено зголемување на чувствата на неизвесност и приватизација на амбивалентноста. Тоа е еден вид на хаотично продолжување на модерноста, каде што едно лице може да се префрли од еден општествен контекст во друг, на „течен начин“. Мобилноста станува општа особина на "течниот современик", со што тој тече низ својот живот како турист, менувач на работни места, сопружник, вредности, а понекогаш и повеќе - како што е политичка или сексуална ориентација - исклучувајќи се од традиционалните мрежи на поддршка, истовремено ослободувајќи се од ограничувањата или барањата што ги наметнуваат тие мрежи. [www.2]

Бауман го нагласи новиот товар на одговорноста дека флуидниот модернизам поставен на индивидуално-традиционалните модели ќе биде заменет со моделите што се самоизбираат. Влезот во глобализираното општество беше отворен за секој со свој став и способност да го финансира, на сличен начин како и приемот на патници во старомодните каравани. Резултатот е нормативен начин на размислување, со акцент на

промените, на привременото, наместо постојаното (или "цврстото") залагање - што може да го наведе лицето кон ограничување и затварање на сопствената егзистенцијална креација. [www.3]

\*\*\*

Во еден ваков контекст на ревизија на „крајот на историјата“, на излегување од имиџот на Балканот и балканизацијата, каде и се дава повторна шанса на кохабитацијата на различните етнички, културни, јазични, религиозни и други групи, во време на „Светот што ни бега“, и живеење во “ликвидна (течна) модерност“, историографијата и историјата ослободена од т.н. ариевски модел, со пристап кон развој на мултикултурно општество и интер-културната толеранција и комуникација, треба да има мошне важна улога во воспоставување и развојот на „вечниот мир“ на Балканот. Се разбира консолидацијата на историскиот наратив и терминологија, преточен во „консензуален политички коректен модел“ за сите групи и идентитети на Балканот е една од најважните мисии на сите балкански држави, но и пошироко во соседните земји и во Европа. Преминот од национална или локална кон универзална историја, како синтеза на сите хумани настани и периоди на Балканот и пошироко, треба да биде една од стратешките приоритети на балканската историографија (Туфан М. 2008: 789-799). Усогласувањето на политички коректниот историски наратив и терминологија кон националните и другите малцинства и ранливи категории во секое политичко општество на Балканот е една од столбовите кон постигнувањето на целта кон универзална историја. При тоа отворените демократски расправи за културните разлики во општество, за признавање на разноликоста на општеството, признавањето на различните идентитети треба да им се овозможат на граѓаните и да разјаснат кои традиции и колективни мемории сакаат да ги негуваат, со кои сакаат да раскинат, каков однос сакаат да имаат кон својата историја, помеѓу себе, кон разноликото општество и како понатаму.

Свесните субјективни сили кај балканските народи и малцинства се исправени пред уште еден предизвик, смирено и во духот на толеранцијата и мирот да размислат дали да му дадат приоритет на нацијата како замислена заедница и на национализмот, кој на Балканот лесно се трансформира и во национал-шовинизам, или на патриотизмот и љубовта кон

своето поднебје, поврзаност за земјата во која човекот се раѓа, расте, развива, умира и се погребува, поднебје прифатено со реалниот диверзитет без митови за етничка или национална хомогеност и супериорност, или пак со илузиите „за избраниот народ“ или „супер човек“ . Тоа е значајна претпоставка и предизвик за балканската историографија и етнологија т.е. антропологија.

На патот кон градење на едно толератно општество неопходна помош може да ни даде образованието за интеркултуралимот по пат на јазикот. При тоа особено треба да се даде значење на мешовитите школи, на која посебно се негува почитувањето на различноста на јазиците, убедувањата и вредностите, како и осетливоста за културните специфичности. При тоа една од вредностите што би се оценувала кај учениците или студентите е *интеркултурната комуникативна способност*. Станува збор за двофазна оспособеност кон јазичните можности: од јазикот во мозокот, преку јазикот во употреба во еднојазичната заедница, се оди кон јазик во размена на културните содржини помеѓу јазичите заедници. (Бугарски Р., 2016: 114).

#### Библиографија:

- Атанасов П., 2017, Македонски мултиетнички јазли: Битка за едно или две општества, Просветно дело, Скопје
- Bauman Z., 2000. Liquid modernity. Polity, Cambridge
- Bembesa E. & Rodrigue A., 2002, Histoire des Juifs sephardes De Toleda a Salonique, Edition du Seuil. Translated on Macedonian by Terzijan- Malenkova M., 2011, Slovo, Skopje.
- Bernal M. 1987, Black Athena- The Afroasiatic Roots of Classical Civilization, Vol. 1 The Fabrication of Ancient Greece 1785-1985, London. (Прев. На македонски Табернакул 2009).
- Башић Г. 2016, Етнокултурни идентитети- политике признања и праксе опстанка, во Стање и претепктиве мулткултурализма у Србији и државана региона, Институт друштвених наука, САНУ, Београд
- Бугарски Р, Језик, мултикултурализам и интеркултурализам, во Стање и претепктиве мулткултурализма у Србији и државана региона, Институт друштвених наука, САНУ, Београд

- Fukuyama F., 1994, *The End of the History and the Last Man*, Kultura, Skopje (на македонски јазик)
- Giddens A., 2002, *Runaway World: How Globalisation is Reshaping our Lives*, Profile books Ltd, London (превод на македонски Гиденс Е., 2003, *Забеган Свет: Како глобализацијата ги преобликува нашите животи*, Филозофски факултет, Скопје)
- Mazower M. 2000, *The Balkans- A short History*, Widenfeld&Nicolson Book, UK
- McCarthy J., 2001, *The Ottoman Peoples and the End of Empire*, Oxford University Press, New York
- Mursic R. & Jezernik B, 2007, *The Balkans in/and Europe*, in: Jezernik B., Mursic R and Bartulovic A. (ed.) *Europe and its Other*, Department of Ethnology and Cultural Anthropology, Faculty of Arts, University of Ljubljana
- Smith A. D., 1991, *National Identity*, Penguin Books Ltd, London, 1991. Translated on Serbian by Slobodan Djordjevic, 1998, XX vek, Beograd.
- Todora M. 1997, *Imaging the Balkans*, Oxford University Press, Inc. New York, USA, translated on Macedonian by. Isakoski I. & Volnaroski P., 2001, Magor, Skopje.
- Туфан М. 2008, *Историографија- Усогласување на историската терминологија*, во: *Институт за национална историја, Транзициите во историјата и културата, меѓународна научна коференција*, Скопје, 789-799.
- Žagar M., 2010, *Some Newer Trends in the Protection and (Special) Rights of Ethnic Minorities: European Context*; in *Minorities for Minorities*, Center for Peace Studies, Zagreb.

Интернет линкови:

[www.1] [http://en.wikipedia.org/wiki/Maria\\_Todorova](http://en.wikipedia.org/wiki/Maria_Todorova)

[www.2] <https://revisesociology.com/2016/08/07/zygmunt-baumans-liquid-modernity-summary/>

[www.3] <http://routledgesoc.com/category/profile-tags/liquid-modernity>

### **Abstract**

*The paper tackle the issue of historiography and anthropology especially in the Balkans as vital and often missing components in understanding the contra-verses of a contemporary time. In doing so, it argues that the construction of nation identities as 'polarized collective identities' which accentuate perceived (cultural) differences play an integral role in shaping how we identify and respond to emerging threats. Furthermore, it is suggested that the construction and maintenance of these identities not only has a tendency to homogenize populations, but also creates antagonistic and conflict-orientated relationships resistant to resolution.*

*Author is proposing that Balkan historiographies and anthologists have to leave the concept where the focus and priority is given to the nation, national identities and nation-states, and attention has to be directed toward to studying of universal Balkan history with using of 'consensual political correct model' (narrative and terminology), as well as nationalism to be replaced with patriotism (love to the land where citizens are living with accepting of all diversities in a society).*

ISSN 2671-3004

UDC 35:316.723-021.463(497.7)  
Punim studimor**Ajten HAJDARI-QAMILI**

Universiteti “Shën Kirili e Metodi” – Shkup,  
Fakulteti i Filologjisë “Bllazhe Koneski”,  
Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare  
e-mail: **teni79@yahoo.com**

**ITERKULTURALIZMI NË INSTITUCIONET PUBLIKE NË RMV****ИНТЕРКУЛТУРАЛИЗМОТ ВО ЈАВНИТЕ ИНСТИТУЦИИ НА РСМ****INTERCULTURALISM IN PUBLIC INSTITUTIONS IN RNM****Hyrje**

Ne njohuritë dhe botëkuptimet tona të kufizuara i përcaktojmë brenda kufijve të gjuhës që e njohim dhe përdorim. Leksiku gjuhësor mund të këmbehet me një gjuhë tjetër, edhe pse jo tërësisht, sidoqoftë, dy folës që flasin dy gjuhë të ndryshme, mund të komunikojnë mes veti përmes interpretimit. Arsyeja e botëkuptimit dhe ndërgjegjes sonë në një gjuhë të caktuar është e kufizuar, jo sepse nuk e njohim plotësisht leksikun e asaj gjuhe, por për shkak të faktit se leksiku i cilësdo gjuhë ndryshohet dhe modifikohet me kalimin e kohës.

Kur korniza apo struktura e një gjuhe plekset me amalgamin e saj kulturor, bëhet unikate. Prandaj njohuritë dhe botëkuptimet tona kur ne ballafaqohemi me botën, gjegjësisht me “tjetrin”, mbështeten në gjuhën apo në gjuhët që i njohim dhe përdorim. Bota ekziston vetëm e tillë siç ekziston në gjuhë, jashtë gjuhës bota sikur zhduket. Po, ku, konkretisht, mbështetet skeleti i një gjuhe? Ai mbështetet në përbërësit gramatikorë, strukturën dhe shprehjen; konceptet

gjuhësore, përjetimet fizike dhe emocionale, idiomat, frazeologjizmat, aksiomat (thëniet e vetëkuptueshme), truizmat (të vërtetat e rëndomta), përshkrimi i fjalëve dhe njerëzve; faktori kohë (e shkuara, e tashmja, e ardhmja); gjuha e trupit (gjesti, mimika, largësia hapësinore e komunikimit); pasthirrat, theksi, intonacioni, melodia; kuptimi (konotacioni + denotacioni); kultura, religjioni etj.<sup>11</sup> Nëse të gjitha këto elemente dhe faktorë vështrohen në aspekt psikolinguistik, do të shohim se ndryshe bashkëveprojnë te folësit njëgjuhësh, dygjuhësh dhe shumëgjuhësh.

Jetojmë në një "çast hibrid", në një kulturë heterogjene bashkohore. Dallimi qëndron te secili prej nesh, kjo ndryshueshmëri e përbën tërësinë. Për gjuhën dhe për qenësoren nuk ekziston kod, strukturë, gjuha është dallimi vet, e cila funksionon vetëm përmes lojës shekullore që gjallëron me kohën. Gjuhën të cilën e dëgjojmë shpesh apo vazhdimisht, edhe nëse nuk është gjuha jonë amtare, ne nuk e llogarisim si të huaj. (p.sh. për shqiptarët maqedonishtja, serbishtja apo për emigrantët gjuhën e vendit ku jetojnë).

Gjatë të mësuarit të një gjuhe të huaj, është e nevojshme të përdorim me kujdes fjalët dhe kontekstin në të cilin ato përdoren, sepse një fjalë në dy gjuhë të ndryshme nuk do të thotë i njëjti objekt ose koncept. Një gabim i madh mund të bëhet nëse disa fjalë dhe shprehje përdoren fjalë për fjalë, sepse kjo mund të çojë në konflikt ose fyerje. Për shembull, gishti tregues i bashkuar me gishtin e madh në ShBA tregon se diçka është "në rregull", në Francë "zero", në Brazil një fyerje, kurse në Japoni "para".

### Shtjellimi

Me synim që të kontribuojë në promovimin e kushteve të barazisë, drejtësisë dhe gjithëpërfshirjes, barazisë midis burrave dhe grave, përfshirjen e identitetit të ndryshëm, komunitetet kulturore, etnike dhe grupeve të cenuara ose të marginalizuara në shoqëri, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në tetor të vitit 2018, në seancën e saj të 162-të miratoi Strategji kombëtare gjithëpërfshirëse për zhvillimin e konceptit të një shoqërie dhe interkulturalizmit.<sup>12</sup> Në këtë strategji u përshinë: 140 organizata joqeveritare, 5 qendra universitare dhe u organizuan 8 debate. Strategjia përfshin shtatë fusha që janë thelbësore për interkulturalizmin, gjegjësisht kornizë

<sup>11</sup> Ajten Hajdari – Qamili, *Perla gjuhësore*, Shkup, 2018, f. 229.

<sup>12</sup> <https://vlada.mk/node/19447>

ligjore, arsimit, media, kultura, kohezioni social, rinia dhe vetëqeverisja lokale.<sup>13</sup>

Koncepti i strategjisë është vendosur në përputhje të plotë dhe respektim të angazhimeve dhe rekomandimeve ndërkombëtare të organizatave kyçe ndërkombëtare, të tilla si Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës dhe organet e tij dhe në përcaktimet politike të OSBE-së “Kahëzimet nga Lubjana për integrimet e shoqërive të llojllojshme” në Komisararin e Lartë për pakicë nacionale të OSBE-së nga viti 2012.<sup>14</sup>

Konferenca ndërkombëtare "Drejt konceptit të një shoqërie dhe interkulturalizmit", në organizim nga zyra e Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Misionit të OSBE-së në Shkup, që u mbajt më 03. 10. 2019 në Shkup, është organizuar për të siguruar një platformë të gjerë për diskutim mbi Strategjinë kombëtare për të zhvilluar konceptin e një shoqërie dhe interkulturalizmin midis përfaqësuesve të institucioneve shtetërore dhe organizatave ndërkombëtare, komunitetit akademik dhe shoqërisë civile.

Në fillim të vitit 2020, në Universitetin e Evropës Juglindore, u mbajt debati rreth tekstit të Strategjisë Kombëtare për zhvillimin e konceptit të një shoqërie dhe interkulturalizmit, përmes të cilit synohet reduktimi i stereotipave, paragjykimeve dhe gjuhës së urrejtjes. Organizatorët e debatit thanë se duhet investuar më shumë te të rinjtë për të larguar stereotipat dhe paragjykimet etnike, kulturore e fetare. Në këtë debat, Robert Allajgjozovski tha se duhet të bëhet i detyrueshëm mësimi i gjuhës maqedonase për komunitetet e tjera, por edhe maqedonasit ta mësojnë gjuhën e komuniteteve. Reduktimi i mosdurimit, stereotipave etnike, eliminimi i gjuhës së urrejtjes te të rinjtë, te grupet e tifozëve, në media, ishte një nga rekomandimet kyçe në fjalimin e tij. Kurse rektori i UEJL-së, Abdylmenaf Bexheti tha se “Si universitet në këtë aspekt ne vazhdojmë të japim kontributin tonë në shoqëri për avancimin e marrëdhënieve shoqërore, posaçërisht ato interkulturore dhe toleranca të caktuara. Këtu modeli i UEJL-së ka çka të prezantojë dhe mund të jetë tamam një model në miniaturë për një shoqëri, për një shtet se si mund dhe si duhet të funksionojë toleranca ndërkulturore dhe avancimi ndërkulturor”.<sup>15</sup>

<sup>13</sup> <https://vlada.mk/nacionalni-strategji>

<sup>14</sup> <https://vlada.mk/node/19147?ln=sq>

<sup>15</sup> Më gjerësisht për këtë shih në: <https://flaka.com.mk/interkulturalizmi-allagjozovski-te-mesojme-gjuhen-e-njeri-tjetrit/>

Edhe Universiteti “Nënë Tereza” është hera e tretë që organizon Konferencë Ndërkombëtare Shkencore për Interkulturalizmin; dhe qoftë për nga gjuhët që përdoren gjatë ligjëratave, qoftë për nga përkatësia kombëtare e studentëve dhe profesorëve, ky universitet mund të shërbejë si shembull për të mirë në ngritjen e vetëdijes së shoqërisë për interkulturalizmin.

Ndërkaq, Universiteti “Kirili dhe Metodi” në mënyrë shumë diplomatike refuzoi bashkëpunimin me Qeverinë për të realizuar debatin për interkulturalizëm dhe nuk pranoi që ky debat të zhvillohet në hapësirat e universitetit. Kurse katedrat e gjuhëve të huaja të Fakultetit të Filologjisë marrin pjesë në shumë aktivitete lidhur me interkulturalizmin e gjuhëve botërore, përmes projekteve të ndryshme dhe asnjëherë nuk është përfshirë shqipja dhe gjuhët e kulturat e bashkësive të tjera etnike të RMV-së, por vetëm gjuhët dhe kulturat e huaja me maqedonishten.

Një hap përpara drejt interkulturalizmit u bë më 03. 06. 2019, kur u krijua Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politikat rinore në të gjitha nivelet, ku u përfshi multikulturalizmi, interkulturalizmi dhe inkluziviteti në pjesëmarrjen aktive të të rinjve edhe në aktivitetet sportive. Objekti i rregullimit i këtij ligji janë format e organizimit rinor, pjesëmarrja e të rinjve në procesin e krijimit të politikave rinore dhe në marrjen e vendimeve që u takojnë po atyre, dokumentet strategjike në nivel kombëtar dhe lokal, si dhe aktivitetet dhe masat që ndërmarrin organet e udhëheqjes së shtetit dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale për avancimin e pozitës së të rinjve në shoqëri, si dhe informimi dhe planifikimi i përbashkët i aktiviteteve që lidhen me dhe për të rinjtë.<sup>16</sup>

Sistemi arsimor i RMV-së gjendet para një sfide të madhe për zhvillim të parakushteve për arsim interkulturalor, si një qasje afatgjate edukativo-arsimore me plan, e cila do t’u përgjigjet nevojave të kontekstit tonë shoqëror, ku në të njëjtën hapësirë bashkëjetojnë më shumë bashkësi etnike dhe pritet në vazhdimësi të zhvillojnë lidhje dhe relacione kulturore në më shumë drejtime. Arsimi interkulturalor, si filozofi dhe si qasje, duhet të jetë mjeti kryesor në procesin e inicimit dhe mbështetjes për ndërtim të marrëdhënieve interaktive dhe harmonike në bashkësi. Për shkak të barazimit të shpeshtë është e domosdoshme të kufizohen nocionet: shoqëri/arsim multikulturalor dhe interkulturalor. Multikulturalizmi

---

<sup>16</sup> <http://www.zakonzamladi.ams.gov.mk/nekategorizirano/propozim-ligji-per-pjesemarrjen-rinore-dhe-politikat-rinore/>

versus interkulturalizmit në fakt nënkupton se kemi të bëjmë me dy koncepte shoqërore, ndërmjet të cilëve vërehet dallim i rëndësishëm cilësor, gjegjësisht dallon shkalla e interaksionit ndërmjet grupeve të ndryshme kulturore në kuadër të një bashkësie shoqërore. Multikulturalizmi thekson ekzistimin e më shumë kulturave në një hapësirë gjeografike, të cilat nuk kanë medoemos kontakt dhe bashkëveprim të përditshëm dhe të vazhdueshëm. Nga ana tjetër interkulturalizmi nënkupton raporte dhe lidhje të hapura të bashkëveprimit ndërmjet grupeve të ndryshme kulturore, nacionale etj., të cilat besojnë dhe njëkohësisht promovojnë vlera siç janë: toleranca, respekti i ndërsjellë, barazia dhe komunikimi i hapur. Arsimi interkulturore duhet të organizohet me qëllim që të realizohet detyra e ndarë në më shumë shtresa, gjegjësisht, arsimi për empati, solidaritet, respekt interkulturore dhe mënyra e të menduarit jonacionalist. Pra, ky lloj i arsimit ka të bëjë me bashkimin, solidaritetin, tolerancën e ndërsjellë, ndihmën, besimin dhe vlerat e tjera humane.<sup>17</sup> Mu për këtë arsye, arsimi interkulturore duhet të perceptohet si nevojë për shoqërinë tonë, sepse në të duhet të dallohet mundësia për përballje me sfidën në gjetjen e raportit optimal të ndërsjellë ndërmjet diversiteteve kulturore dhe kohezionit shoqëror.<sup>18</sup>

Qëllimet e arsimit interkulturore duhet ta iniciojnë ndryshimin dhe avancimin e praktikës edukativo-arsimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes transformimit personal dhe institucional, si bazë për ndryshime më të gjera shoqërore për të ardhmen.

Qëllimet globale të arsimit interkulturore janë:

- Ndërtimi i politikave arsimore dhe strategjive për mundësi të barabarta për të gjitha sferat e veprimtarisë edukativo-arsimore;
- garantimi i të drejtave të secilit individ në kontekst të diversitetit kulturor;
- promovimi i tolerancës, besimit të ndërsjellë, respektit, barazisë dhe mosdiskriminimit në bashkësitë dhe mjediset multikulturore;
- mundësimi i participimit social të secilit individ në bashkësinë interkulturore;

<sup>17</sup> Концепција за интеркултурно образование (2016). Скопје: МОН, (<http://www.mon.gov.mk/images/Koncepcija-mk.pdf>)

<sup>18</sup> Qendra për Dialog Nansen Shkup, Nansen Qendra për Trajnim për arsim interkulturore, *Doracak për arsimtarë, si deri te arsimit interkulturore*, Shkup, 2018, f. 12.

- kultivimi i dialogut ndërmjet subjekteve edukativo-arsimore me përkatësi të ndryshme etnike, gjinore, sociale, kulturore, fetare dhe gjuhësore;
- realizimi i kohezionit social dhe bashkëjetesës paqësore.
- zhvillimi i empatisë ndaj tjetrit, si bartës i tipareve të ndryshme kulturore, sociale, gjuhësore, fetare;
- nxitja dhe kultivimi i mendimit kritik në veprimtarinë edukativo-arsimore si faktor për krijimin e ambientit shoqëror demokratik, social dhe të drejtë;
- krijimi i mjedisit të sigurt interkulturore dhe inkluziv parashkollor dhe shkollor.
- krijimi i formave të ndryshme të bashkëpunimit interkulturore ndërmjet institucioneve edukativo-arsimore dhe bashkësisë lokale.<sup>19</sup>

Qëllimet globale të arsimit interkulturore bazojnë operacionalizimin dhe realizimin e tyre të drejtpërdrejtë në këto detyra:

- ndërmarrja e iniciativave integruese, interkulturore me karakter edukativo-arsimor në përputhje me nevojat reale të shkollave multikulturore;
- zhvillimi i mekanizmave dhe praktikave për veprim të paanshëm dhe jodiskriminues në të gjitha segmentet e procesit edukativo-arsimor;
- sigurimi i kushteve për krijim të diversitetit multilingual dhe kulturor në entet parashkollore dhe nëpër shkolla;
- zhvillimi i shkathtësive për komunikim të hapur, të drejtpërdrejtë dhe konstruktiv si dhe për bashkëpunim ndërmjet subjekteve edukativo-arsimore;
- aftësimi i të gjithë nxënësve në procesin edukativo-arsimor për zgjidhje paqësore dhe transformim të situatave konfliktuoze;
- sensibilizimi i subjekteve në sferën edukativo-arsimore për njohje të burimeve të paragykimeve dhe stereotipave, si dhe disenjimi i strategjive për tejkalim të suksesshëm të tyre;<sup>20</sup>

Përfundimet që dalin nga ky studim thonë se, shpeshherë sipas vlerësimeve të praktikuesve edukativo-arsimorë konsiderohet se përmes veprimtarisë edukative interkulturore në mësimin e rregullt do të merret shumë kohë, gjegjësisht do të anashkalohen përmbajtjet mësimore me karakter obligator; por përkundrazi, arsimit interkulturore, i cili realizohet në mënyrë të planifikuar, sistematike

---

<sup>19</sup> Po aty f. 14.

<sup>20</sup> Po aty, f. 15.

dhe të rregullt mund nga njëherë të integrohet në një lojë të shkurtër hyrëse, në ndonjë aktivitet përfundimtar që zhvillohet me nxënësit në grupe ose në dyshe, si pjesë e ndonjë situatë problemore ose mund me shkathtësi të futet përmes një video sekuençe të shkurtër, pikës muzikore, serisë së fotografive ose ndonjë lloj të caktuar të resurseve tjera didaktike etj.<sup>21</sup>

Për të shmangur improvizimet e mundshme në funksionalizimin e qëllimeve dhe detyrave të edukimit interkulturore, është e nevojshme të krijohet një qasje profesionale, e planifikuar dhe ekipore ndërkurrikulare nga stafi mësimdhënës, shërbimet profesionale dhe udhëheqësia e shkollës, të cilat p.sh. në nivel të aktiviteteve profesionale do të hartojnë plane të përbashkëta për arsimin interkulturore, të cilat më pas do jenë komponentë të strukturuar të strategjive interkulturore (afatshkurtra dhe afatgjata) të vetë shkollave.<sup>22</sup>

Metodat e dialogut, ilustrimit, demonstrimit, punës praktike e të ngjashme janë aparaturë metodike, e cila lehtë do të mundësojë që përmbajtjet, aktivitetet të cilat janë pjesë e procesit të rregullt arsimor, të avancohen me elemente interkulturore. Gama e teknikave arsimore do t'i pasurojë edhe më shumë aktivitetet, duke ua mundësuar nxënësve të zhvillojnë qasje aktive ndaj përmbajtjeve, por njëkohësisht edhe do të iniciojnë përdorimin e materialit të pasur didaktik, si dhe stimulim, kultivim të klimës pozitive-emocionale në grup, gjegjësisht në grupe. Është absolutisht e panatyrshme që arsimi interkulturore të barazohet me procesin e mësimdhënies, në vend se të barazohet me zhvillimin e shkathtësive për komunikim të hapur, konstruktiv, zgjedhje paqësore të situatave konfliktuozë, tejkallim të anësisë, stereotipave, paragjykimeve, kultivim të mendimit kritik etj.<sup>23</sup>

Një hulumtim tjetër në këtë fushë ka bërë Ministria e Arsimit dhe Shkencës, gjegjësisht *Hulumtimi i teksteve shkollore, të cilat përdoren në procesin mësimor me nxënësit prej klasës së parë deri në të pestën të arsimit fillor nëntëvjeçar*. Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë të vëzhgohet përfaqësimi dhe mënyra e pasqyrit të karakteristikave kulturore dhe interaksionit midis bashkësive të ndryshme etnike të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, lidhur me përfaqësimin e përmbajtjeve multikulturore sa i

<sup>21</sup> Po aty, f. 16.

<sup>22</sup> Po aty, f. 38.

<sup>23</sup> Diana Djaloshi, Pasqyrimi i elemnteve kulturore në gjuhë dhe ligjërim, Tiranë, 2019, f. 1.

(<http://www.anglisticum.org.mk/index.php/IJLLIS/article/view/88/1619>)

përket kontekstit më të gjerë global. Gjendjet e identifikuara mundësojnë të perceptohet nëse dhe sa tekstet shkollore i sensibilizojnë nxënësit nga mosha e hershme shkollore, lidhur me diversitetet me të cilët rrethohen dhe stimulimin e dialogut dhe bashkëpunimit interkulturore. Në këtë mënyrë, nga njohuritë e fituara do të rezultojnë udhëzime për avancimin e cilësisë së teksteve shkollore nga aspekti i multikulturalizmit dhe interkulturalizmit, ndërkaq me këtë do të paraqesin kontribut në ndërtimin e ambientit interkulturore edukativ-arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut.<sup>24</sup>

Për këtë hulumtim janë përdorur metoda dhe procedura të kombinuara kualitative dhe kuantitative, ndërsa rezultatet janë pasqyruar përmes deskripsionit narrativ, tabelave dhe ilustrimeve me shembuj. Për përpunimin kualitativ është përdorur metoda Analiza e përmbajtjes përmes përcaktimit deduktiv të kategorive. Duke u nisur nga përcaktimi i nocioneve multikulturalizëm dhe interkulturalizëm, janë nxjerrë gjashtë kategori për analizë:

1. Identiteti kulturor;
2. Interaksioni midis të ndryshëmve;
3. Stereotipat dhe paragjykimet;
4. Emra personale dhe autorët;
5. Përfaqësimi i atdheut; dhe
6. Transparenca ndaj botës.<sup>25</sup>

Përpos MASH-it, edhe organizatat e huaja (si Delegacioni i BE-së, USAID, OSBE, NDC etj.) kanë mbështetur financiarisht shumë projekte të kësaj natyre nëpër shkollat e vendit, ku janë realizuar dhe hulumtuar:

- prezantimi dhe simulimi i zakoneve, besimeve dhe traditave të ndryshme;
- prezantimi i muzikës, pikturave, letërsisë, folklorit, prezantimi arkitektonik e të ngjashme si dhe prezantimi trashëgimisë botërore;
- zgjidhja e situatave problemore me shenjë interkulturore;
- realizimi i lojërave të ndryshme të oratorisë, aktiviteteve sportive, muzikore etj. (me prejardhje të ndryshme kulturore);
- prezantime të gjuhëve, alfabetëve, simboleve të ndryshme;

<sup>24</sup> Ministria e Arsimit dhe Shkencës, *Multikulturalizmi dhe interkulturalizmi në tekstet shkollore prej klasës së parë deri në të pestën në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë*, Shkup, 2017, f. 5.

<sup>25</sup> Ministria e Arsimit dhe Shkencës, *Multikulturalizmi dhe interkulturalizmi në tekstet shkollore prej klasës së parë deri në të pestën në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë*, Shkup, 2017, f. 6.

- organizim i vizitave të institucioneve të ndryshme kulturore, vizita në familje etj.
- përgatitja e artikujve ushqimor tipik për kultura të ndryshme etj.

Ajo që u vërejt nga kjo mbikëqyrje është se në projektet që organizojnë shkollat maqedonase përfshihen kulturat dhe gjuhët maqedonase, gjermane, angleze dhe frënge, si p.sh. në ShEJQSh “Vasill Antevski - Dren” në Shkup dhe në shkolla të tjera. Kurse vetëm disa shkolla shqipe i përfshijnë kulturat dhe gjuhët e bashkësive etnike që jetojnë në RMV.

Më shumë se dhjetë vjet nëpër shkollat fillore të RMV-së, shqipja ofrohet si lëndë fakultative për joshqiptarët, por në praktikë dëshmohet se vetëm një paralele në Tetovë, një klasë me boshnjakë, një me turq dhe fëmijë nga martesat të përzierat në Shkup e kanë zgjedhur si lëndë ose aty-këtu ndonjë grup i vogël dhe vetëm herë pas here janë interesuar për shqipen, madje e mësojnë të izoluar e jo me ndërveprim kulturor. Megjithatë, sivjet MASH-i kërkoi përditësimin dhe modifikimin e librave shkollorë të gjuhës shqipe për joshqiptarët nga klasa VI deri në klasën IX dhe deri në fund të vitit do t'i botojë. Shpresojmë që kësaj radhe të hyjnë në përdorim këta libra.

Shoqata e Përkthyesve dhe Interpretuesve të Maqedonisë ndan çdo vit çmimin “Ba-bi-lon” për përkthyesin e ri më të mirë me qëllim që të promovohen gjuhët e vendit dhe të huaja. Por edhe në këto konkurse shqipja nuk është e përfaqësuar sa duhet.

Një hulumtim që kam bërë unë para disa vitesh në fushë të psikolinguistikës, gjegjësisht interkulturalizmi dhe interlingualizmi, nxora disa përfundime, mes të cilave veçoj këto: 1. gjuha në të cilën mendojmë (me vetëdije apo nënvetëdije) i parapërcakton kufizimet dhe veprimet tona; 2. nëse një person njeh gjuhë të dytë, por jo shumë mirë, kur do të gjendet në të ashtuquajturën “pikë e fundit e njohurive”, ai me nënvetëdije do të bazohet në gjuhën amtare (të parë); 3. ndërkaq, nëse i njëjti di edhe gjuhë të tretë, katërt etj., por jo aq mirë, shumë lehtë gjendet dhe mund të shprehet duke i kombinuar format strukturore të gjuhëve që njeh; 4. folësi shumë-gjuhësh (multilinguisti) në të shumtën e rasteve është në gjendje t'i njohë dhe kuptojë strukturat e gjuhëve, e njëkohësisht akoma më mirë e zhvillon vetëdijen për gjuhën amtare. Nga këndtështrimi psikologjik, ky person ndryshe e sheh dhe kupton botën përreth tij, është njeri më pozitiv, më i hapur, më i shoqërueshëm etj.<sup>26</sup>

<sup>26</sup> Ajten Hajdari – Qamili, *Perla gjuhësore*, Shkup, 2018 f. 230.

Siguria është nevojë dhe gjendje të cilën në mënyrë të drejtpërdrejtë e kanë ndier shumë popuj dhe kombe të botës. Fuqia dhe rëndësia e saj për qytetarin e zakonshëm dhe për shtetin i motivon njerëzit për gjetjen e korrelacionit të sigurisë me ekzistencën e njeriut dhe me mbijetesën e shtetit. Së këtejmi, duhet të krijohet politikë e sigurisë kombëtare, e cila sigurisë do t'i japë konotacion politik dhe do ta bëjë vegël strategjike për realizimin e interesave kombëtare.

Çështja e sigurisë së Maqedonisë së Veriut dhe gjendja e sigurisë në Ballkan, si një tërësi e sigurisë, gjithmonë kanë zënë vend të rëndësishëm në pasqyrën gjeopolitike të Evropës. Dinamika e ngjarjeve të sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, veçanërisht në periudhën pas pavarësisë, rezulton nga marrëdhëniet ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike dhe faktorëve politikë – në planin e brendshëm dhe ndikimi i vendeve fqinje, SHBA-ve, vendeve të fuqishme në BE dhe BE si tërësi – në planin e jashtëm. Ndikimi i faktorëve të jashtëm u tregua veçanërisht i rëndësishëm në integrimet euroatlantike të shtetit – si proces unikal i cili zgjatë më shumë se dy dekada dhe ka implikime të fuqishme mbi sigurinë e vendit. Në këtë periudhë, Maqedonia e Veriut në mënyrën më të mirë të mundshme i ndjeu efektet të cilat rezultojnë nga diversiteti i interesave të forcave më të fuqishme në Evropë dhe në BE si tërësi politike. Ky proces zgjat nga çasti kur Republika e Maqedonisë e fitoi pavarësinë nga ish-Jugosllavia, u intensifikua në procedurën për njohje ndërkombëtare të shtetit dhe e ruajti intensitetin, si dhe i tejkaloi kushtet e proceseve integruese të zakonshme euroatlantike.<sup>27</sup>

Nga aspekti i qasjes teorike ndaj çështjeve lidhur me politikën e sigurisë, nga aspekti i përgjithshëm siguria dhe politika e sigurisë analizohen përmes konstruktivizmit dhe teorisë kritike, ndërkaq ndryshimet sa i përket sigurisë perceptohen përmes realizmit, liberalizmit dhe përsëri përmes konstruktivizmit. Një hulumtim që ka bërë Rade Rajkovçevski nga viti 2009 deri 2013, me qytetarë të RMV-së, nga qytete të ndryshme, grupmosha mbi 20 vjeçarë, nga të dyja gjinitë, nacionalitete të ndryshme, ka arritur në disa përfundime, prej të cilave po veçoj këto rezultate:

---

<sup>27</sup> Rade Rajkovçevski, *Ndërtimi i politikës së sigurisë: rasti i Republikës së Maqedonisë*, Shkup, 2015, f. 12.

([https://www.kas.de/documents/252038/253252/7\\_dokument\\_dok\\_pdf\\_36984\\_2.pdf/d4f028dd-d92e-61e9-cac0-dd9a7c8fa337?version=1.0&t=1539654537533](https://www.kas.de/documents/252038/253252/7_dokument_dok_pdf_36984_2.pdf/d4f028dd-d92e-61e9-cac0-dd9a7c8fa337?version=1.0&t=1539654537533))

Në vitin 2009	Maqedonas	Shqiptarë
Gjendja stabile e sigurisë është mungesë e kërcënimeve të cilat do ta cenonin integritetin territorial të RM-së;	136 -- 18,0%	18 -- 10,8%
Gjendja stabile e sigurisë është mungesë e veprimeve të ngjashme të ngjarjeve nga viti 2001;	79 -- 10,0%	17 -- 10,2%
Gjendja stabile e sigurisë është shkalla e reduktuar e krimit të organizuar dhe korrupsionit;	65 -- 8,0%	13 -- 7,8%
Gjendja stabile e sigurisë është veprim i harmonizuar politik i partive politike me proveniencë të ndryshme etnike në procesin e integrimeve euroatlantike të RM-së;	42 -- 5,5%	6 -- 3,6%
Gjendja stabile e sigurisë janë marrëdhëniet e mira ndëretnike;	71 -- 9,2%	21 -- 12,7%
Gjendja stabile e sigurisë është gjendja e mirë ekonomike, standardi më i lartë i qytetarëve dhe siguria më e madhe sociale;	146 -- 19,0%	26 -- 15,7%
Gjendja stabile e sigurisë është respektimi i parimeve të sundimit të së drejtës dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut.	154 -- 20,0%	27 -- 16,3%
Nuk janë përgjigjur	77 -- 10,0%	38 -- 22,9%
Gjithsej	770 -- 100,0%	166 -- 100,0%

*Pasqyra 1: Përgjigjet e të anketuarve në pyetjen: "Sipas Jush cili nga qëndrimet e theksuara më së miri e pasqyron qëndrimin tuaj për gjendjen stabile të sigurisë?" (2009)*

Në vitin 2013	Maqedonas	Shqiptarë
1. Gjendja stabile e sigurisë është mungesë e kërcënimeve të cilat do ta cenonin integritetin territorial të Republikës së Maqedonisë.	78 -- 28,9%	4 -- 12,1%
2. Gjendja stabile e sigurisë është mungesë e veprimeve të ngjashme të ngjarjeve nga viti 2001.	8 -- 3,0%	0 -- 0%
3. Gjendja stabile e sigurisë është shkalla e reduktuar e krimit të organizuar dhe korrupsionit.	15 -- 5,6%	6 -- 18,2%

4. Gjendja stabile e sigurisë është veprim i harmonizuar politik i partive politike me proveniencë të ndryshme etnike në procesin e integritimeve euroatlantike të Republikës së Maqedonisë;	11 -- 4,1%	0 -- 0%
5. Gjendja stabile e sigurisë janë marrëdhëniet e mira ndëretnike;	16 -- 5,9%	8 -- 24,2%
6. Gjendja stabile e sigurisë është gjendja e mirë ekonomike, standardi më i lartë i qytetarëve dhe siguria më e madhe sociale;	49 -- 18,1%	6 -- 18,2%
7. Gjendja stabile e sigurisë është respektimi i parimeve të sundimit të së drejtës dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut.	93 -- 34,4%	9 -- 27,3%
Gjithsej	270 -- 100.0%	33 -- 100,0%

*Pasqyra 2: Përgjigjet e të anketuarve në pyetjen: "Sipas Jush cili nga qëndrimet e theksuara më së miri e pasqyron qëndrimin e Juaj për gjendjen stabile të sigurisë?" (2013)*

Në hulumtimin nga viti 2013 janë ofruar thuaja se përkufizime identike. Të anketuarit - shqiptarë (27,3%) dhe maqedonas (34,4%) konsiderojnë se sundimi i së drejtës dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut janë kryesorë për gjendjen stabile të sigurisë.<sup>28</sup>

Me zyrtarizimin e shqipes në nivel qendror dhe me miratimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në vitin 2017, u themelua më pas edhe Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, vizioni i së cilës është mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit të gjuhëve, ruajtjes, promovimit dhe mbrojtjes së gjuhëve zyrtare dhe statusin e tyre të barabartë në RMV si dhe për të siguruar, mbrojtur gjuhët e komuniteteve gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare. AZGJ-ja ka mision të ndërtojë një mjedis institucional që respekton detyrimet kushtetuese dhe ligjore, mbron, promovon, ruan dhe zbaton të drejtën gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përmes:

- bërjes së politikave gjuhësore dhe unifikimin e nocioneve administrative në bashkëpunim me ekspertë të fushës dhe institucione gjegjëse brenda dhe jashtë vendit,
- trajnimit të përkthyesve dhe lektorëve nëpër të gjitha institucionet e vendit,
- sigurimin dhe furnizimin e softuerit të përkthimit me fjalë dhe shprehje për institucionet qendrore,

<sup>28</sup> Po aty, f. 36.

- dhënies së këshillave ligjore qytetarëve për të drejtën e gjuhës amtare,
- bashkëpunimit të ngushtë me Inspektoratin për Zbatimin e Gjuhës dhe me të gjitha institucionet relevante të vendit,
- këshillimit të Qeverisë dhe institucioneve në lidhje me miratimin dhe zbatimin e masave që sigurojnë përdorimin dhe statusin e barabartë të gjuhëve zyrtare,
- dhënies së rekomandimeve për institucionet qendrore dhe komunale për të inkurajuar, mbështetur dhe ofruar zgjidhje afatgjate, të qëndrueshme strukturore dhe një politikë stimulimi për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

29

Detyrat që ka realizuar AZGJ-ja janë:

- Mbështetja e institucioneve për realizimin e detyrimeve në bazë të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, duke përfshirë përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve;
- Lekturimi i akteve qëshpallen në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”;
- Promovimi dhe marrja e masave për avancimin e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Përgatitja e raporteve për informimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Përgatitja e materialeve profesionale analitike nën kompetencat e saj;
- Dhënia e mendimeve profesionale për materialet që janë në funksion të zbatimit dhe avancimit të përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Zbatimi i trajnimeve për përforcimin e kapaciteteve të të punësuarve, kurs për shqipe dhe maqedonishte brenda të punësuarve;
- Trajnime të përkthyesve dhe lektorëve të të gjitha institucioneve në vend;
- Organizim të konferencave dhe tryezave shkecore me qëllim të njëjtësimit të terminologjisë administrative dhe të fushave të tjera etj.

29

<https://apj.gov.mk/%d0%bc%d0%b8%d1%81%d0%b8%d1%98%d0%b0/?lang=sq>

▪ Përgatitje të një mekanizmi të ri për mbështetjen logjistike e cila do t'i ndihmojë AZGJ-së në zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në organet e pushtetit qendror, lokal dhe gjyqësor. Mekanizmi i mbështetjes logjistike është motivuar nga hartimi i udhëzimeve, doracakëve dhe broshurave për të drejtat e qytetarëve në të cilat gjenden Ligji i Përdorimit të Gjuhëve dhe Ligji i Inspektoratit të Përdorimit të Gjuhëve.

AZGJ-ja gjatë vitit 2019 bëri një hulumtim për ta konstatuar me saktësi se sa zbatohet dygjuhësia në RMV. Ajo realizoi gjithsej 641 pyetësorë anketues me një sërë pyetjesh të strukturuar drejtuar institucioneve të sektorit publik, me ç'rast kanë kthyer përgjigje gjithsej 183 institucione.

Nga përgjigjet e marra për pyetjen: A i keni përmbushur detyrimet në përputhje me nenin 7 të këtij ligji, dhe, nëse nuk i keni përmbushur plotësisht, deri në cilën fazë keni arritur me ndryshimin e tabelave të institucionit, memorandumet, vulat, logot dhe ueb faqet?

- 147 institucione janë përgjigjur se i kanë ndryshuar tabelat, 36 jo;
- 119 institucione janë përgjigjur se i kanë ndryshuar memorandumet, 64 jo;
- 151 institucione janë përgjigjur se i kanë ndryshuar vulat, 32 jo;
- 110 institucione janë përgjigjur se i kanë ndryshuar logot, 73 jo;
- 113 institucione janë përgjigjur se i kanë ndryshuar ueb faqet, 70 jo.

Përgjigjet e marra nga pyetja: Nëse nuk keni filluar me implementimin, a keni nevojë për ndihmë profesionale nga agjencia?

- 27 institucione janë përgjigjur se kanë nevojë për ndihmën e AZGJ-së;
- 63 institucione janë përgjigjur se nuk kanë nevojë për ndihmën e AZGJ-së;
- 54 institucione nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje;
- 26 institucione u përgjigjën se do të kërkojnë ndihmë nga AZGJ-ja sipas nevojës;
- 13 institucione u përgjigjën se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Përgjigjet e marra nga pyetja: Në aktin tuaj për sistematizimin e vendeve të punës, a keni paraparë sektor ose njësi të përkthimit dhe lekturës në shqip dhe nga gjuha shqipe?

- 30 institucione janë përgjigjur se kanë paraparë sektor dhe njësi të përkthimit dhe lekturës në shqip dhe nga gjuha shqipe;

- 135 institucione u përgjigjën se nuk kanë paraparë sektor dhe njësi të përkthimit dhe lekturës në shqip dhe nga gjuha shqipe;
- 18 institucione u përgjigjën se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Përgjigjet e marra nga pyetja: Nëse nuk e keni paraparë, a do ta bëni atë në ndryshimin e ardhshëm të aktit për sistematizimin e vendeve të punës?

- 76 institucione janë përgjigjur se do ta parashohin ndryshimin e aktit të sistematizimit të vendeve të punës;
- 31 institucione janë përgjigjur se nuk do ta parashohin ndryshimin e aktit për sistematizimin e vendeve të punës;
- 8 institucione nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje;
- 20 institucione janë përgjigjur se do ta parashohin ndryshim të aktit të sistematizimit të vendeve të punës, nëse është e nevojshme;
- 23 institucione janë përgjigjur se tashmë kanë paraparë ndryshim të aktit të sistematizimit të vendeve të punës;
- 25 institucione janë përgjigjur se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Përgjigjet e marra nga pyetja: Sa përkthyes dhe sa lektorë keni të punësuar në institucionin tuaj?

- 124 institucione janë përgjigjur se nuk kanë të punësuar asnjë përkthyes dhe lektor;
- 23 institucione janë përgjigjur se kanë të punësuar një përkthyes dhe lektor;
- 11 institucione janë përgjigjur se kanë të punësuar dy përkthyes dhe lektorë;
- 1 institucion janë përgjigjur se ka të punësuar tre përkthyes dhe lektorë;
- 2 institucione janë përgjigjur se kanë të punësuar katër përkthyes dhe lektorë;
- 3 institucione janë përgjigjur se kanë të punësuar pesë përkthyes dhe lektorë;
- 1 institucion është përgjigjur se ka të punësuar 22 përkthyes dhe lektorë;
- 18 institucione janë përgjigjur se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Përgjigjet e marra nga pyetja: Në buxhetin e paraparë për vitin 2020, a keni paraparë mjete financiare për përkthyes dhe lektorë të rinj?

- 43 institucione janë përgjigjur se kanë paraparë mjete financiare;
- 96 institucione janë përgjigjur se nuk kanë paraparë mjete financiare;
- 4 institucione janë përgjigjur se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje;
- 41 institucione nuk kanë dhënë asnjë përgjigje në lidhje me këtë pyetje.

Përgjigjet e marra nga pyetja: Si mund t'ju ndihmohet për të shpejtuar fazën e dytë të zbatimit të plotë të ligjit?

- 21 institucione janë përgjigjur se kanë nevojë për ndihmën e AZGJ-së;
- 16 institucione janë përgjigjur se nuk kanë nevojë për ndihmën e AZGJ-së;
- 60 institucione nuk dhanë asnjë përgjigje në lidhje me pyetjen;
- 73 institucione janë përgjigjur se do të kërkojnë ndihmë nga AZGJ-ja në rast nevojë;
- 13 institucione janë përgjigjur se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Nga gjithsej 183 përgjigje të marra:

- 131 institucione janë përgjigjur vetëm në gjuhën maqedonase;
- 4 institucione janë përgjigjur vetëm në gjuhën shqipe;
- 48 institucione janë përgjigjur edhe në gjuhën maqedonase edhe në gjuhën shqipe.<sup>30</sup>

Përfundim:

Nga e gjithë ajo që u trajtua më sipër dhe nga përfundimet e të gjitha hulumtimeve që u përfshinë në këtë kumtesë rezulton se edhe shumë duhet të punohet për interkulturalizmin institucional, sepse paragjykimet, urrejtja, përbuzja dhe rrezistenca ndaj gjuhës dhe kulturës së "tjetrit" ende gjallon në RMV, sidomos nga maqedonasit.

Zakonisht gjuha është ajo që mbron identitetin dhe kulturën e një kombi, prandaj zyrtarizimi i gjuhës garanton integrimin e atij

---

<sup>30</sup> Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, *Raporti i punës i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019*, Shkup, 2020, f. 21-23.

kombi në shoqëri dhe interkulturalizëm në një shtet. Këtë mund ta vërejmë edhe nëse krahasojmë historikisht me përdorimin e gjuhëve zyrtare në periudhën Austro-Hungareze dhe Perandorisë Osmane, me periudhën pas LDB kur u zmadhua numri i gjuhëve shtetërore, të cilat ndikuan në shpërbërjen e ish-Jugosllavisë dhe ish-Bashkimit Sovjetik apo rasti me Belgjikën, pastaj Zvicra dhe Suedia e sotme apo Tiroli i Jugut si modeli më i mirë për interkulturalizëm dhe bashkëjetesë etj.

Multikulturalizmi mund të çojë në konflikte një vend ku dominojnë kultura të ndryshme, sepse çdo kulturë ka identitetin, standardet dhe vlerat e veta. Jo të gjithë vendasit e një shteti respektojnë vlerat e një kulture. Kjo mund të krijojë konflikt si rezultat i kundërthënieve dhe çrregullimeve shoqërore-politike në shoqëritë bashkëkohore, të cilat të shumtën e herave janë heterogjene dhe multikulturore. Vetë laramania e kombeve të ndryshme, feve, racave, gjuhëve dhe kulturave, paraqesin edhe pikëpamje të ndryshme ideore dhe politike. Secila nga bashkësitë përpiqet të imponojë sjelljet, qëndrimet, rregullat dhe botëkuptimet e veta, kurse bashkësitë e tjera kundërshtojnë t'i pranojnë ato. Kështu lindin konfliktet, urrejtja, mostoleranca. Ajo që shton konfliktet ndërkulturore është paragjykimi që kultivojmë ndër vite për kulturat e tjera. Këtu në Ballkan paragjykimet kanë shumë rrënjë të thella dhe ato më negative janë të sllavëve ndaj shqiptarëve (si: nacionalistë, separatistë, irredentistë, të prapambetur, injorantë, ekstremistë, talibanë, indianë etj.) dhe anasjelltas (si: shka, kaurr, gjaurr, i pabesë), por edhe ndaj bashkësive të tjera etnike.<sup>31</sup>

Të gjithë këto fakte janë tregues të mjaftueshëm se në të gjitha institucionet e RMV-së duhet shumë më tepër të punohet me ndërgjegjësimin e pupullatës për një shoqëri interkulturore.

---

<sup>31</sup> Shih më gjerësisht: Mustafa Ibrahim, *Sociolinguistika*, Shkup, 2018, f. 118.

## Literatura:

AGJENCIA E ZBATIMIT TË GJUHËS. (2020) *Raporti i punës i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2019*, Shkup, 21-23.

DJALOSHI, D. (2019). *Pasqyrimi i elemnteve kulturore në gjuhë dhe ligjërim*, Tiranë. (<http://www.anglisticum.org.mk/index.php/IJLLIS/article/view/88/1619>)

HAJDARI – QAMILI, A. (2018). *Perla gjuhësore*, Shkup: SAK STIL.

IBRAHIMI, M. (2018). *Sociolinguistika*, Shkup.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS. (2017). *Multikulturalizmi dhe interkulturalizmi në tekstet shkollore prej klasës së parë deri në të pestën në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë*, Shkup.

QENDRA PËR DIALOG NANSEN SHKUP. (2018). *Doracak për arsimtarë, si deri te arsimit interkulturore*, Nansen Qendra për Trajnim për arsim interkulturore, Shkup.

RAJKOVÇEVSKI, R. (2015). *Ndërtimi i politikës së sigurisë: rasti i Republikës së Maqedonisë*, Shkup.

Концепција за интеркултурно образование (2016). Скопје: МОН, (<http://www.mon.gov.mk/images/Koncepcija-mk.pdf>)

<https://apj.gov.mk/%d0%bc%d0%b8%d1%81%d0%b8%d1%98%d0%b0/?lang=sq>

<https://flaka.com.mk/interkulturalizmi-allagjozovski-te-mesoyme-gjuhen-e-njeri-tjetrit/>

<https://vlada.mk/nacionalni-strategji>

<https://vlada.mk/node/19147?ln=sq>

<https://vlada.mk/node/19447>

[https://www.kas.de/documents/252038/253252/7\\_dokument\\_dok\\_pdf\\_36984\\_2.pdf/d4f028dd-d92e-61e9-cac0-dd9a7c8fa337?version=1.0&t=1539654537533](https://www.kas.de/documents/252038/253252/7_dokument_dok_pdf_36984_2.pdf/d4f028dd-d92e-61e9-cac0-dd9a7c8fa337?version=1.0&t=1539654537533)

<http://www.zakonzamladi.ams.gov.mk/nekategorizirano/propozim-ligji-per-pjesemarrjen-rinore-dhe-politikat-rinore/>

## Abstract

*The Republic of Northern Macedonia is a multiethnic and multicultural society. The heterogeneous ethnic structure of the population is an indication that the priority in education and public institutions should be to support constructive initiatives to promote the idea of interculturalism, as a fundamental connection for cooperation and communication between different ethnic communities.*

*Interculturalism and multiculturalism are very common topics that are researched by many different sciences such as sociology, anthropology, psychology, philosophy, pedagogy, law, sociolinguistics, psycholinguistics, ethics and others. However, the importance of interculturalism in education and the role of other public institutions has not been sufficiently researched and addressed. The purpose of this paper is to highlight the need to add and reinforce strategies for institutional interculturalism.*

*The idea for this research arose from the conclusions of some previous research by individuals and various institutions related to intercultural issues, therefore in the paper I will give an overview of some public institutions in the RMV, such as: how many primary and secondary schools, universities, ministries and how many other institutions try to practice cultural interactions.*

*As a study method I have used the method of synthesis and comparison of several researches from different points of view.*

*Key words: interculturalism, institutions, language, culture, values, differences, achievement.*

## Abstrakti

*Republika e Maqedonisë së Veriut është shoqëri multietnike dhe multikulturale. Struktura heterogjene etnike e popullsisë është tregues se prioritet në arsim dhe institucione publike duhet të jetë mbështetja e iniciativave konstruktive për promovim të idesë së interkulturalizmit, si lidhje themelore për bashkëpunim dhe komunikim ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike.*

*Interkulturalizmi dhe multikulturalizmi janë tema shumë të përhapura që trajtohen nga shumë shkencë të ndryshme si sociologjia, antropologjia, psikologjia, filozofia, pedagogjia, drejtësia, sociolinguistika, psikolinguistika, etika dhe të tjera. Megjithatë, rëndësia e interkulturalizmit në arsim dhe roli i institucioneve të tjera publike nuk është hulumtuar dhe trajtuar mjaftueshëm. Qëllimi i kësaj kumtese është të nxjerrë në pah nevojën për të shtuar dhe përfocuar strategjitë për interkulturalizmin institucional.*

*Ideja për këtë hulumtim lindi nga përfundimet e disa hulumtimeve paraprake nga individë dhe institucione të ndryshme lidhur me çështje*

*interkulturore, prandaj në kumtesë do të jap një pasqyrë të disa institucioneve publike në RMV, si p.sh.: sa shkollat fillore dhe të mesme, universtetet, ministritë dhe sa institucionet e tjera përpiqen të praktikojnë ndërveprimet kulturore.*

*Si metodë studimi kam përdorur metodën e sintezës dhe krahasimit të disa hulumtimeve nga këndvështrime të ndryshme.*

ISSN 2671-3004

UDC 316.723-021.463:37(497.7)

Punim studimor

**Ismet OSMANI**

Universiteti 'Shën Cirili dhe Metodi

E-mail: avzimustafa@yahoo.com

**INTERKULTURALIZMI NË PROCESIN EDUKATIVO-ARSIMOR NË  
REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT**

**ИНТЕРКУЛТУРАЛИЗМОТ ВО ВОСПИТНО-ОБРАЗОВНИОТ  
ПРОЦЕС НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

**INTERCULTURALISM IN THE EDUCATIONAL PROCESS IN THE REPUBLIC  
OF NORTHE MACEDONIA**

Hyrje

Kultura, si kategori universale, krijon mundësinë e njohjes së jetës shoqërore të gërshetuar me vepra kulturore. Në çdo kulturë mund të gjejmë një gamë të gjerë të aktiviteteve njerëzore, si: marrëdhëniet familjare, statusin shoqëror, të drejtat e pronës, tabutë, mitet, ndarjen e punës, ritualet etj. Format në të cilat shfaqen këto aktivitete, si elemente kulturore universale, mbartin karakteristikat e kulturës së mjedisit shoqëror. Kultura është vepër e njeriut, e edukon njeriun, ndërsa njeriu përcakton kulturën. Kultura është qendra e edukimit, e cila krijon një ndërvarësi midis njeriut, kulturës dhe edukimit (Strugar, 2012).

RMV si shoqëri shumëkulturore, përveç që mund të jetë burim dhe vend i konflikteve, mund të jetë edhe vend i takimeve ndërkulturore, i takimeve kulturore të barasvlershme, të cilat me bashkëveprim të suksesshëm do të krijojnë vlera të reja, dialog të suksesshëm dhe respekt të ndërsjellë.

Komunikimi si mjet afrimi dhe respekti midis kulturave është fryt i vetëdijes shoqërore, punës, traditës dhe historisë së një vendi. Respekti kultivon ndjenjën e ndërgjegjësimit ndaj kulturës së tjetrit. Vendtakimi i krijimit të relacioneve të ndërkulturore është shkolla, e cila si mjedis i takimit të kulturave të ndryshme krijon mundësinë e ndërveprimit më dinamik midis vetë nxënësve, midis nxënësve dhe arsimtarëve, gjithashtu nxit edhe komunikimin ndërkulturore midis tyre. Shkolla, gjithashtu mundëson përvetësimin e njohurive për kultura të ndryshme, njohjen me tjetrin dhe vënien e kontakteve, duke ndikuar drejtpërdrejtë në formimin e qëndrimeve dhe vlerave. Kështu, si nevojë e njohjes së kulturës së tjetrit lind interkulturalizmi, i cili duke shmangur paragjykimet, stereotipet dhe barrierat, krijon mundësinë e njohjes së kulturave të ndryshme në një shoqëri shumëkulturore. Republika e Maqedonisë së Veriut është vend i një larmie kulturash gjuhësore, kulturore, fetare, ku kontaktet me kulturat e ndryshme janë përditshmëri. Në një ambient të tillë interkulturore duhet vepruar me kompetencë nga të gjithë faktorët relevantë për të shmangur ndjenjën e intolerancës, mospërfilljes dhe paragjyqimeve. Sot, nuk duhet të përqendrohemi vetëm në ndërtimin e një shoqërie shumëkulturore, por edhe për një shoqëri ndërkulturore në të cilën grupe të ndryshme do të mund të komunikojnë me njëri-tjetrin dhe të punojnë për qëllime të përbashkëta. Interkulturalizmi vë në spikamë vlerat e përbashkëta kulturore dhe krijon mundësinë e një dialogu të barabartë midis bashkësive ku gërshetimi i elementeve kulturore nuk duhet kuptuar si humbje të identitetit kulturor, por, përkundrazi si vlerë që duhet çmuar.

### **Roli i shkollës në edukimin interkulturore**

Shkolla luan rol të rëndësishëm në përvetësimin e njohurive, zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive të nxënësit dhe është një bazë e mirë për përfshirjen e tyre në jetën shoqërore. Shkolla, përveç që shquhet për rolin e saj edukativ, kryen edhe funksionin e edukimit arsimor, kulturor dhe shoqëror. Si vendtakimi i kulturës kombëtare dhe globale, duhet të krijojë kushte të cilat do të mundësojnë përvetësimin e shprehive kulturore dhe vendosjen e dialogut midis kulturave të ndryshme. Edukimi interkulturore në Republikën e Maqedonisë së Veriut duhet të jetë shtyllë kryesore e një dialogu të sigurt interkulturore midis arsimtarëve dhe nxënësve të bashkësive të ndryshme. Praktika në vendet e zhvilluara tregon se edukimi, si formë themelore e procesit edukativo-arsimor në shkollë, zhvillimit

të modeleve të komunikimit ndërkulturor midis bashkësive të ndryshme kulturore dhe gjuhësore, ka rezultuar e suksesshme. Shembuj të tillë ku diversiteti kulturor është në qendër të vëmendjes hasim në shumë shtete evropiane, ku përmes bashkëveprimit me njerëz të ndryshëm dhe me prejardhje të ndryshme të tyre, kanë gjetur frymëzimin për sfida të reja.

Kështu, një nga mënyrat themelore për zhvillimin e komunikimit interkulturor është edhe zhvillimi i një sistemi gjuhësor shkollor që duhet parë si proces, e jo si pengesë. Respektimi i kulturës dhe gjuhës së tjetrit si model mirëkuptimi midis bashkësive të ndryshme, do t'i minimizojë konfliktet ekzistuese dhe mosbesimin e ndërsjellë midis grupeve të ndryshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Një veprim i tillë do të ndikojë në identitetin e fëmijës, të mësuarit, marrëdhëniet me miqtë, arsimimin dhe punësimin, dhe do t'u mundësojë atyre që të vazhdojnë më tej në drejtim të qenit qytetarë aktivë dhe të dobishëm në shoqërinë në të cilën jetojnë. Përveç kësaj, ndihmon në ndërtimin e ndjenjës së përkatësisë dhe forcimin e lidhjeve familjare dhe më gjerë. Ky lloj i mësimdhënies, si dhe bashkëpunimi me arsimtarë dygjuhësorë, siguron mbështetje për arritjet e plota akademike të nxënësve dhe studentëve që flasin gjuhë të ndryshme. Me këtë rast, duhet të merren parasysh kërkesat dhe nevojat e nxënësve, klima shoqërore që është e domosdoshme në mënyrë që nxënës dhe studentë të ndryshëm të ndjehen të vlerësuar dhe të krijohen kushte të nevojshme për integrimin e të rinjve në shoqëri (Axelsson, 1998, 1999, 2001).

Republika e Maqedonisë së Veriut si vend ku jetojnë bashkësi të ndryshme duhet të kultivojë modele edukativo-arsimore të mirëkuptimit, bashkëjetesës dhe veprimit të përbashkët ndërkulturor. Shkollat e ndara, ose ndërrimet e ndryshme vetëm për të shmangur kontaktet me nxënësit që flasin gjuhë tjetër vetëm se i thellojnë paragjykimet dhe stereotipet dhe nuk ndihmojnë në zhvillimin e marrëdhënieve reciproke, mirëkuptimin dhe tolerancën midis bashkësive. Një veprim i tillë monokulturor e bën të paqëndrueshme një shoqëri multikulturore. Prandaj, afirmimi i mirëkuptimit dhe pranimit ndërmjet pjesëtarëve të kulturave të ndryshme po bëhet kërkesë imanente në shoqëritë demokratike moderne. Nxënësit duhet të ndërtojnë ura për pjesëtarët e kulturave të ndryshme dhe të jenë të aftë për përshtatje kulturore ku do të promovojnë vlerat, njohuritë dhe zakonet e të gjitha kulturave në kontakt. Shkolla është vendi ku nxënësit krijojnë kontakte, komunikojnë me bashkëmoshatarët e tyre, vendi ku mbarten dhe

miratohen pikëpamjet dhe vlera të ndryshme. Studiues të shumtë e konsiderojnë mjedisin arsimor si një edukator të tretë. Nëse kultivohet mirë, mund të mbështesë dhe përmirësojë shumë të gjitha fushat e të mësuarit dhe të zhvillimit (Darragh, 2006).

Mjedisi shkollor stimulues është pjesë integrale e diskutimit bashkëkohor pedagogjik mbi zhvillimin e kompetencës ndër-kulturore, e cila krijon mundësinë e komunikimit efektiv dhe sjelljes në kontekste të ndryshme kulturore (Bennett 2001).

Ndërkaq, nëse shkolla nuk pasqyron rëndësinë e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe pranimit të larmisë kulturore, siç ndodh në shumë mjedise në RMV, nuk mund të zhvillojë kompetenca të bashkëveprimit dhe bashkëpunimit dhe të promovojë qëllimet përkatëse arsimore në një botë globale multikulturore. Mungesa e mirëkuptimit e grupeve të caktuara ndaj larmisë së vlerave kulturore, kombëtare, fetare, ekonomike dhe politike në shoqërinë tonë pothuajse është përditshmëri. Sharjet, fyerjet në baza kombëtare në stadione, por edhe në vende të tjera, barten edhe në mjediset shkollore, ku ndikojnë në acarimin e marrëdhënieve dhe arsimitarëve të bashkësive të ndryshme. Studimet e bëra nga shumë organizata joqeveritare paralajmërojnë ekzistencën e devijimeve shoqërore ndaj disa kombësive dhe konfirmojnë ekzistencën e një stereotipi etnik. Prandaj, është e nevojshme të hulumtohen orientimet e të rinjve në mënyrë që të sigurohet mbështetje sistematike përmes institucioneve arsimore dhe organizatave joqeveritare për të shmangur dukuritë devijuese në shoqëri.

### **Plan-programet mësimore**

Plan-programet mësimore duhet të artikulojnë programe, përmbajtje, burime dhe metoda që jo vetëm do të kontribuojnë në përvetësimin e njohurive, por edhe në edukimin për shmangien e stereotipave dhe paragjykimeve midis njerëzve. Dimensionin ndër-kulturor i plan-programeve ofron mundësinë që nxënësit të mësojnë më shumë për të tjerët, ndihmon në krijimin e një mjedisi në të cilin inkurajohet respektimi i diversitetit dhe zhvillimi i dialogut ndërkulturor (Coelho, 1998).

Megjithëse përmbajtja ndërkulturore mund të zbatohet në të gjitha fushat dhe lëndët edukativo-arsimore, disa autorë besojnë se shkencat shoqërore janë mënyra më e mirë që nxënësit të njihen me pluralizmin kulturor të shoqërive evropiane (trashëgiminë kulturore, emigrimet, religjionet), dhe t'i përgatisin të rinjtë me përvojat e

shoqërive shumëkulturore gjatë historisë së përbashkët. Pas shkencave shoqërore, janë fushat artistike që nxisin të rinjtë të zhvillojnë dhe të formojnë identitetin e tyre, shkëmbimin kulturor, por edhe përvojën e tyre. Shkolla, për të qenë e suksesshme duhet t'i edukojë nxënësit me njohuri nga bota e sotme, duke përfshirë në plan-programet mësimore edukimin mbi demokracinë, të drejtat e njeriut dhe tolerancën. Mësimi ndërkulturor mund të zhvillohet edhe përmes programeve jashtëshkollore të cilat dukshëm mund të kontribuojnë në ndërtimin e marrëdhënieve midis të rinjve. Mësimi ndërkulturor në vendet evropiane u drejtohet kryesisht të rinjve, ku përmes kampeve dhe projekteve të ndryshme do të mund të nxisin shoqërimin e të rinjve të qyteteve të ndryshme. Kampet janë një vendtakim i volitshëm ku nxënësit e shkollave nëntëvjeçare apo të mesme mund t'i pasurojnë njohuritë e tyre duke u njohur me kulturën dhe traditën e tjetrit. Kështu, përmes aktiviteteve sportive dhe argëtuese fitojnë aftësi për punë ekipore, ndërsa përmes debateve kreative zhvillojnë të menduarit kritik dhe të folurit e argumentuar. Por, për fat të keq këto programe shpesh realizohen veçmas, në varësi të gjuhës mësimore, gjë që i thellon edhe më shumë ndasitë midis të rinjve. Sistemi arsimor në RMV zhvillohet në mënyrë paralele, që do të thotë se nxënësit shqiptarë dhe maqedonas janë të ndarë dhe mësojnë në ndërrime të ndryshme, dhe me libra shkollorë përplot me stereotipa.

Përkundër reformave të bëra në zhvillimin e arsimit dhe ndërtimit të një strategjie të përgjithshme "Arsim cilësor për të gjithë", që, për nga titulli dhe përmbajtja korrespondon me strategjitë e zhvillimit të politikave arsimore të vendeve të zhvilluara evropiane, RMV, akoma ka ngecur në vend. Angazhimi i ekspertëve të shumtë nga të gjitha fushat dhe komisione të ndryshme të formuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së RMV-së për zhvillimin e politikave arsimore, tanimë disa vite nuk ka dhënë ndonjë rezultat.

### **Arsimtari si ndërmjetësues midis kulturave**

Roli i arsimtarëve në procesin edukativo-arsimor është shumë i rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie kohezive dhe ndërmjetësimin midis dy, tre ose më shumë kulturave, duke sqaruar e shpjeguar dallimet midis tyre pa ndonjë paragjykim. Arsimtari është një personi i përshtatshëm për takimin e kulturave, i cili përmes përmbajtjeve të pasura mësimore, interpreton dhe nxit zhvillimin intelektual e moral të nxënësit. Të jesh mësues nuk do të thotë të

edukosh dikë që të miratojë rregulla të përgjithshme të sjelljes që janë vendosur në shoqëri, por edhe t'i mësosh nxënësit të mendojnë për vlerat e organizimit të një shoqërie (Chantal Forestal, 2007).

Arsimtarët duhet të posedojnë kompetencë kulturore dhe të jenë të pavarur në punën e tyre. Në dallim nga konceptet tradicionale të mësimdhënies, perspektiva e sotme kulturore është avancuar shumë dhe, sot, ajo përfaqëson qëllimin që duhet të arrihet përmes kompetencës komunikuese si element i pandashëm i kompetencës kulturore. Dimensionet kryesore të kompetencës komunikuese ndërkulturore të mësuesve janë njohja, emocionet dhe sjellja, të cilat manifestohen përmes aktiviteteve njohëse, ndjeshmërisë dhe komunikimit të shoqëruar me sjellje fleksibël ndaj një realiteti tjetër.

Të institucionet udhëheqëse arsimore përmes projekteve të ndryshme duhet t'i trajnojnë dhe përgatisin arsimtarët në një shoqëri shumëkulturore, siç është edhe RMV. Trajnimi profesional është një nga mënyrat më efektive që shkollat të reagojnë shpejt ndaj dallimeve në shoqëri, duke ofruar përmbajtje që nxisin zhvillim profesional e moral të arsimtarëve. Edukimi dhe përgatitja e arsimtarëve për arsimin ndërkulturor duhet të bëhet në bazë të një politike arsimore të konceptuar mirë dhe të miratuar zyrtarisht, dhe jo duke zbatuar masa izolimi. Programi për edukim ndërkulturor të arsimtarëve duhet t'i integrojë karakteristikat e të gjitha komuniteteve në vend. RMV-ja si shtet shumëkombësh dhe shumëkulturor duhet t'u mundësojë të rinjtë të njihen me cilësinë dhe përparësitë e jetës në një shoqëri shumëkulturore. Çdo reformë dhe risi në arsim mund të kontribuojë dukshëm në përmirësimin e cilësisë, përgatitjen profesionale të arsimtarëve dhe motivimin e tyre në përputhje me kërkesat e shoqërisë moderne. Standardet, udhëzimet dhe parashikimet evropiane dhe nacionale mbi aftësitë e nevojshme për nxënësin, studentin dhe qytetarin evropian të shekullit 21 janë pikënisje për përcaktimin e kompetencave të arsimtarit të ardhshëm dhe konceptimin e përgatitjen profesionale të tij. Gjatë punës me nxënësit, gjithnjë e më shumë duhet spikatur kompetencat për ndërveprim interkulturor, të cilat janë shumë të rëndësishme në një shoqëri moderne shumëkulturore.

Zhvillimi i aftësive komunikuese ndërkulturore të arsimtarit kontribuojnë kryesisht në arsimin dhe edukimin cilësor, por edhe në uljen e paragjyqimeve të nxënësit. Gjithashtu, ndihmojnë në shmangien e etnocentrizmit, stereotipave, pabarazisë dhe diskriminimit në shoqëri. Për të gjitha këto, duhet pasur një pjekuri të caktuar metakognitive, e cila karakterizohet nga një shkallë e lartë e

vetëdijes, vetëvlerësimit, ose tendencës për të menduar për përvojën e fituar, si dhe aftësi të avancuar perceptuese (Piršl, 2007). Arsimtarët, duhet vazhdimisht të zhvillohen emocionalisht, intelektualisht dhe moralisht, dhe "të posedojnë aftësi në njohjen e njerëzve të tjerë, nxënësve, njohjen e aftësive, gjuhëve dhe kulturave të tyre" (Previšić, 1999). Tre faktorët e aftësisë komunikuese ndërkulturore që duhet t'i kenë mësuesit janë: shkathtësitë, të cilat pasqyrohen në prezantimin e një ngjarjeje të një kulture tjetër, njohuritë rreth mënyrës se si funksionon një grup shoqëror dhe qëndrimet që konsistojnë me pranimin e kulturave të tjera (Byram et al, 2001). Në rrugën e vazhdueshme të përvetësimit të njohurive, përvojës dhe zhvillimit të aftësive komunikuese ndërkulturore, arsimtarët mësojnë të komunikojnë verbalisht dhe jo verbalisht, të mësojnë më shumë për kulturën e tyre dhe ta krahasojnë atë me një kulturë të huaj. Ata mësojnë të respektojnë, kuptojnë dhe pranojnë një nxënës që i përket një kulture tjetër. Njohuritë që arsimtarët kulturorë duhet t'i zotërojnë përfshijnë njohuritë në lidhje me migrimet, historinë, mediat, sociologjinë e kulturave, gjuhësinë, psikolinguistikën, dallimet kulturore, karakteristika kulturore (Perroti, 1995).

### **Përfundimi**

Procesi edukativo-arsimor, sot, vë në spikamë përpjekjet për të sjellë risi dhe cilësi në arsim. Në këto përpjekje, spikat edhe interkulturalizmi, i cili gradualisht u përfshi në procesin edukativo-arsimor. Interkulturalizmi në shkollë ndihmon në krijimin e një atmosfere bashkëpunimi, respekti dhe ndjeshmërie, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të realizohet mësimdhënia e suksesshme. Përveç shkollës, mësuesit domosdo duhet t'i zhvillojnë aftësitë komunikuese ndërkulturore. Një gjë e tillë është e mundshme vetëm përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional, ku mësuesit do të mund t'i zgjerojnë dhe thellojnë njohuritë e tyre dhe të ndërmjetësojnë midis njerëzve të kulturave të ndryshme. Ndërtimi i kapaciteteve për komunikim ndërkulturor nuk duhet të synojë vetëm nxënësit dhe mësuesit, por edhe strukturat drejtuese të cilat duhet të pasqyrojnë karakterin multikulturor të vetë shoqërisë. Të mësuarit ndërkulturor do të krijojë kushte më të mira për qytetarin e ardhshëm aktiv, do të rrisë tolerancën, do të zhvillojë kulturën e komunikimit, respektin e identitetit kombëtar dhe etnik, gjuhën, historinë e vet dhe do të krijojë marrëdhënie konstruktive me të tjerët.

## Literatura

- ODINA, T. Aguado (2005): La educación intercultural en la práctica escolar. Investigación en el ámbito español. *Revista de Educación*, Vol. 21, No. 7, 43-51.
- AMORIM, L. (2001): Intercultural Learning. *Community Foundation Transatlantic Fellowship, Orientation Session* (june 2-4).
- BENNETT M., TOWARDS J. (1993): *Ethnorelativism-A Developmental Model of Intercultural Sensitivity*, Intercultural Press, Yamonh., M. C.
- BYRAM, M. (1998): *Teaching and Assessing Intercultural Communicative Competence*. Retrieved August 12, 2013 from Google books.
- EARLEY, P. C & Ang S. (2003): *Cultural intelligence: Individual interactions across cultures*. Stanford: Stanford University Press.
- GIESECKE, Hermann (1993), *Увод у педагозију*, Загреб, Едука.
- ПЕТРОВСКИ, В. Мирасчиева, С. (2013) *Мултикултуризам и интеркултурална комуникација*. Штип: УГД
- VERNE E. (1987): *Les politiques d education multikulturelles*, во: *Leducation multiculturelle*, Paris

## Abstrakti

*Zhvillimi i globalizmit ka bërë që domosdo të njihemi me kultura të ndryshme, gjuhë të ndryshme, të cilat mundësojnë krijimin e një marrëdhënie të veçantë midis popujve të ndryshëm. Një marrëdhënie e tillë duhet të mbështetet në bashkëpunim, respekt të ndërsjellë, barazi, njohje dhe lidhje, dhe mundësi e mirë për shkëmbimin e mendimeve, ideve, njohjen e kulturave të ndryshme, pranimin dhe respektimin e tyre. Mjedisi ku mund të theksohet një nga parimet bazë të interkulturalizmit është shkolla, e cila duke inkurajuar njohjen, mirëkuptimin, respektimin e mënyrës së jetesës e bën më të pasur dhe më të larmishëm mjedisin shoqëror. Në këtë kumtesë do të trajtomë rëndësinë e kulturës, edukimit dhe arsimit ndërkulturor në procesin edukativo-arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe të vë në dukje komunikimin ndërkulturor midis nxënësve dhe arsimtarëve në shkolla, si aktorët kryesorë në mësimdhënien bashkëkohore, ndërkulturore që zvogëlon diskriminimin dhe inkurajon tolerancën dhe kuptimin e kulturave të ndryshme.*

**Fjalët kyçe:** *interkulturalizmi, mësimdhënie dhe komunikim ndërkulturor, shkolla, mësuësit, nxënësit.*

**Abstract**

*The development of globalization has made it necessary to get acquainted with different cultures, different languages, which enable the creation of a special relationship between different peoples. Such a relationship should be based on cooperation, mutual respect, equality, recognition and connection, and a good opportunity for exchanging opinions, ideas, recognition of different cultures, their acceptance and respect. The environment where one of the basic principles of interculturalism can be emphasized is the school, which by encouraging knowledge, understanding, respect for the way of life makes the social environment richer and more diverse. In this paper we will address the importance of culture, education and intercultural education in the educational process in the Republic of Northern Macedonia, also to point out the intercultural communication between students and teachers in schools, as main actors in contemporary and intercultural teaching that reduces discrimination and encourages tolerance and understanding of different cultures.*

Keywords: interculturalism, intercultural teaching, intercultural communication, schools, teachers, students.



ISSN 2671-3004

UDC 811.18&#39;373.7:811.163.3&#39;373.7]:316.723-021.463

UDC 811.163.3&#39;373.7:811.18&#39;373.7]:316.723-021.463

Punim studimor

**Berton SULEJMANI**

Universiteti i Tetovës ([www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk))

[berton.sulejmani@unite.edu.mk](mailto:berton.sulejmani@unite.edu.mk)

**INTERKULTURALIZMI GJUHËSOR NËPËRMJET  
FRAZELOGJIZMAVE NË GJUHËN SHQIPE DHE MAQEDONASE**

**ЈАЗИЧНИОТ ИНТЕРКУЛТУРАЛИЗАМ НИЗ ФРАЗЕОЛОГИЗМИТЕ  
ВО АЛБАНСКИОТ И МАКЕДОНСКИОТ ЈАЗИК**

**LINGUISTIC INTERCULTURALISM THROUGH PHRASEOLOGIES IN  
ALBANIAN AND MACEDONIAN**

**Hyrje**

Fillet e ballkanistikës, si një lloj i gjuhësisë në kontakt, pra si një mënyrë për të krahasuar ngjashmëritë e gjuhëve ballkanike, që nuk janë rezultat i një origjine të përbashkët, por i një të kaluarë të përbashkët të popujve të Ballkanit, i gjejmë nga shekulli XIX, përkatësisht nga koha e lulëzimit të gjuhësisë krahasimtare. Këto studime, kryesisht i gjejmë në Gjermani, dhe mbi të gjitha, nga kërkimet e gjuhëtarëve të shquar evropianë, si: Franz Miklosiçi, Jernej Kopitari, Avgust Shllajeri, Gustav Majeri, Gustav Vajgandi dhe të tjerë (krh. Ilievski 1988: 14-15, Demiraj 1994: 15-20). Më vonë, këto hulumtime nxitën studime të mëpastajme, që në shekullin XX, të vazhdojnë më intensivisht me kërkime në gjuhët ballkanike,

përkatësisht, në studimin e ballkanizmave. Megjithatë, edhe sot e gjithë ditën në mjaft raste nuk ka ende një mendim të përbashkët për rrugën e lindjes dhe të përhapjes së disa ballkanizmave në gjuhët ballkanike në përgjithësi, apo në këtë ose në atë gjuhë të Gadishullit në veçanti. Sidoqoftë, të gjithë ata që janë marrë me hulumtimin dhe studimin e ballkanizmave, nuk mund të mos vinin re e të mos pranonin që shqipja është një ndër gjuhët ballkanike më tipike, dhe që, si rrjedhim, ajo duhej pasur kurdoherë parasysh për sqarimin historik të dukurive të përbashkëta të gjuhëve të Gadishullit. Dhe me të vërtetë, nuk ka pothuaj asnjë ballkanizëm që të mos ndeshet në gjuhën shqipe. Për më tepër, ballkanizmat në këtë gjuhë, në shumicën e rasteve, janë të një moshe relativisht mjaft të vjetër e kjo rrethanë e shton edhe më shumë interesin për studimin historik të këyre dukurive të shqipes (Demiraj, 2003: 45).

Shqipja dhe maqedonishtja si dy gjuhë të arealit ballkanik dhe njëkohësisht si dy gjuhë të familjes indoevropiane, kanë qenë në kontakt dhe në bashkëjetesë dhe kanë krijuar një radhë tiparesh të përbashkëta edhe në krijimin e proverbave. Gjuhëtari i madh zviceran Ferdinand de Sosiri kur fliste për gjeografinë gjuhësore e për bashkekzistencën e disa gjuhëve në të njëjtin vend, merrte për shembull tipik për këtë Maqedoninë dhe shprehej kështu: *“Në Maqedoni hasen të gjitha gjuhët që mund të merren me mend: turqishtja, bullgarishtja, serbishtja, greqishtja, shqipja, rumanishtja etj., të përziara në mënyra të ndryshme sipas regjioneve”* (Sosyr: 1977:294). Nga ky numër i madh i gjuhëve që fliten sot brenda kufijve të Maqedonisë së Veriut, sipas numrit të folësve të tyre, shqipja dhe maqedonishtja zënë vendin qendror.

Në fushën e fjalorit e të shprehjeve, në rastin tonë në krijimin e proverbave të këtyre dy gjuhëve, kanë hyrë një mal elementesh të ndërsjella shqipe në maqedonishte dhe maqedonase në shqipe, të cilat u kanë dhënë këtyre proverbave një kolorit të veçantë dhe kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në njëra-tjetrën, sidomos në leksik e në toponimi, por edhe në lëmin e proverbave. Elementet e ndërsjella shqipe në maqedonishten dhe anasjelltas në rrafshin dialektor të Maqedonisë (sot Maqedonia e Veriut) kanë qenë objekt hulumtimesh të gjuhëtarëve të ndryshëm dialektologë e leksikologë, si: A.M. Selishçevi, R. Nesimi, E. Hamp, R. Ismajli, Q. Murati, A. Poloska, O. Jashar-Nasteva, B. Vidoeskit, B. Koneskit, V. Labroska etj.) të cilët kanë bërë studime të shumta, por, kuptohet jo gjithëpërfshirëse.

Në këtë fushë ka munguar një studim më tërësor i cili do të inventarizonte fondin më të plotë të proverbave shqipe dhe ekuivalenteve dhe përshtatjes së tyre në maqedonishte. Ky është hapi i parë dhe besojmë se një inventar i tillë i proverbave shqipe me ekuivalentet dhe përshtatjet e të njëjtave në maqedonishte do të lehtësojë punën, sidomos punën e përkthyesve, në të ardhmen.

Korpusin e proverbave të përfshira në këtë studim i kemi marrë nga fjalori dygjuhësh, shqip – maqedonisht i autorit Haki Ymeri – Bina, që është botuar nga SHB “Logos-A” në vitin 2012. Edhe pse, prania në gjuhën shqipe e një numri jo të vogël frazeologjish, që ndeshen edhe në gjuhë të tjera ballkanike (rumanisht, bullgarisht, greqisht), paraqet shumë interes. Këto janë shumë të ngjashme midis tyre jo vetëm nga domethënia, por edhe nga tipi i ndërtimit (po i japim vetëm në shqip e në bullgarisht), si p.sh: *e di ujë*, bullgarisht *Znam go po voda*; *më hëngri veshët*, bullgarisht *Izede mi usite*; *më dhemb zemra*, bullgarisht *Boli me sërce* etj, (Demiraj, 2003: 46).

Në Parathënien e këtij fjalori, autori jep sqarime se nga e ka marrë fondin e përfshirë të fjalëve. Ai ka marrë fjalë nga: Fjalori i gjuhës shqipe (1954), Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980) dhe Fjalori i i gjuhës shqipe (2006) që të tre të botuara nga IGJL i Tiranës si dhe fjalorë të tjerrë në të cilët shqipja është gjuha e parë. Numri i fjalëve në këtë fjalor është rreth 30000 mijë. Proverbat e fjalorit në fjalë, autori te sqarimet paraprake tregonte i ka shënuar me dy ylltha (\*\*). Fjalori ka 976 faqe. Te fjalori dygjuhësh shqip-maqedonisht, i autorit, Haki Ymeri – Bina, krahas punës shumë të mirë dhe të dobishme në fushën e leksikografisë dygjuhësore, hasim edhe një numër të madh proverbash të shqipes dhe ekuivalenteve të tyre në maqedonishte. Por një numër i madh nga to janë përkthyer mekanikisht (ad literum) në maqedonishte, dhe të njëjtat nuk i kemi përfshirë në punimin tonë. Më poshtë po i rënditim proverbat e nxjerra nga fjalori në fjalë:

A

ai është vrima e fundit e kavallit *тој е последна дупка на свиралото (кавалот)*.

ai ka gisht në këtë punë *има замешано прсти во оваа работа*;

ai që s'ka kokë, ka këmbë *кој нема во главата, има во нозете*.

ajo kokë atë feste do *таа глава таква капа бара (спрема главата и капата)*;

as e mira as e keqja, nuk duhen harruar *ни добрината ни лошотујата, не треба да се забораат!*

asnjë s'të kruan si dora jote *ништо не може да чеша како сопствената рака;*

atë që sjell çasti, s'e sjell moti *што носи денот, не носи векот (не се знае што носи денот, што носи векот);*

**B**

besa e burrit – peshja e gurit *даден збор од маж- тежок како камен (како планина).*

bie daullja në vesh të shurdhrit *трешти зурла во увото на глувиот;*

bie lodra për atë që ka veshë *тапанот бие за тој што има уши (може да слуша).*

bjeri daulles, nëse nuk ke punë tjetër! *зборувај, ако немаш друга работа;*

burri lidhet për fjale, e kau për brirë *мажот се врзува за збор, а волот за рогови.*

burri lidhet prej fjalësh, kau prej brirësh *волот се врзува за роговите, мажот за зборовите;*

**Ç**

çdo berr varet nga këmbët e veta *секоја овца на своја нога виси; ка këmbë prej balte има стаклени нозе; ai me një këmbë (тој со една нога) нечистивиот (џаволот).*

çdo gjë që ndrit nuk është ar (flori) *се што сјае не е злато.*

**D**

dardha nën dardhë bie *круша под круша паѓа.*

darkë e lehtë, gjumë i qetë *мала вечеричка, долга живеачка.*

delen arrakate e ha ujku *заталканата овца (стадото) ја јаде волкот.*

delen e cila ndahet nga tufa e ha ujku *која овца се дели од стадото, волкот ја јаде;*

delja ku kullot, atje lë leshin *каде пасе овцата, таму си ја остава волната;*

deri në frymën e fundit *до последниот здив;*

deti më këmbë s'kalohet *морето не се преминува пешки.*

di gomari ku e vret samari *знае магарето каде го убива самарот;*

dielli lind për të gjithë *сонцето изгрева (се раѓа) за сите.*

dita e mirë duket që në mëngjes *денот по утрото се познава.*

djalli s'ka dele, por shet lesh *џаволот овци нема, ама волна (масло) продава.*

djalli s'ka dele e shet lesh *џаволот кози нема, а сирење продава;*

dora e huaj nuk të kruan si e jotja *туѓа рака не чеша како што може да те чеша твојата;*

duhen ndarë kokrrat nga hulina *да се оддели житото од плева, како л и сл.*

dy kokoshë në një pleh nuk qëndrojnë *два петла на едно бунуште не пеат*

E

e bën mizën ka *од влакно прави ортома;*

e di i zoti ku i pikon çatia *знае сопственикот кај му капе кровот;*

e ka dimrin prapa *одзади му е зимата (отпосле наидуваат проблемите);*

e vërteta çan (*edhe*) gurët *правдината и планини преместува (пробива на секаде).*

edhe mishi të piqet edhe helli të mos digjet *и месото да се испече и раженот да не изгори (и волк сит, и овците на број).*

eja baba të të dëftej *arat ајде тате да ти ги покажам меѓите;*

F

faji është jetim *вината е сирота (неа никој не ја прифаќа).*

fëmijët hanë kumbulla, pleqve u mrihen dhëmbët *децата јадат незрели сливи, ама на постарите им трнат забите;*

fëmijët hanë kumbulla, pleqve u mrihen dhëmbët *децата јадат сливи а на старите им трнат забите;*

fjala e burrit, pesha e gurit *зборот на маж, тежок како камен;*

fjala e butë hap dyer të hekurta *сладок збор и железни порти отвора;*

fjalët e hallkut e vrimat e gardhit s`mbyllen kurrë *туѓите усти и дупките на плотот никогаш не се затвораат.*

fjalët e shumta janë fukarallëk *многу зборови голема сиромаштија.*

flet në erë *зборува на ветар (зборува напразно, треска глупости);*

fshati digjet, plaka krihet *село гори баба се чешла;*

fshati që duket s`do kallauz *во познато село не ти треба предводник.*

fshesa e re fshin më mirë *нова метла подобро мете (чисти).*

fusha ka sy e gardhi ka veshë *полето има очи а плотот има уши.*

fusha ka sy e mali (*gardhi, muri*) ka veshë *полето има очи, а планината (плотот/sидот) уши.*

G

gënjeshtër i ka këmbët të shkurtra *лагата има куси нозе (брзу се открива).*

gomari i cofët nuk i tutet ujkut *пцовисаното магаре не се плаши од волкот*

gur, gur bëhet kala (*bëhet mur*) камен по камен кула (*sud*) (*капка по капка, вир/зрно по зрно, погача*);

guri është i rëndë në vend të vet каменот на местото си тежи.

Gj

gjarpri nuk i dëften këmbët змија нозе не покажува;

gjej njëherë bari, pastaj shko e bli dhi најди си еднаш овчар/козар, а потоа купи си овци/кози;

gjerba shpon gurin капаницата го дупи каменот.

gjuha kocka s'ka e kocka thyen јазикот коски нема, ама коски крши;

gjumi është vëllai i vdekjes сонот наликува на смрт.

H

ha bukën e mikut e bën duanë e armikut свој леб јаде, туѓо гајле бере (*свои свеќи гори, туѓи есапи прави*).

harron si grizhla çerdhen e vet заборава како страчка своето седало.

hekuri njihet në zjarr, miku në nevojë железото во оган, а пријателот во мака (*неволја*) се препознава;

hekuri rrihet sa është i nxehtë железото се кове дури е жешко.

heshtja është flori молчењето е злато.

humbi si sëpata pa bisht се изгуби како секира без дршка;

I

i armatosur gjer (*deri*) në dhëmbë вооружен до заби;

i bën edhe gjeli vezë u петелот му носи јајца;

i bërtet së bijës, të dëgjojë e reja говорам (*зборувам*) ти, ќерко, сети се снао.

i bie lapsit (*kalemit*) му удира калем/молив (*пресметува нешто*).

i duruari, i fituari трпение, спасение (*кој чекал, дочекал*).

i duruari, i lavdëruari трпен спасен.

i fundit o qesh, o qanë последниот или се смее или плаче;

i ka hyrë frika në palcë стравот му навлегол во сржта.

i marri i hap udhë të dehurit u будалата му попушта на пијаниот.

i merr krundet për miell триците ги смета за брашно (*сапунот го смета за сирење*).

i ngopuri s'e beson të uriturin сит гладен не верува.

i qan hallin kalorësit se i varen këmbët се грижи за коњаникот, зошто му висат нозете (*се грижи без причина*).

i qan hallin kalorësit se i varen këmbët се секира за коњаникот зошто му висат нозете (*се секира за брадата на косиот*).

i shet kastravecë bostanxhiut/ kopshtarit на бостанџијата/ бавчованџијата му продава краставици.

i shkon si shala gomarit *како на магаре седло*;  
 ia mbloodhën (*ia shkurtuan/ia prenë*) litarin (*lakun*) *му го пресекоа јажето (го ослободија од некаква мака)*;  
 ia shtrënguan litarin *му го затегнаа јажето*;  
 ia vunë thikën në grykë *му ставија нож под грло*;

J

jetëgjati, jetëshkurtër s'bëhet *долговечниот, кусовечен не бидува*.

K

kali i mirë duket nën çull *добриот коњ се познава и под чулот*.  
 kalit të falur nuk i shihen dhëmbët *на подарен коњ не му се бројат забите*.

kalit të falur nuk i shikohen dhëmbët *на подарен коњ забите не му се гледаат*;

kapedani i mirë njihet në furtunë *добриот капетан се познава во време на бура (високите елки растат во предели на бури)*.

kau i mirë njihet në hulli *добриот вол се познава во бразда (дали држи бразда при орање)*.

kau lidhet për brirë, e burri për fjale *волот се врзува за рогови, а мажот за збор*.

kau lidhet për brirësh, njeriu lidhet për gjuhe *волот се врзува за рогови, човекот со дадениот збор*;

këtu i la koskat *тука ги остави коските (долго живеше или работеше на едно место)*.

klloçka që s'rri mbi vezë i nxjerr ato kllukë *квачка која не лежи на јајца изведува сматок*.

korbi korbit (*sorra sorrës*) s'ia nxjerr sytë *врана на врана очи не копа*.

kroi i mirë njihet në kohë të thatë *добриот извор се познава во време на суша (добриот, способниот човек се познава во тешки моменти)*;

ku dhemb dhëmbi, vete gjuha *каде боли забот, таму оди јазикот*;

ku hyn dielli nuk hyn mjeku *каде допира (влегува) сонцето, не влегува лекарот*

ku i bie daulles unë, e ku e hedh vallen ti? *што зборувам јас, а што правиш ти?*

ku ka gjallesë, ka edhe shpresë *каде што има живот, има и надеж*.

ku u nis e ku u degdis *каде појде а каде пристигна (како почна а како заврши работата)*.

kujt i ha miza nën kësulë, le të kruhet! *кој има мува под капа, нека се почеша!*

kur kërcente fukarai, çahëj daullja *кога ќе се фати сиромавиот на оро, ќе се скине тапанот;*

kur s'ha kumbulla, s'të mpihen dhëmbët *ако не јадеш сливи, нема зошто да ти трнат забите (ако не си згрешил, нема место за вознемирување);*

kur s'ke grurë, e mirë është edhe thekra *кога немаш пченица, добра е и `ржта;*

kur s'ke pulën, ha edhe sorrën *кога немаш кокошка, можеш да јадеш и сврака;*

kush punon, galdon *кој работи, се радува.*

kush guxon, fiton *кој рескура, тој добива.*

kush i bën gropën tjetrit, bie vetë brenda *кој копа дупка на друг, сам ќе падне во неа.*

kush lyp gjen *кој бара и наоѓа.*

kush mbjell duhi, korr breshër e shi *кој ветер сее, бура жнее .*

kush mbjell duhinë, korr breshër *кој сее бура, жнее град.*

kush mbjell erën do të korrë furtunën *кој сее ветар, ќе жнее фуртуна.*

kush mbjell erën, korr duhinë *кој сее ветар, жнее бура;*

kush nxiton, dështon *кој брза, греша.*

kush rri nën dardhë, i ha kokrrat *кој седи под круша, тој јаде круши.*

kush s`ka kokë, ka këmbë *кој нема во главата има во нозете.*

kush shkon pas brumbullit, te plehu do ta shpjerë *кој оди по бумбарот, стигнува на буниште.*

peshku në det, tigani në zjarr *рибата в море, тавата на оган.*

L

Iepuri i madh rri në ferrë të vogël *голем зајак на мал жбун;*

Iepuri në mal e vala (*kusia*) në zjarr (*peshku në det e tigani në zjarr*) *рибата в море, тавата на оган (зајакот в планина, а казанот на оган).*

liria nuk dhurohet, por fitohet me gjak *слободата не се дарува, туку се извојува со крв.*

lisit shihi hijen, njeriut mendjen *на дабот висината, а на човекот (гледај му ја) паметта.*

lugë-lugë shpiket një kupë *капка по капка, се полни бунарот спор. со: gurë-gurë bëhet mur камен по камен суд (капка по капка вир).*

LL

llumi lahet, turpi s`lahet *нечистотијата може, ама срамот не може да се испере.*

M

mbeti si peshku në gjanë *остана како риба на суво (тиња).*

më dha saçin, ia dhash fulteren *ми даде вршник, му дадов тава (доброто со добро се враќа).*

më i keq gërgasësi se dorasi *полош е подбуцнувачот од убиецот (крвникот).*

më mirë djepin thatë (*bosh*) se shejtanin brenda *подобра празна лулка отколку ѓаволот во него.*

me mirë i fikur, se i koritur *подобро осиромашен, отколку осрамотен.*

më mirë pak se aspak *подобро нешто отколку ништо.*

më mirë të dish se të kesh *подобро да знаеш отколку да имаш.*

më mirë të të rrahë yti, sesa të të puthë i huaji *подобро да те тепа твојот, отколку да те бакне туѓиот (туѓинецот).*

më mirë të thyhesh, se sa të epesh *подобро гроб, отколку роб (подобро да се скршиш, отколку да се повиниш).*

më mirë vonë se kurrë *поарно некогаш, отколку никогаш.*

me një dallëndyshe s'vjen pranvera *со една ластовица пролет не бидува.*

me një lule s'vjen behari (*pranvera*) *со една ластовица пролетта не иде.*

me një lule s'vjen pranvera *едно цвеќе (една ластовица) не прави пролет.*

mish pa kocka s'ka *месо без коски нема;*

mos bëj hop pa e kapërcyer gardhin! *прво скокни, па речи оп(а)!*

mos i shiko gunën, po shikoji punën! *не му ја гледај рубата, туку работата!*

mos shtjerë kripë në gjellë të botës *не ставај сол во туѓа манџа.*

mos u përziej me krundet, se do të hanë pulat! *не се мешај со трици, оти ќе те изедат кокошките!*

mulliri bluan, kur ka ujë *воденицата меле, кога има вода.*

N

në çdo gjellë majdanoz *во секоја манџа мирудија.*

në humbi unazat, gishtërinjtë i ka *ако ги изгубил прстените, прстите ги има.*

ne për ujkun e ujku në derë *ние за волкот, а волкот на врата.*

në shtëpinë e të varurit nuk e zënë në gojë *litarin во куќата на обесениот не се спомнува јажето.*

nuk bie reja në hithra *гром во коприви не удира.*

nuk është lule për t'i marrë erë *не е цвеќе за мирисање;*

nuk fle (*nuk kullot*) delja me ujkun *bashkë не спие (не пасе) овцата заедно со волкот.*

nuk fshihesh dot prapa hostenit *не можеш да се скриеш одзади остен.*

nuk fshihet derri në thes *не се крие свиња во вреќа;*

nuk fshihet hosteni (*minarja*) në thes *не се скрива остен (минаре) во вреќа.*

nuk gjëmon po s'vetëtiu *нема да грми ако не севне (молскне).*

nuk ka degë pa rrënjë *нема гранка без корен.*

nuk lind njeriu (*burri*) me mustaqe *не се раѓа маж со мустаќи.*

nuk lyhet Dielli me baltë *сонцето не може да се извалка со кал.*

nuk mbahen dy karpuzë (*shalqinj*) nën një sqetull *две лубеници под една мишка не се носат.*

nuk mbahen dy kunguj (*du shalqinj*) nën (një) sqetull *две тикви (две лубеници) под една мишка не се носат.*

nuk mbahet gardhi me një hu *не се прави ограда со еден кол; ishin mbledhur i hurit dhe i konopit се собрале кој од кол, кој од ортома.*

nuk mbahet shtëpia me miell hua *не се крепи куќа со позајмено брашно.*

nuk mbulohet (*nuk zihet*) dielli me shoshë *не се покрива сонце со решето.*

NJ

një gur s`çon mur *со една греда (еден дирек) куќа не се крепи.*

njëra dorë lan tjetrën, të dyja lajnë fytyrën (*faqet*) *едната рака ја мие другата, а заедно го мијат лицето;*

njëri i bie gozhdës (*thumbit*), tjetri potkoit *едниот удира по клин, другиот по потковица;*

P

pasi s'ke ara në mal, pse bën dava me çakejtë *кога немаш ниви в планина, што бркаш сојки? (не читај ферман на орман (на планина)!*

pate thonj, kruaju vetë *ако имаш нокти, чешај се самиот.*

pelën shite, po çokalen ruaje *кобилата продавај ја, ама клопотарецот чувај си го!*

pëlhurës këqyri indin dhe fëmijës prindin *на платното нитката а на детето мајката.*

për një gozhdë (*thumb*) shkoi potkoi *за едно клинче отиде потковицата (се оштети нешто големо за многу мала работа);*

për një gozhdë humb potkoi *за еден клин се губи потковицата.*

për një pe, për një gjilpërë, shkoi kot një gunë *е tërë за конче и игла, пропадна една цела гуна (за мала работа пропаѓа целата работа).*

peri këputet ku është i dobët *кај што е тенко, таму се кине крајот.*

po i hape derën, të rrëmben shtëpinë *ако му отвориш врата, ќе ти ја земе куќата (ако му дадеш прст, ќе ти ја грабне раката).*

po nuk hëngre hudhër, nuk bie erë *ни лук јал, ни лук мирисал.*

po nuk qau fëmija, nuk i jep nëna sisë *ако детето не заплаче, мајката не му дава да цица.*

po u thye kulaçi, s'ngjitet më *ако се скрши еднаш лебот, не може да се состави повторно;*

prilli mbulon gurët, maji mbush çeturët *април ги покрива камењата, а мај ги полни матарките (со млеко).*

prish bucela e bën kënaçe *растури куќа, прави плевна.*

prit gomar të mbijë bar *не умри магаре до зелена трева;*

pula e botës duket më e majme *(тë e madhe) комшиското јајце изгледа по големо (комшиската кокошка поголеми јајца снесува);*

puno fatkeq, ha barkdreç *работи несреќнику, да јаде ненаситникот.*

puno sot e paratë pas lëmëve *денес работи, парите по вршидба.*

Q

qengji i butë thith dy nëna *кратко јагне од две мајки цица.*

qeni leh atje ku ha кучето *лае таму каде се храни;*

qeni që leh nuk kafshon кучето *што лае, не каса.*

qentë le të lehin, karvani shkon përpara *пците лаат, карванот си мине.*

qesh mirë ai që qesh i fundit *последниот што се смее најслатко се смее.*

R

ra si gjeli *(si pula) në thekër како кокошка на гумно;*

RR

rri si mbi gjilpëra *(gjemb) седи како на игли;*

rris gjarprin në gji *помагам (одгледувам) неблагодарник;*

S

s`bartet çorba me kaçile *не се носи вода со решето;*

s`bëhet urë me gëzhdalla! *со игла бунар не може да се ископа!*

s`bëhet vreshti me urata, po me shata e lopata *лозјето не сака молитва, туку сака мотика.*

s`ka grurë pa egjër *во секое жито има и какол.*

s`ka mbetur laraskë pa bisht, që ti të mbetesh pa grua *која страчка (останала) без опашка, да и ти(останеш) без жена;*

s`ke ku të hedhësh majën e gjilpërës *(s`ke ku të veshë këmbën) нема каде игла да фрлиш (нема место игла да падне);*

s`pritet lisi me një të rënë të sëpatës *со еден удар на секира, не се оборува даб.*

s'bëhet dasma me një fyell *свадба со една свирка (шупелка) не бидува.*

sa më i gjatë është lisi, aq më shumë e zë era *што е повисок дабот, толку повеќе го бие ветрот;*

s'bëhet dasma me një fyell *(me një këngë) свадба со една песна не бидува;*

s'bëhet stan me lepuj *не бидува бачило со зајци;*

s'çalon gomari nga veshët *не криви магарето заради ушите;*

s'dalin dy lëkurë nga një dele *од една овца две кожи не излегуваат.*

s'dalin dy lëkurë nga një dele *од една овца две кожи сака;*

secila bletë nuk bën *(nuk mbledh) mjalte секоја пчела не дава (бере) мед.*

secila dhi për këmbë të vete viret *секоја коза на својата нога виси.*

s'i bihet malit me kokë *не се урива суд со глава;*

si e bija edhe e ëma *каква мајка, таква ќерка (гледај ја мајката, зemi ја ќерката!)*

si i ati, ashtu edhe i biri *каков татко, таков син.*

si lata, sëpata *(каква е секирата, такво е и секирчето) каков татко, таков син.*

si pata në gjetkëz *како бубрег во лој.*

s'ia ka çukitur/pirë sorra mendtë *чавките умот не му го испиле.*

sipas kokës edhe festen *(ajo kokë atë feste do; atë kokë ka, atë feste do) спрема главата и капата;*

s'janë të gjithë gishtërinjtë njësoj *не се сите прсти исти;*

s'ka ç'i bën gomarit, i bie samarit *не може по магарето, удира по самарот;*

s'korret livadhi me gërshërë *не се коси ливада со ножички.*

s'ka ç'i bën shkëndia eshkës së njomë *што му може искра на влажен трат.*

s'mbahet zjarri me lëmishte *не се држи оган со суварки.*

s'shëndoshet kau ditën që do të theret/ s'trashet kurbanit ditën e bajramit *не гоу се прасе в очи божиќ;*

SH

shelgu ndreqet sa është filiz *дрвото се вие дур е младо.*

shëndet e kësmet *здравје и (касмет) среќа;*

shiko drithin e jo thesin *гледај го житото, а не вреќата!*

shkoi vara me gushtin *(ja snema жештината со месецот август) сè во свое време.*

shumë babo *(dada) e mbytin fëmijën при многу бабици децата килави испаѓаат;*

shumë dada e mbytin fëmijën *при многу баби детето килаво излегува.*

T

të lumshin krahët (*duart*)! *да ти се позлатат* рацете;  
të shpie (*të çon*) në krua e s'të jep ujë *ке те префрли* жеден преку река.

t'u bëftë gjak e dhjamë! *крв да ти се стори!*

U

u bë kockë e lëkurë *стана коска и кожа*; është kockë e fortë *тој е стара коска (искусен човек)*;

u dogj nga qulli (*nga kungulli*) e i fryn edhe kosit *изгоре од млеко, сега дува и на матеница.*

u rrokullis tenxherja, gjeti karakun *нашло грне поклонче*

ujët fle, hasmi s'fle *водата мирува, непријателот не мирува.*

uji fle, hasmi s'fle *водата спие (мирува), непријателот не (мирува)*;

ujku mjegull kërkon *волкот магла бара.*

unë për lisa, ti për fshesa *јас за дабови а ти за метли (јас зборувам за голема, вредна работа, а ти за некаква мала, безвредна работа).*

unë zot, ti zot, po gomarin kush e kullot *јас господин, ти господин, ами магарето кој ќе го пасе (кој ќе го тури житото во амбар).*

V

vaj halli për ne *тешко нам*;

vë kusarin të ruajë shtëpinë *става крадец да му варди кука (ирон.)*

Z

zbriti nga kali në gomar *слезе од коњ на магаре.*

Krahas proverbave të nxjerra nga fjalori në fjalë, në vitin 2016, së bashku me profesorët V. Labroskën, H. Ymerin e P. Atanasovin, hartuam një fjalor dykahësh, shqip-maqedonisht dhe maqedonisht-shqip (shih te literatura e shfrytëzuar) me dy gramatika të shkurtër për nxënësit e shkollave fillore në RMV, nga i cili do t'i nxjerrim disa fjalë me formë e kuptim të njëjtë apo të përfaqësues.

Ja disa nga to: ама / ama (lidh, bised.), аманет / amanet, анегдота / anekdota, артист / artist, ас / as (= првак), асфалт / asfalt, ацо / axhë, бавча / bahçe, бања / banjë, барабар / barabar, бастун / bastun, баш / bash, баца / baxhë, базира / bazohem (текстот се

базира на легенда: *teksti bazohet në legjenda*), богат / begatë, боја / bojë, беља / bela, беса / besë, бир(о) / bir (=син), беседа / bisedë, цуца / cuscë, чупе / çupë, дада / dadë, далдиса / dalldisem, далга / dalga, дамла / damlla, тантела / dantellë, дома / dhomë, илач / ilaç, инает / inat, интегрирање / integrim etj.

Një pjesë e fjalëve të mësipërme janë me burim nga gjuhët sllave të cilat prej kohësh kanë hyrë në gjuhën shqipe. Për depërtimin e këtyre fjalëve në gjuhën shqipe shkruan Franc Miklisiçi në veprën e tij *Albanische Forschungen. I. Die slavischen Elemente im albanischen* të botuar në Vjenë në vitin 1870 (Miklosiç 2007: 491–501). Ja disa nga fjalët që ai i jep në veprën e tij: *beleg, biber, bosilek, breg, vilushka, dedo, zhaba, kolaç, streha, trup* etj. S’do mend se disa nga to në gjuhën shqipe (sidomos te shqiptarët e këtyre trevave, sot Maqedonia e Veriut) kanë depërtuar nëpërmjet maqedonishtes (sidomos, nga gjysma e dytë e shekullit XX).

Disa nga fjalët e mësipërme janë të gjuhës shqipe të cilat kanë hyrë në maqedonishte, si: *besa/беса (чесен збор), bibë/биба (пajка), bir/бир (сине), buzë/буза (усна), dallgë/далга (бран), dembel/дембел (мрза), lalë/лала (стрико), lejlek/лејлек (штрк), presh/преш (праз)*. Kristijan Sandfeldi në librin e tij *Lingustique balkanique*, të botuar në Paris (1930), rreth huazimeve nga gjuha shqipe që kanë hyrë në gjuhët sllave i jep këto: *molikë, çupa* dhe disa të tjera të cilat nuk janë shumë të njohura sot (Sandfeld 1930: 68).

Përfundim. Gjuha shqipe dhe gjuha maqedonase, edhe pse janë shumë të ndryshme, e para përfaqëson grup më vete në familjen e madhe indoevropiane, ndërsa e dyta, pjesë e grupit të gjuhëve sllave, kanë një numër të fjalëve me kuptime të njëjta, ashtu siç edhe e pamë më lart. Por, këto dy gjuhë, kanë edhe proverba të njëjta a të përafërta, të cilat, në të shumtën e rasteve, përdoren edhe në situata të ngjashme. Këtë punim do ta përbyllim me frazeologjinë: fjala e butë hap dyer të hekurta *сладок збор и железни порти отвора*, duke shpresuar që fjala do të na afrojë e do të na hapë dyert për një bashkëjetesë më të mirë në këtë pjesë të botës që quhet Ballkan.

## LITERATURA E SHFRYTËZUAR:

- Bozhidar V. (1993) *Međuјазичниот контакт (на дијалектно рамниште) како фактор на дијалектната диференцијација на македонскиот јазик*, Реферати на македонските слависти на XI меѓународен славистички конгрес во Братислава, Скопје: МАНУ, 33 – 54.
- Demiraj, Sh. (2003) *Gjuha shqipe probleme dhe disa figura të shquara të saj*, Tiranë.
- Demiraj, Sh. (1988) *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë.
- Demiraj, Sh. (1994) *Gjuhësi ballkanike*, Shkup.
- Илиевски Петар Хр. (1988) *Балканолошки лингвистички студии*. Shkup: ИМЈ (Instituti i Gjuhës Maqedonase) „Крсте Мисирков“.
- Jashar-Nasteva, O. (1957) *Влијанието на македонскиот јазик врз албанските и турските говори во Македонија*, Македонски јазик VIII/2, 147-164.
- Labroska, V. (2013) „*Македонските заемки во албанскиот јазик во споредба со материјалите од Франц Миклошич*“, Miklošičeva monografija, Ob dvestaletnici Franca Miklošiča (uredil Marko Jesenšek), Ljutomer, 159-167.
- Лаброска В., Сулејмани Б., Имери-Бина Х., Атанасов П. (2016) *Македонско-албански, Албанско-македонски речник*, Скопје.
- Miklosiç F, (2007) *Gjurmime shqiptare / Albanische Forschungen*. Prishtinë, Akademia e Shkencave dhe e Ateve e Kosovës.
- Сулејмани Б., Даниловска М., Спасовска М., Лаброска В. (2013) „*Меѓујазичното влијание на македонскиот говор и албанскиот гегиски говор во Тетово на лексичко рамниште*“, Македонски јазик LXIV, 105-115.
- Sulejmani B., Danilovska M., Spasovska M., Labroska V. (2014) *Ndikimet ndërјgjuhësore të së folmes maqedonase dhe të të folmeve shqipe të Tetovës me rrethinë në fushën e leksikut*, Albanologjia (International Journal of Albanology), Tetova.
- Sandfeld K. (1930) *Linguistique balkanique (problèmes et résultats)*, Paris: Librairie ancienne honoré champion, éditeur Édouard Champion.
- Ymeri-Bina, H. (2012) *Fjalor shqip-maqedonisht / Албанско-македонски речник*, Shkup.

## Abstrakti

*Në këtë kumtesë do të trajtojmë dy fjalorë dhe një libër bashkëbisedimesh, të cilat, besojmë se kanë qenë, janë dhe do të jenë çelës kryesor për ta njohur e për ta mësuar gjuhën e kulturën njëri-tjetrit në këtë pjesë të tokës që quhet Ballkan. Proverbat me kuptime të njëjta i kemi vjelë nga fjalori dygjuhësh, shqip – maqedonisht i autorit Haki Ymeri – Bina, që është botuar nga SHB “Logos-A” në vitin 2012, ndërsa fjalët me kuptime të njëjta nga fjalori shqip – maqedonisht (dhe anasjelltas) i autorëve V. Labroska, B. Sulejmani, H. Imeri-Bina, P. Atanasov, i botuar enkas për nxënësit e ciklit fillor (Shkup, 2016). Bie fjala, proverbi ose ndryshe thënë fjala e urtë dardha nën dardhë bie, maq. кpyyа нод кpyyа наза, siç shihet, me strukturë dhe me kuptim të njëjtë, domosdo dëshmon për kontakte e ndikime gjuhësore të këtyre dy gjuhëve, përkatësisht të të dy popujve më të mëdhenj në Republikën e Maqedonisë së Veriut.*

Fjalë kyçe: ballkanologji, gjuhë shqipe, gjuhë maqedonase, njësi leksikore.

## Abstract

*In this paper we will address two dictionaries and a book of conversations, which, we believe have been, are and will be the key to getting to know and learning each other's language and culture in this part of the world called the Balkans. Proverbs with the same meanings are taken from the bilingual dictionary, Albanian - Macedonian by Haki Ymeri - Bina, which was published by the publishing house "Logos-A" in 2012, while words with the same meanings from the Albanian - Macedonian dictionary (and vice versa) ) by V. Labroska, B. Sulejmani, H. Imeri-Bina, P. Atanasov, published especially for primary school students (Skopje, 2016). The word falls, the proverb dardha nën dardhë bie, macedonia: кpyyа нод кpyyа наза (english: pears under the pear falls), as seen, with the same structure and meaning, necessarily testifies to the linguistic contacts and influences of these two languages, respectively of the two largest peoples in the Republic of North Macedonia.*

Keywords: Balkanology, Albanian language, Macedonian language, lexical units.

ISSN 2671-3004

UDC 398:[930.85(38)  
398(=18)  
Punim studimor

**Sunaj RAIMI**

Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup  
Fakulteti i Shkencave Sociale  
E-mail: [sunaj.raimi@unt.edu.mk](mailto:sunaj.raimi@unt.edu.mk)

**DISA KOMPONENTË INTERKULTUROR NË FOLKLORIN E  
HELENËVE TË LASHTË DHE SHQIPTARËVE TË SOTSHËM****НЕКОИ ИНТЕРКУЛТУРНИ КОМПОНЕНТИ ВО ФOLKLOROT HA  
ДРЕВНИТЕ ХЕЛЕНИ И ДЕНЕШНИТЕ АЛБАНИЦИ****SOME INTERCULTURAL COMPONENTS IN THE FOLKLORE OF  
THE ANCIENT HELLENES AND MODERN ALBANIANS****Hyrje**

Synimi i kumtesës sime sociologjiko-kulturologjike me temë "*Disa komponentë interkulturor në folklorin e helenëve të lashtë dhe shqiptarëve të sotshëm*" është shpërfaqja e ca elementeve të folklorit të helenëve të lashtë, të cilat akoma jetojnë në folklorin e shqiptarëve të sotshëm. Vërtetimin e këtyre pohimeve për substancën antike të kulturës shqiptare jam orvatur ta bëj me anë të mbetëzave muzikore që akoma fshihen në rrënjët e melosit popullor shqiptar. Brenda këtij studimi, do të përpiqem të argumentoj se folklori shqiptar paraqet krijimtarinë kulturo-artistike më të rrallë në Ballkan e më gjerë, që deri më sot ka arritur ta ruaj embrionin e tij antik, me që tingujt e këtij melosi autentik, akoma mund të dëgjohen në dasmat, banquetet dhe solemnitetet popullore shqiptare. Për ta dëshmuar validitetin e këtij konstatimi, në këtë elaborim kam përmendur edhe disa hulumtime arkeologjike, muzikologjike dhe etnologjike të

hulumtuesve të huaj dhe vendorë, të cilat përmes këngëve, valleve dhe instrumenteve, qartazi flasin për linkun interkulturor në mes të folklorit shqiptar dhe atij të antikitetit helen.

Trungu

Nuk është ndonjë zbulim fantastik konstatimi se në periudhën e antikitetit helen, fiset e ndryshme të asaj kohe që jetonin në të njëjtin areal gjeografik, ekonomik dhe politik, kishin edhe lidhjet e tyre etno-tradicionale, sikur dhe ndikimet interkulturore reciproke. Këto interaksione sociokulturore mundësuan që këto komunitete sociokulturore, edhe përsikaj të dallimeve dhe specifikave të tyre subkulturore, të zhvillojnë disa elemente folklorike karakteristike, të cilat ndonjëherë i eksportonin te të tjerët, por ndonjëherë i importonin nga të tjerët. Këtu pra fshihet ai 'sekreti' i të ashtuquajturit 'interkulturalizmi ballkanik', i cili ka mundësuar që shumica e popujve që jetojnë në këtë Gadishull, të kenë folklor, këngë, valle dhe instrumente të ngjashme. Kështu kjo gjë ishte në kohërat antike, por kështu pak a shumë është edhe sot. Në këtë kontekst heuristik, kur bëhet fjalë për komponentët interkulturor në folklorin e helenëve të lashtë dhe shqiptarëve të sotshëm, lipset të nënvizohet fakti se kultura muzikore si fenomen, paraqet elementin kyç ku mund të shihet bashkëveprimi e ndërndikimi interkulturor në mes të popujve, e sidomos mes grekëve të lashtë dhe shqiptarëve të sotshëm.

Kështu, nëse dihen karakteristikat e rregullimit sociopolitik të dy shteteve udhëheqëse në Heladë - Athinës dhe Spartës, lehtë është të konkludohet se konform frymës së shtetit përkatës, ishte përshtatur edhe muzika. Në Athinën e atëhershme demokratike, standardet për muzikën e mirë ishin krejt tjera nga ato në Spartën luftarake. Pikërisht për shkak të këtyre shkaqeve muzika e athinasve ishte demokratike, lirike dhe romantike, ndërsa muzika e spartanëve ishte patriotike, epike dhe burrërore. Bazuar në këto premisa, detyra e filozofisë ishte që t'i sqarojë influencat eventuale të modaliteteve muzikore në mënyrën e të jetuarit tek dy qendrat e përmendura kulturore. Gjatë kësaj, filozofia ishte ajo që artikulonte konkretisht se cilat modele muzikore zgjojnë ndjenja të caktuara; cilat melodi e fisnikërojnë karakterin, e cilat jo; cilët instrumente janë të mira, e cilat duhet të mos përdoren. Sugjerimet e filozofëve në lidhje me ruajtjen dhe kultivimin e baraspeshës psiko-morale të bashkësisë shoqërore, treguan rezultate të ndryshme që ishin në përputhje me sistemin e shtetit. Vlen të theksohet se këto rekomandime të filozofëve më lehtë aplikoheshin në Spartë se sa në Athinë. Kjo ndodhte kështu sepse regjimi ushtarak rigjid i Spartës mundësonte

një kontroll të plotë jo vetëm mbi të gjitha ndodhitë shoqëroro-politike, por edhe mbi të gjitha ngjarjet e tjera kulturore artistike, e me këtë edhe mbi vetë muzikën. Mirëpo, në Athinën demokratike puna qëndronte ndryshe, pikërisht për arsye të lirisë së madhe të cilën e gëzonin qytetarët e saj (veçanërisht artistët, muzikantët), andaj dhe kontrolli mbi atë që ndodhte në botën muzikore të atjeshme ishte më i vështirë. Këtë e konfirmon edhe thirrja e çjerrur e filozofëve të asaj kohe (Platoni, Aristoteli) që i drejtohej demosit, me qëllim që populli të bëhet i vetëdijshëm për destabilizimin psikomoral të mundshëm, të cilën gjë sipas filozofëve, muzika pa problem mund ta shkaktonte.

Por, Platoni dhe Aristoteli nuk u kënaqën vetëm me një kritikizëm verbal, por këtë qëndrim të tyre e zbatuan edhe praktikisht në shkollat e tyre filozofike, ku nga planprogramet e tyre arsimore i larguan disa melose shqetësuese. Platoni p.sh, muzikën sentimentale dhe euforike i konsideronte si "fajtorë" për çekuilibrimin socio-moral të shtetit, për çka dhe kërkonte që performimet e tilla të ndalohen (Platoni, 1980 : 399). Kështu ishte edhe në Athinë, edhe në Spartë. Në zonën kulturore jonike me epiqendër në Athinë, roli shoqëror i muzikës konsistonte në krejt atë që kishte lidhje me arritjen e *ataraksisë* (paturbullshmërisë shpirtërore) dhe të lumturisë (në kuptim të argëtimit dhe rekreimit me muzikë). Por, në zonën kulturore dorike me epiqendër në Spartë, funksioni socio-moral i muzikës ishte sajimi i një personazhi tipik patriotik, me synim që ta edukojë ushtarakisht karakterin dhe temperamentin e qytetarëve në bashkësi. Si argumente të fuqishme për rolet e ndryshme që muzika i kishte në Athinë dhe Spartë janë format e ndryshme muzikore, përmes të cilave muzika i realizonte këto funksione specifike. Kështu, derisa muziktarët jonik këndonin për lumturinë, kënaqësinë dhe dashurinë, muziktarët dorik këndonin për guximin, trimërinë dhe atdhedashurinë. Kështu p.sh. derisa poetesha muzikale eolike nga Lesbosi - Safo (Sapfa) këndonte këngë sentimentale dhe erotike, spartani Tirtej përmes këngëve të veta apelonte në luftën heroike kundër armikut.

Për këtë shkak idealisti grek Platoni, duke bërë fjalë për këto probleme, e flaku poshtë muzikën jonike dhe lidike duke i quajtur ato si të ngathëta, ndjenjazbutëse dhe të dëmshme për bashkësinë, sepse mbjellnin përtaci (Platoni, 1980 : 131). Pra, mënyra e jetës jonike dhe dorike në mes veti dalloheshin varësisht se si kuptohej dhe ekzekutohej ajo muzikë në jetën e përditshme në polis. Kështu, derisa në qendrën kulturore jonike Athinë, muzika shfrytëzohej për

sigurimin e kënaqësisë dhe qetësisë shpirtërore të qytetarit, në qendrën kulturore dorike-Spartë, muzika përdorej si mekanizëm i edukimit ushtarak të mendjes dhe karakterit të qytetarit. Mirëpo "askush nuk mund të dëshmojë se Sparta, në krahasim me Athinë ishte vulgare dhe artistikisht e pafrytshme, sepse ajo nuk krijonte vepra prej fjalëve dhe gurit (apo tingujve, vërejtje e S.R.), por njerëz (Kito, 1963 : 111). Megjithatë në tërë Heladën ekzistonte bindja se *eneksia* (shëndeti ideal trupor dhe shpirtëror) nuk mundej të arrihej vetëm përmes gjimnastikës, por e domosdoshme ishte edhe muzika. Këtë e dëshmon edhe Platoni i cili duke folur për edukimin ideal të qytetarëve grek, thekson se edukatë të përsosur ka vetëm ai i cili "di t'i bashkojë më bukur edukatën muzikore dhe gjimnastikën" (Platoni, 1980 : 412).

Nga ana tjetër, atribut i përbashkët i muzikës së dy qendrave kulturore-artistike në Heladë: Athinë dhe Spartë, ishte ai se ngjarjet më të rëndësishme nga jeta private dhe shoqërore shënoheshin me muzikë dhe valle të njejta, përkatësisht me forma dhe instrumente muzikore adekuate. Kështu p.sh, në të dy qytetet-shtetet e përmendura, me rastin e solemniteteve familjare, kur vajzat lidhnin kurorë, këndoheshin himeneje (këngë dasme); kur organizohej ndonjë gosti, këndoheshin skolione (këngë dollie); për madhërimin e shëndetit dhe mirëqenies njerëzore këndoheshin peane (këngë shëruese); me rastin e vajtimit dhe lavdërimit të të ndjerit këndohej kënga e quajtur tren (këngë lavdëruese për dëshmorët). Ngjashëm veprohej edhe gjatë inaugurimeve solemne që mbaheshin publikisht nëpër sheshe si p.sh, kur shpallej fituesi i agoneve këndoheshin epinikie (këngë triumfale të garave olimpike), apo kur lavdërohej organizatori i ndonjë manifestimi gjithëpopullor këndoheshin enkomie (këngë falënderuese për ndonjë kontribut të veçantë), e kështu me radhë.

Është shumë interesante të venerohet fakti se për ndryshim nga muzika e civilizimeve lindore (Egjypti, Persia), ku kjo degë artistike në aspektin ontologjiko-gnoseologjik ishte me orientim pesimist, duke iu dedikuar lumturisë në jetën e pasvarrit, muzika e Heladës ishte me përcaktim optimist, me që e mëtonte lumturinë në jetën e kësaj bote! Në këtë drejtim, duhet theksuar se edhe ilirët e moçëm kishin forma të ndryshme të këngëve, valleve dhe veglave muzikore, të cilët i përdornin për qëllime të caktuara dhe në raste të ndryshme, si në jetën pagane, ashtu edhe në atë religjioze. Krijimtaria muzikore ilire, sikur edhe ajo helene gjatë zhvillimit të saj të bujshëm, vazhdimisht ka qenë nën goditjen e luftërave

shkatërruese, epidemive dhe kataklizmave dërrmuese, gjë që kishte shkaktuar zhdukjen e pjesës më të madhe të dëshmive. Megjithatë, sot ekzistojnë mjaft burime të autorëve grekë dhe romakë, të cilët me sukses kanë arritur ta demistifikojnë enigmën e madhe të quajtur muzikë antike.

Përshkrimet dhe krahasimet e ndryshme për kulturën muzikore të lashtësisë që i gjejmë në veprat e Homerit, Aristotelit, Strabonit, Ksenofontit, Lukianit, Plutarkut, Tit Livit, Ciceronit, Ateneut, Galenit, Plinit etj, na japin një brum të mjaftueshëm për të kuptuar se çfarë ka qenë muzika e të parëve tanë. Edhe arkitektura, skulptura, qeramika, mozaiku dhe numizmatika e gjetur në lokalitetet ilire na tregojnë qartë për nivelin e lartë të jetës kulturore-artistike. Nga këto fakte mund të kuptojmë se jeta muzikore e stërgjyshërve tanë ishte shumë e pasur. Ata i kultivonin thuajse të gjitha këngët dhe vallet që interpretoheshin në atë areal kulturor antik, duke filluar prej këngëve lirike, epike, elegjike, e deri te vallet ceremonike në amfiteatre, tempuj dhe odeone. Pikturat, skulpturat dhe basoreliefet e ndryshme të lashta, ku paraqiten skena të ndryshme me instrumentistë, këngëtarë dhe valltarë nuk janë pjellë e fantazive të artistëve, por pasqyrim besnik i realitetit të atëhershëm kulturo-artistik. Paraqitja e pamjeve të këtilla nuk ka patur thjesht karakter dekorativo-estetik, por ka shprehur nevojat shpirtërore të njerëzve të atyre vendeve. Është shumë me rëndësi të theksohet se në disa zona të kësaj ekumene kulturore të lashtë, edhe sot mund të gjejmë instrumente, këngë dhe valle antike që përdoren në folklorin etnomuzikor shqiptar. Kjo dëshmon për kultin e popullit shqiptar ndaj muzikës, i cili edhe përskaaj shumë peripecive dramatike nëpër histori, arriti ta ruaj dhe ta përcjellë këtë traditë muzikore të lashtë deri në ditët tona. Kjo përçueshmëri e çuditshme e materies muzikore antike nga ilirët antik tek shqiptarët e sotshëm mund të argumentohet me mjaft shembuj.

Duke folur për këto momente, muzikologu shqiptar Z. Ismaili në librin e tij "*Muzika nëpër shekuj*" shkruan: "Fillova të meditoj për të kaluarën e lashtë shqiptare, gjithnjë duke u mbështetur në tezën e prejardhjes sonë pellazgjike, tezë e cila është e pakontestueshme. Nisa të qëmtoj së pari në historinë e grekëve (muzikë, kulturë, arte, shkencë ), gjithnjë i prirur nga premisat për të akceptuar ato elemente që përkonin me karakteristikat dhe tiparet e përkatësisë dhe etimologjisë së tyre shqiptare, por duke u bazuar edhe në zhvillimin e tyre sinkronik dhe diakronik. Jonet e tyre e ruajtën ngjyrën dhe jehonën e përkatësisë etnike, që i sollën shekujt nga

thellësia e tyre, të pastra ashtu siç na i lanë në trashëgimi të parët tanë" (Ismaili, 2000 : 44-45). Kështu bie fjala, vegla frymore e lashtë me dy tyta e quajtur *diaulos* që mund të shihet në disa basoreliefe dhe skulptura (Tole, 2000 : 74) e gjetur në vendbanimet ilire (shek. III-II p.e.s), mund të shihet edhe sot tek banorët shqiptar të këtyre trevave. Kremtimi i festës pagane "Llazarët" që tradicionalisht praktikohet me 1 Maj në zonën e Lunxhërisë ku banonte fisi ilir i kaonëve, si një festë rituale e motmotit (Bogdani, 1995 : 42-43) është një variant i festave antike kushtuar Dionisit, ku pjesëmarrësit duke kënduar dhe vallëzuar talleshin dhe argëtoheshin. Mjaft indikative është edhe vallja e njohur "premja me tagana" e Malësisë së Madhe, rrethi i Shkodrës, (Bogdani, 1995 : 45-53), për të cilën mendohet se është relik i *valles pirrike*, që siç thuhet, Leka i Madh e kishte kërcyer rreth varrit të Teodotit, para se të nisej për Persi. Lidhur me këte R. Sinani e përmend përshkrimin e Ksenofontit për thrakasit që kërcenin një valle sipas tingujve të fyellit, duke u hedhur lartë me lehtësi, e duke u tundur e duke përplasur shpatat, derisa njëri godiste rëndë tjetrin i cili shtrihej sikur rrëzohej, ndërsa fitimtari ia merrte armët dhe shkonte duke kënduar (Sokoli, 1971 : 7). Përveç kësaj, këtë kontinuitet të trashëgimisë muzikore antike në muzikën shqiptare e dëshmon edhe truporja e një aktori nga teatri i Bylisit (Hekali i Mallakastrës), qëndrimi këndues i të cilit aq shumë ngjan me qëndrimin e këngëtarëve tonë popullorë të veriut, derisa këndojnë të ashtuquajturat "majekrahe" (Sokoli & Miso, 1991 : 23). Vlen të përmendet edhe qeramika e gjetur në rrethin e Durrësit, që daton para 24 shekujve, ku është paraqitur një grua e cila këndon duke e dridhur fytin me dorë, që përngjet me këngëtarët tanë popullorë të jugut që mbajnë "*iso*", që paraqet karakteristikën kryesore të polifonisë shqiptare të famshme.

Le t'i kthehemi tani pak analizimit më të hollësishëm të formave vokalo-instrumentale dhe mënyrës se si këto trajta muzikore antike e kryenin funksionin e tyre moralo-edukativ dhe psiko-social. Meqenëse, secila nga format e përmendura veç e veç, e luante rolin e caktuar saktësisht. Kështu p.sh. hymni kishte rol psikologjik, sepse grekët besonin se perënditë që madhëroheshin në këto këngë do t'i mbrojnë njerëzit nga rreziqet, andaj edhe ata jetonin pa frikë; prozodia kishte funksionin moral meqë shërbente për sforcimin e vullnetit dhe durimit të pjesëmarrësve në ceremonitë religjioze; peani ishte një këngë me rol psiko-moral meqenëse duke iu dedikuar Apolonit – Perëndisë së jetës dhe shëndetit, ajo kishte për qëllim që tek njerëzit t'i zgjojë ndjenjat për shëndet, gëzim dhe

lumturi (Saks, 1980 : 295); gjimnopedia – e cila kishte detyrë që ta freskojë gjendjen psiko-fizike të njerëzve, meqë muzika e saj ritmike njerëzit i bënte të disponuar për ç'arsye kjo zakonisht rekomandohej në orët e mëngjesit, kur njerëzit përgatiteshin për kryerjen e aktiviteteve të përditshme të tyre (vlen të theksohet se në disa shtete me kulturë tradicionale si në Kinë ose Japoni, edhe sot ky funksion i muzikës gjallëron); ditirambi – ishte një këngë me influencë psiko-morale, sepse duke iu dedikuar Dionisit – Perëndisë së verës dhe qejfeve, tek njerëzit mbjellte optimizëm dhe ndjenjë të lumturisë; treni – ushtronte funksion të pastër moral, sepse jo vetëm që i përkëdhelte ndjenjat e lënduara të farefisit të të ndjerit, por edhe ua zgjonte ndjenjën e krenarisë atyre (Andreis, 1965 : 52); epitalami – shërbente si këngë e cila ushtronte veprim psikomoral tek të sapomartuarit para natës së parë bashkëshortore, me që përmbajtja e saj miqësore, e sinqertë dhe solidare, i çlironte partnerët bashkëshortorë nga ndjenjat e shqetësimit dhe defetizmit, duke i bërë ata më të relaksuar dhe më vetëbesues në natën më intime të jetës; skolioni ishte këngë që kishte rol specifik puro-hedonist, meqenëse karakteri i tij euforiko-boemik i obligonte të gjithë pjesëmarrësit në aheng të pijnë dhe të këndojnë, me çka të gjithë bashkërisht hynin në një botë tejet të hareshme miqësore, ku përmes metodës së këngës normat shoqërore konvencionale shpërfillëshin, kurse ndjenjat natyrore për relaksim, hare dhe kënaqësi dominonin. Dhe më në fund, kuptohet se ndikimin më të madh edukativ moral prej të gjitha këtyre formave muzikore të përmendura e ka ushtruar tragjedia, e cila si formë muzikore më influente poetiko – dramaturgjike ka patur për detyrë që ta shpërblajë dhe pastrojë njeriun nga eksceset e pamoralshme, manipulimet politike dhe bestytnitë shoqërore. Temat e tragjedive të atëhershme, kryesisht i dedikoheshin luftës së heronjve kundër fatit të tyre dhe luftës për atdhe (Пејовић, 1969 : 36).

Vlen të theksohet se një funksion të tillë katarzik moralo-edukativ muzika folklorike shqiptare (sidomos ajo me çifteli apo lahutë) ende e ushtron fuqishëm tek populli jonë. Në folklorin tonë muzikor ekzistojnë shumë këngë të tilla të cilat trajtojnë ngjarje të ndryshme dramatike nga e kaluara apo e tanishmja e popullit tonë. Kënga e këtillë e rapsodit shqiptar (shahirit) e cila duke përshkruar ngjarje dhe situata të ndryshme tronditëse që të ngjethin mishtë, shndërrohet në një gjykatës socio-moral i cili e dënon tradhtinë, qyqarinë dhe incestin, siç edhe e lavdëron burrërinë, trimërinë apo solidaritetin. Këndimi i këngëve me karakter të tillë, tek shqiptarët

është kultivuar tradicionalisht me një dashuri të madhe nëpër "oda të burrave", sepse gjeneratat e reja kështu e ndërtonin sistemin e tyre të vlerave, me ç'rast e kuptonin se çka është ajo që populli e dëshiron, e çka ajo që e dënon. Në këtë kontekst është me rëndësi të përmendet edhe roli etiko-shoqëror i vronjës (një si zëdhënës që përdoret nga arbëreshët e Italisë Jugore për demaskimin e shkelësve të mirësjelljes); tallja apo shpallja e sjelljeve të pahijshme nëpërmjet këtij zëdhënësi, duke nxjerrë në shesh të palarat e njerëzve, ka vepruar si mjet kontrolli shoqëror dhe ka ndihmuar për mënjanimin e disa dobësive (Sokoli & Miso, 1991 : 13-86). Mendoj se të gjitha këto raste që i përmendëm deri më tani qartë flasin për embrionin antik të folklorit tonë muzikor.

Mirëpo, një krahasim i këtillë hermeneutik, sipas mendimit tim mund të bëhet edhe në mes të këngës patriotike spartane dhe të asaj heroike shqiptare, e cila materie antike akoma jeton në indin e folklorit shqiptar. Në këngët e këtilla heroike shqiptare (këngë kreshnike apo krahina) ngjashëm me ato spartane, me çifteli, sharki ose me lahutë madhërohet trimëria, burrëria dhe bujaria. Me të drejtë shkruan I. Kadareja se vjersha popullore dhe kënga ishte vlerësimi më i lartë, që populli u jepte ngjarjeve dhe njerëzve. Me një fjalë, hierarkia e këngës ka qenë më e nderuara për njeriun shqiptar (Kadare, 1980 : 33). Sikur këngët që luhen me lahutë, ashtu edhe vetë veglat kanë lindur nga ndjenja e thellë për të lartësuar kultin e të parëve. Ato flasin për një traditë të brumosur, të formuar në kushte të caktuara ekonomiko-shoqërore të një rendi fisnor. Së bashku me lahutën, me të u është bërë jehonë ngjarjeve të shumta të lavdishme të popullit tonë ndër shekuj, duke i përcjellë brez pas brezi deri në ditët tona. (Sokoli & Miso, 1991 : 216.) Në relacion me këtë mund të thuhet se, kënga heroike spartane dhe kënga kreshnike shqiptare në tre pika qëndrojnë në një emërues të përbashkët: e para në aspektin poetik, sepse tekstet e tyre kanë të njëjtin subjekt e ky është patriotizmi, e dyta në aspektin muzikor, sepse që të dyja shërbehen me të njëjtën shkallë muzikore - atë dorike dhe e treta sepse në të dyja muzikat fjalën kryesore e kanë instrumentet kordofone (me tela). Kështu, përputhja poetike përmbajtjesore në mes të teksteve të këngëve patriotike spartane dhe atyre kreshnike shqiptare për një laik mund të duket e rastësishme, por për atë që e njeh mirë frymën e kulturës dhe traditës së lashtë shqiptare, nënkupton faktin se muzika kreshnike shqiptare ka rrënjë antike dhe se paraqet një vazhdimësi të atij kreativiteti artistik popullor të lashtësisë. Ky konstatim mund të mbështetet në disa argumente: e para, si tek spartanët ashtu edhe

tek shqiptarët, gjithmonë ka mbisunduar një edukim patriarkal, ku kujdes i posaçëm i është kushtuar formimit të personalitetit të shëndoshë moral të të rinjve; e dyta, ngjashëm me spartanët edhe tek shqiptarët, ka ekzistuar një kult i veçantë ndaj mënyrës së jetës heroike, burrërore, stoike ku numri më i madh i këngëve popullore dhe i atyre folklorike u janë përkushtuar trimave dhe dëshmorëve, të cilët nëpër këto këngë madhërohen me një dhembshuri krenare, që është specifike për të gjithë popujt e lashtë; dhe e treta, duke u bazuar në disa fragmente të gjetura që përmbanin këngë spartane, vërtetohet qartë se shkalla muzikore me të cilën janë ekzekutuar këto këngë spartane, sot e më ditë përdoret në melosin shqiptar (shkalla dorike), gjë që zbulon përmbajtjen antike të kulturës muzikore shqiptare.

Prof. Eqrem Çabej duke bërë fjalë për origjinën iliro-epirote të gjuhës, kulturës dhe muzikës shqiptare shkruan se teoria e burimit ilir përveç dëshmimeve gjuhësore, ka në dorë edhe arsye të forta historike, ngaqë shqiptarët kanë të përbashkët me ilirët e moçëm truallin e banimit. (Çabej, 1976 : 60). Këtu vlen të përmendet edhe një unazë e shek. XV p.e.s gjetur në një kodërvarr ilir në Çinamak të Lumës, në gurin e së cilës është gdhendur figura e Panit brinoç me këmbë dhie (mbrojtësi i barinjëve dhe bagëtive) i cili luan në diaulos (apo me emërtimin shqiptar *biculë*), gjë që tregon për përdorimin e lashtë të këtij instrumenti në trevat e banuara me shqiptarë. (Sokoli & Miso, 1991 : 27). Në këtë kontekst është e vlefshme të theksohet fakti se në disa treva malore të Shqipërisë, ende mund të hasen vegla muzikore me pamje dhe strukturë si në antikë. Kështu p.sh lahuta e këtyre zonave ende ndërtohet nga guaska e breshkës ngjashëm me lyrën antike.

Një formë muzikore antike që akoma është prezente në folklorin shqiptar të sotit është edhe kënga e quajtur tren, e cila është këngë vajtuese shumë e vjetër që ka ekzistuar qysh në kohën arkaike. Në epin "*Iliada*" Homeri në mënyrë tejet emocionale e përshkruan momentin kur pas vdekjes së Hektorit, Andromaka, Hekuba dhe Helena e vajtonin Hektorin dhimbshëm duke kënduar trene. Mirëpo, treni nuk ishte vetëm një vajtuese e thjeshtë me të cilën vajtohej i ndjeri, por ai ishte edhe një lloj kënge e dhimbshme me të cilën lavdëroheshin dëshmorët. Një këngë me përmbajtje të këtyllë mund të haset edhe sot në disa vise malore të banuara me shqiptarë. Lidhur me këtë Faik Konica thoshte se "ajo që do të ofrojë ndoshta një interes të ri, para së gjithash janë vajtimet, trenet, ato gjëmë, kuisje (lamentations) të ritmuara që gratë shqiptare i improvizojnë mbi

varrin e të vdekurve, karakteri antik i të cilave shpesh i ka mahnitur udhëtarët që kaluan andej". (Konica, 1990 : 118). Këngët e tilla i gjejmë edhe në gojëdhënat e njohura shqiptare si bie fjala në "*Legjendën e Fjalës së Dhënë*" (Konstandini e Doruntina) ku nëna e Konstandinit e mbetur qyqe, ditën e të vdekurve shkon tek varri i djalit duke i kënduar gjëmën: "*Konstandin, të ardhhtë gjëma, ku e ke besën që më dhe? Besa jote nën dhe...*" (Kadare, 1980 : 24).

Por, antikiteti i muzikës shqiptare nuk argumentohet vetëm me anë të mbijetimit të këtyre këngëve heroike-kreshnike të ne deri në ditë të sotit, por edhe me gjallimin e formave të tjera muzikore që ishin karakteristike për atë kohë si partenitë, himenejet, epitalamet, të cilat në viset shqiptare ende jetojnë duke u kultivuar me një dashuri të madhe nëpër dasma. Është e vërtetë e pamohueshme se tek shqiptarët, partenia - këngë me motive vajzërore edhe sot me ëndje këndohen në të gjitha ndejat, fejesat dhe martesat e vajzave shqiptare. Ky lirizëm antik i vajzave tona mund të shihet edhe në vargjet e një kënge popullore që këndohet me defe nëpër dasma vajzash në rrethin e Kumanovës, Maqedoni: *Seç na paska Lulija, o një pikë në ballë / Nuse, nuse, nuse o, më e bukura n`mahallë; Seç na paska kjo Lulija, o syrin mavi / Nuse, nuse, nuse o, të gjithë ta kanë zili. Pastaj, himeneji që është një këngë e hareshme dasme, e cila këndohej nëpër gostitë familjare solemne, gjegjësisht kur të rinjtë (çifti bashkëshortor) martoheshin. Ajo këndohej në shoqërim, jo vetëm nga muziktarët, por edhe nga pjesëmarrësit e solemnitetit. Në këso ahengjesh ekzistonin dy lloje himenejesh: ai mashkullor, të cilin e këndonin beqarët dhe femëror, që këndohej nga beqareshat. Këngë të këtilla akoma këndohen thuajse në të gjitha viset shqiptare. Ndërkaq, epitalami ishte një këngë romantike që i përkushtohej të porsamartuarve, në shenjë dëshire për harmoni dhe lumturi gjatë natës së parë bashkëshortore. Temat e këtyre këngëve, në realitet ishin fragmente nga jeta e muajit (hënës) së mjaltit. Epitalamin e këndonin të gjithë pjesëmarrësit e ahengut, sepse nata e parë bashkëshortore, njëkohësisht ishte edhe natë e veçantë për të gjithë të rinjtë tjerë aty. Këngë të tilla janë prezente thuajse në të gjitha martesat shqiptare, me ç`rsat lavdërohen virtytet e të porsamartuarve, ku anëtarët e familjes së nuses e lavdërojnë nusen, kurse ata të dhëndrit e lavdërojnë dhëndrin. Ja disa fragmente të këngëve me motive të këtilla që këndohen në anën e Kumanovës: 1) *Oj hana kur del, oj hana kur del, ma i mirë vëllau jonë, se nusja me tel* (kur lavdërohet dhëndri); 2) *Ky oborri jonë me lajthia, oj kutia jonë**

*me gurabija, kutia jonë çilet e mshilet, motra jonë kollaj s`mirret* (kur lavdërohet nusja).

Mirëpo, ajo që çudit më tepër këtu është funksioni psikologjik i këtyre këngëve, i cili është akoma i fuqishëm si në kohën antike. Sipas kësaj, të gjitha këto këngë që edhe sot me aq pasion këndohen ndër ne nga ana e farefisit të nuses apo dhëndrrit të përcjellura me defe, kanë për qëllim që ta relaksojnë shpirtin e trazuar të çiftit të ri, ta çlirojnë atë nga frika se ndoshta nuk do t'i pëlqejnë njëri-tjetrit apo familjes së tij, duke ua ngjallur të rinjve krenarinë e duke ua forcuar vetëbesimin për martesë të suksesshme. Ndjej detyrim të nënvizoj se këngë të këtilla ku akoma ndjehet performanca e dasmave antike, përveç se të shqiptarët, vështirë se mund të gjenden sot në Gadishullin Ballkanik. Ky konsatim vlen edhe për grekët e sotshëm, që për shkak të modernitetit dhe ceremonive proeuropiane të cilat janë futur thellë në të gjitha poret e jetës shoqërore të tyre, këngët dhe ritualet tradicionale u janë zbehur aq shumë, sa që nuk iu ngjajnë më atyre antike. Kurse në anën tjetër, shumë rituale dasmash të shqiptarëve të sotshëm ende e ruajnë thelbin autentik pagan të botës antike. Vazhdimin e këtij kontinuiteti antik në traditat shqiptare të sotit e dëshmojnë edhe një mori elementesh koreografike, duke filluar nga kostumet që shëmbëlajnë aq shumë me ato të antikitetit e deri te karakteri i këngëve, modeli i valleve, vendi i manifestimeve, llojet e veglave muzikore etj (Bogdani, 1995 : 38-48).

### Përfundimi

Vlen të theksohet se disa aspekte të këtyre tezave mbi lashtësinë e muzikës shqiptare, i gjejmë të shkapërderdhura edhe në fushën e letërsisë sonë, linguistikës dhe folkloristikës. Nëpër këto vepra jo rrallë herë mund të hasim përpjekje të shkrimtarëve, gjuhëtarëve e folkloristëve të ndryshëm, të cilët përmes shembujve dhe argumenteve përkatëse, mundohen ta gjejnë dhe ta shpjegojnë rrënjën e kulturës dhe artit popullor shqiptar, pra edhe të vetë muzikës sonë. Është interesante se edhe poeti i njohur malazias dhe mbledhësi i folklorit Petar P. Njegosh, e kishte zakon të bënte krahasim në mes të muzikës heroike spartane dhe këngës heroike malazeze me lahutë, me qëllim që ta dëshmojë substancën antike në muzikën malazeze. Një detyrë të këtillë mjaft të vështirë për argumentimin e rrënjëve antike të kulturës sonë shqiptare mbi vete e mori edhe shkrimtari ynë i shquar Ismail Kadare, i cili në veprën e tij "*Dosja H*" mundohet të hedh dritë në këto çështje. Kadare këtë gjë na e përshkruan në mënyrë impresive përmes misionit specifik të dy

homeristëve irlandez Maksit dhe Vilit, të cilët kishin ardhur në Shqipëri për të hulumtuar "platformën e një parauniversi të përbashkët greko-iliro-shqiptar". Interesant është fragmenti ku Kadareja shkruan për titujt e gazetave të njohura botërore, të cilat kishin botuar artikuj për misionin specifik të këtyre dy hulumtuesve. Në ato gazeta në mes tjerash shkruante: "Dy shkencëtarë të rinj irlandezë atakojnë prapë problemin homerik në një mënyrë krejt origjinale. Është fjala për zotërinjtë Maks Roth e Vili Norton që, ndryshe nga tradita shekullore, kanë shkuar të vërtetojnë çështjen në vend. I papritur është në këtë rast fakti që kërkimet nuk kryhen në atdheun e Homerit, por në Shqipërinë fqinje, ku thuhet se teknika e poezisë epike është ende e gjallë ashtu si tri mijë vjet më parë" (Kadare, 1990 : 152). Mirëpo, ky vendim i antropologëve irlandez Max dhe Vili që hulumtimet e tyre t'i bënin në truallin shqiptar nuk ishte lojë e rastit, por rezultat i një studimi të gjithanshëm teoriko-empirik të tyre. Ata e dinin mirë që përveç se në Shqipëri askund në vendet ballkanike (as në Greqi) nuk mund të hasen këngëtarë dhe rapsodë të lozës së Homerit, të cilët janë në gjendje të këndojnë këngë epike edhe me mbi 1000 vargje!? Kjo na tregon në një mënyrë se "zona shqiptaro-ilire, ishte ara folklorike që kishte ushqyer letërsinë dhe artin e madh antik grek" (Kadare, 1990 : 152).

Analizat, konstatimet dhe shembujt e përmendur në këtë punim, janë vetëm disa nga argumentet e shumtë me të cilat mund të provohet substanca antike e folklorit muzikor shqiptar. Edhe pse sot është mjaft vështirë ta dëgjojmë kumbimin origjinal të muzikës së të parëve tanë, ashtu siç e kanë krijuar dhe dëgjuar atëbotë ata, sepse ajo është gllabëruar nga heshtja e kohës, është fakt i pakontestueshëm se varietetet e kulturës muzikore të lashtësisë ende jehojnë nëpër trojet tona shqiptare.

## Literatura

1. Platoni: *Shteti*, Rilindja, Prishtinë, 1980.
2. Saks, Kurt: *Muzika starog sveta, Univerzitet umetnosti*, Beograd, 1980.
3. Bogdani, H. Ramazan: *Vallet e Lunxhërisë, Sindikalisti*, Tiranë, 1995.
4. Кито, Х.Д.Ф: *Грци*, Матица Српска, Нови Сад, 1963.
5. Ismaili, *Zejadin: Muzika nëpër shekuj*, Vatra, Shkup, 2000.
6. Sokoli, Ramadan & Miso, Pirro: *Veglat muzikore të popullit shqiptar*, Tiranë, 1991.
7. Çabej, Eqrem: *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1976.
8. Kadare, Ismail: *Dosja H*, Rilindja, Prishtinë, 1990.
9. Konica, Faik: *Vepra*, Copa letrare, Letërsia shqipe, Tiranë, 1990.
10. Đurić, Milos; *Istorija helenseke etike*, Zavod za udžb. i nast. sredstva, Beograd, 1987.
11. Kalem, Spiro: *Historia e Muzikës I*, Mihal Duri, Tiranë, 1988.
12. Aristoteli, *Poetika*, Rilindja, Prishtinë, 1984.
13. Andreis, Josip: *Povijest glazbe*, Liber, Mladost, Zagreb, 1965.
14. Tole, T. Vasil: *Folklori muzikor*, SH.B.L.U, Tiranë, 2000.
15. Bogdani, Ramazan: *Gjurmime koreografike*, Eurorilindja, Tiranë, 1995.
16. Sokoli, Ramadan: *Vallet dhe muzika e të parëve tanë*, Qendra e kr. pop, Tiranë, 1971.
17. Пејовић, Роксанда: *Историја музике*, З.И.У.С.Р.С, Београд, 1969.
18. R. Sokoli dhe P. Miso: *Veglat muzikore të popullit shqiptar*, Tiranë, 1991.
19. Hanslick, Eduard: *O muzički lijepom*, BIGZ, Beograd, 1977.
20. Kadare, Ismail: *Autobiografia e popullit në vargje*, Naim Frashëri, Tiranë, 1980.

**Abstract (english)**

*The subject matter of my sociological-culturologic paper on "Some intercultural components in the folklore of the ancient Hellenes and modern Albanians" is the discussion of some elements of the ancient Hellenes folklore, which still generate in the folklore of today's Albanians. My preoccupations will be the comparative analysis and sociocultural interpretation of some ancient components in Albanian folklore, with the help of various researches of eminent scholars of the ancient period, but also of our time. I have tried to argue these theses presented for the ancient substratum of Albanian culture by means of musical remnants that still breathe in the roots of the Albanian folk melody. In the continuation of this study, I will try to prove that Albanian folklore is among the rarest cultural and artistic creations in the Balkans and beyond, which to date has managed to preserve its ancient embryo, with the sounds of that melody still can be heard at Albanian weddings, banquets and solemnities. To prove the validity of this finding, in my study I have demonstrated some archaeological, musicological and ethnological research of foreign and local researchers (songs, dances and instruments), which clearly speak of the intercultural link between Albanian folklore and that of Hellenic antiquity. Keywords: interculture, Hellenic music, Albanian folklore, songs, dances, instruments.*

**Abstract (shqip)**

*Syzheja e kumtesës sime sociologjiko-kulturologjike me temë "Disa komponentë interkulturor në folklorin e helenëve të lashtë dhe shqiptarëve të sotshëm" është sheshitja e disa elementeve të folklorit të helenëve të lashtë, të cilat akoma gjenerojnë në folklorin e shqiptarëve të sotshëm. Në fokusin e preokupimeve të mia do të jetë analiza komparative dhe interpretimi sociokulturologjik i disa komponentëve antik në folklorin shqiptar, me ndihmën e hulumtimeve të ndryshme të studiuesve eminent të periudhës antike, por edhe të kohës sonë. Argumentimin e këtyre tezave të parashtruara për substratin antik të kulturës shqiptare jam orvatur ta bëj me anë të mbetëzave muzikore që akoma frymojnë në rrënjët e melosit popullor shqiptar. Në vazhden e këtij studimi, do të orvatem të vërtetoj se folklori shqiptar është ndër krijimtaritë kulturo-artistike më të rralla në Ballkan dhe më gjerë, i cili deri më sot ka arritur ta ruaj embrionin e saj antik, me që tingujt e atij melosi akoma mu të dëgjohen në dasmat, banketet dhe solemnitetet popullore shqiptare. Për ta dëshmuar validitetin e këtij konstatimi, në studimin tim kam demonstruar disa hulumtime arkeologjike, muzikologjike dhe etnologjike të hulumtuesve të huaj dhe vendorë (këngë, valle e instrumente), të cilat qartazi flasin për linkun interkulturor në mes të folklorit shqiptar dhe atij të antikitetit helen. Fjalët kyçe: interkultura, muzika helene, folklori shqiptar, këngët, vallet, instrumentet.*

ISSN 2671-3004

UDC 7:316.723-021.463  
Punim studimor**Mixhait POLLOZHANI****Universiteti i Tetovës, Tetovë**  
mixhait\_p@yahoo.com**ARTI SI VEPRIMTARI E KULTIVIMIT TË INTERKULTURALIZMIT****УМЕТНОСТА КАКО ДЕЈНОСТ ВО НЕГУВАЊЕТА НА ИНТЕР-  
КУЛТУРАЛИЗМОТ****ART AS AN ACTIVITY OF CULTIVATION OF INTERCULTURALISM**

## Hyrje

Pjesa më e madhe e shoqërive, historikisht, kanë qenë dhe vazhdojnë të mbeten në strukturën e tyre multikulturore, ndaj dhe si nevojë e një realiteti të këtillë ai ka imponuar nevojën e promovimit të interkulturalizmit (lexo shqip: ndërkulturalizmi). Përderisa, multikulturalizmi reflekton realitetin shumë-kulturor brenda një shoqërie, apo një shteti, ndërkultura vazhdon të zhvillohet dhe të marrë përmasat e një disipline të veçantë shkencore shumë të rëndësishëm, por jo edhe gjithaq e akceptuar në shoqërinë bashkëkohore. Për të qenë akoma më të qartë, duhet theksuar se ndërkulturalizmi ve në pah marrëdhëniet midis kulturave dhe domosdoshmërinë e ndërveprimit reciprok të tyre. Ndërkulturalizëm, pra, do të thotë trajtim i problemeve që lindin në marrëdhëniet midis bartësve të kulturave të ndryshme, pranimin dhe respektimin e tyre.

Përderisa teoricien të ndryshëm vazhdojnë me përpjekjet e tyre për të zbërthyer dhe definuar deri në fund se çfarë përbënë dhe

çfarë paraqet ndërkultura dhe cili është roli dhe kontributi i saj në shoqëri, bota, sidomos shoqëritë më të avancuara të saj, pothuajse e kanë kuptuar tërësisht rëndësinë e saj, ndaj dhe po i japin vendin e duhur asaj në politikat shtetërore të tyre. Njohja dhe reflektimi i diversitetit midis kulturave si një pjesë integrale e identitetit të tyre dhe element që mundëson dhe inkurajon komunikimin dhe bashkëpunimin, përbënë një fenomen të paevitueshëm të shoqërisë postmoderne. Promovimi i diversitetit kulturor dhe komunikimi ndërkulturor nëpërmjet afirmimit të kulturës figurative janë faktorët domethënës të cilët mund të kontribuojnë në ekuilibrimin e raporteve midis komuniteteve të ndryshme.

Për ta respektuar thelbin e tezës bosht të parashtruar nga organizatori "Arsimi interkultural" dhe për t'iu përmbajtur suazave të saj, nëpërmjet kësaj kumtese do të përpiqemi që të sjellim një këndvështrim të rolit dhe reflektimit të artit figurativ si segment i rëndësishëm multikulturor në dobi të ndërkulturalizmit. Ndërkaq, ndërkulturalizmi funksionon si rezultat i ndërthurjes së më shumë fushave socio-kulturore, përfshirë këtu edhe veprimtaritë e ndryshme artistike. Nga tërë ajo gamë e gjerë artesh ne kemi zgjedhur artin pamor, përkatësisht artin figurativ, i cili padyshim që është një ndër promotorët tejet të drejtpërdrejtë dhe mjaft produktiv në kultivimit dhe promovimit e vlerave multikulturore.

### **Interkulturalizmi dhe krijimtaria e piktorit Koxhoman**

Pra, për të shpjeguar domethënien dhe rolin e artit në shoqëri, duhet marrë parasysh relacionin e tij me disiplinat tjera shkencore dhe artistike. Duke qenë se edhe arti është subjekt i rëndësishëm arsimor, kurse, arsimi paraqet një nga faktorët kryesore të cilët ndihmojnë që nëpërmjet krijimtarisë artistike ta njohim më mirë botën rreth nesh. Por, para se gjithash duhet ditur përgjigjur e dy pyetjeve kyçe ontologjike që burojnë nga filozofia artit, ose thënë ndryshe përgjigjen e dy varianteve të cilat burojnë nga një pyetje kryesore, dhe ato janë: "Çfarë është arti?" dhe "Çfarë është një vepër arti?" Në dukje këto pyetje janë të thjeshta, për të cilat shumëkush mbase mendon se mund t'u përgjigjemi në mënyrë intuitive. Por çështja e shpjegimit të artit është më substanciale dhe kërkon një qasje komplekse shkencore.

Në përgjithësi mund të themi se arti një aktivitet i veçantë njerëzor përfshin "entuziazmin" krijues, krijimin dhe formësimin (estetik) të një vepre dhe përjetimin e saj. Ndërsa, vepra e artit

vepron mbi arsyen, ndjenjat dhe imagjinatën, duke e fisnikëruar njeriun dhe kulturën njerëzore. Të paktën kështu do të duhej të jetë. Por, sipas sociologjisë, arti përcaktohet si një nga veprimtaritë kulturore universale e cila është e pranishme në të gjitha segmentet e jetës shoqërore, në të gjitha shoqëritë, kulturat dhe civilizimet.

Tërë shoqëria njerëzore, që nga vizatimet dhe pikturat e shpellave deri në ditët e sotme, është e përfshirë nga një vello arti që gjatë historisë ka pasur funksione, stile, ide dhe manifestime të ndryshme. Kështu që ne e kuptojmë se në përgjithësi nuk mund të flasim për një lëvizje artistike, periudhë, stil, performancë apo të ngjashme, por duhet të flasim për një nivel të përgjithshëm të praktikave të ndryshme artistike, ndonëse shpesh të kundërta njëra me tjetrën, por kur bashkërendohen ato e begatojnë multikulturalizmin, dhe e bëjnë më domethënës dhe më kuptimplotë ndërkulturalizmin.

Në mungesë të një shtetit që nuk e ka mbështetur dhe nuk e mbështet institucionalisht aq sa duhet, dhe ashtu siç duhet diversitetin në shoqërinë tonë, ne do të mjaftohemi në këtë rast që të marrim si shembull konkret tentativat individuale të personaliteteve të kësaj fushe artistike. Nga tërë ato personalitete të shquara artistike ne kemi zgjedh një piktor i cili vjen nga një mjedis specifik, në krijimtarinë e të cilit mund të identifikohen sekuenca artistike me elemente vizuale multikulturale. Fjala është për piktorin maqedonas, Vangell Koxhman (1904 - 1994), i lindur në qytetin e Strugës, ku edhe ka kaluar një pjesë të jetës së tij dhe ka realizuar një pjesë të karrierës profesionale.

Mbase vetvetiu mund të shtrohet pyetja, pse si shembull kemi marrë vetëm këtë piktor, vallë nuk ka të tjerë, apo për më shumë, pse mungon së paku edhe një artist shqiptarë me të cilin do të mund të tërhiqeshin paralele ndërkulturore me piktorin Vangell Koxhoman!? Përgjigja është e thjeshtë, se nuk ka artist të tillë, as maqedonas dhe as shqiptarë, të cilët kanë lënë një opus artistik, ku mund të gjenim elemente të kulturave të ndryshme gjë që mund të ishte objekt interesi i ndërkulturalizmit. Edhe pse duhet theksuar se tradita ndërkulturor në artet figurative është e hershme për çka flasin veprat e krijuesve shqiptarë dhe të artistëve të huaj, që u prezantua si kumtesë në këtë Konferencën e II - të që u mbajt në vitin 2019. Në këtë kumtesë janë përfshirë artist të ndryshëm të cilët, dikur dhe sot, kanë lënë vepra me vlerë estetike dhe dokumentare, duke zënë kështu vend (Pollozhani, 2019 f...) si shembuj konkret të ndërveprimit kulturor në historinë e artit. Vetëm do të përmendim

emrat e disa krijuesve: Andrea Aleksi, Onufri, Omer Kaleshi, Eduard Lir, Paja Jovanoviq, Tome Serafimovski, Zhaneta Vangeli, Tome Axhievski, etj., të cilët nëpërmjet veprave artistike të proveniencave të ndryshme stilistike, ose kanë riprodhuar realitetin e kohës, ose po me anë të projekteve konceptuale pamore kanë problematizuar tema të ndjeshme midis popujve, sidomos të atyre fqinjë.

Kur jemi këtu duhet, rikujtuar se historia e artit na mëson edhe për një piktor anglez i shekullit XIX, dhe ai ka qenë Eduard Lir (Edward Lear) (1812-1888) i cili, gjatë një udhëtimi të tij në Ballkan, ndër të tjera ka vizituar edhe Manastirin, Ohrin dhe Strugën. Rrëfimi i gjallë i këtij udhëtimi është botuar në librin e tij me titull "Ditar i një piktori peizazhist në Shqipëri" (*Journals of a Landscape Painter in Albania*), në Londër 1851, i cili në vitin 2008 është botuar edhe në gjuhën shqipe (Lear, 2008, 3-5). Si ditari, ashtu edhe mjaft prej peizazheve që pikturoi dhe skicat që i bëri gjatë udhëtimit, ofrojnë një dokumentim të saktë topografik të Shqipërisë së mesit të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Në këtë libër i gjejmë edhe akuarelet me objekte sakral, siç janë xhamitë dhe kishat, por nuk mungojnë as edhe imazhet me karakter profan, nga mjedise të ndryshme të pellgut të liqenit të Ohrit.

Shikuar nga kontestit ndërkulturor, Vangell Koxhoman paraqet një rast të veçantë artistik, ndaj dhe u përcaktuam për ta prezantuar krijimtarinë e tij, e cila përbënë një subjekt artistik me interes ndërkulturor si objekt tematik studimi. Meqenëse bëhet fjalë për një emër të rëndësishëm të artit maqedonas, (Величковски, 2009, f. 16) për të dhe krijimtarinë e tij deri më sot janë bërë studime dhe publikime të ndryshme, përfshirë këtu, katalogë ekspozitash, vështrime kritike dhe monografi. Por, megjithatë, studiuesit nuk i janë qasur sa duhet trajtimit të krijimtarisë së tij nga aspekti ndërkulturor. Pra, për të pasqyruar sa më të plotë kontributin artistik të piktorit, Vangell Koxhoman, po i qasemi nga këndtështrime të ndryshme krijimtarisë së tij, dhe se nëpërmjet zbërthimit të një pjese të saj do të tregojmë se teoria e artit përfaqësues, teoria e stilistikës foviste -ekspresive, teoria e konceptit të hapur artistik, teoria institucionale artistike dhe teoria historike mbi artin janë ato që e begatojnë karakterin ndërkulturor botëkuptimit krijues të piktorit, Koxhoman.

Pra, emri dhe vepra e Vangell Koxhoman janë ngulitur thellë në themelet e artit modern maqedonas duke u bërë një nga artistët avangardë të Maqedonisë Veriut. Ai ka qenë ndër artistët e rrallët që në fillim të viteve tridhjetë të shekullit XX, në kushte historike të

pafavorshme, filloi veprimtarinë e tij krijuese. Kontributi personal i Koxhoman në artin figurativ, i mbështetur në përvojave e modernizmit të fillim të shekullit XX, është i konsiderueshëm, (Дамјановска, 1971, f. 4-24) duke u bërë një nga personalitetet rëndësishëm në organizmin edhe të jetës institucionale artistike si para Luftës së Dytë Botërore ashtu edhe gjatë periudhës së komunizmit në Maqedoninë e Veriut (atëherë Republika Socialiste e Maqedonisë si pjesë konstituive e ish- federatës Jugosllave.). Në plani artistik ai ka kaluar një rrugë me transformime stilistike, nga piktura valeristike deri te piktura koloristike – impresioniste, (Величковски, 2009, f. 16) si dhe nga vizatimi “konstruktivist” deri te shenjat foviste – ekspresioniste. Krijimtarisë së tij ai është qasur edhe nga sensacioni i drejtpërdrejtë vizual për të arrit kështu deri te shfaqja figurative e cila më shumë u nënshtrohet vlerave koloristike në pikturë.

Por ajo që duhet theksuar akoma më qartë ka të bëjë me faktin se me vendlindjen e Vangel Koxhomanit lidhet pothuajse një pjesa e konsiderueshme e krijimtarisë që ky piktor e ka lënë si trashëgimi. Meqenëse ai ka jetuar në një mjedis multietnik dhe multikonfesional siç ishte qyteti Strugës, edhe krijimtaria e tij me dozë të artë besnikërie e reflekton realitetin e kohës kur janë realizuar veprat. Në krijimtarinë e pasur figurative, të Vangell Koxhomanit, si segmenti më i rëndësishëm dhe si preokupimin e vazhdueshëm tematik, duhet veçuar opusin e tij të inspiruar nga vendlindja. Struga dhe nënqielli i saj pra bëhet preokupimi kryesor i hulumtimit të tij artistik. Kjo mjaft mirë vërehet sidomos në koleksionin prej 33 veprave (Н. У. Музеј „Д-р Никола Незлобински, 2008, f. 2-11) të formatit të vogël dhe të mesëm, të pikturuara në kryesisht në teknikën e vajit, dhe rrallë ndonjë vepër është realizuar në teknikën e akualetit, në pëlhurë, kartonë, letër, që përbëjnë ekspozitën e përhershme të Galerisë “Koxhoman” e cila është pjesë e muzeut të qytetit të Strugës.

Krijimtaria e piktorit Koxhoman shfaqet mjaft e pasur, si nga aspekti tematik ashtu edhe nga llojshmëria e motiveve, (Peić,1986, f.194 – 209) kur mbi të gjitha dominojnë: figura e njeriut (portreti), pastaj peizazhi vizual me sekuenca reale nga Struga dhe rrethina e saj, (Величковски, 2004, f. 33 - 40) të cilat meqenëse sjellin pamje nga përditshmëria strugave e asaj kohe më shpesh përfundojnë si motiv i zhanër skenave. Peizazhet e tij në thelb sjellin frymën e autorit dhe realitetit të kohës në të cilën jetoi ai. Duke i shikuar disa nga veprat e këtij piktori, do të shohim se kemi të bëjmë me disa

veduta, nëpërmjet të cilave autori sjellë pamje nga rrugicat dhe sheshet të qytetit të Strugës, pothuajse që prej tetë apo nëntë dekadash më parë. Ky qytet asokohe më shumë ka përngjarë në një kasaba të vogël dhe një mjedis gjysmë-urban dhe gjysmë-rural.

Por ajo që bije në sy, duket që autori përdor më shumë gjuhën stilistike foviste – ekspresioniste, ndonëse herë-herë në mënyrë selektive sjellë pamje autentike (reale) nga mjedise të ndryshme të qytezës së Strugës. Meqenëse nuk është i vogël numri i veprave me sekuenca nga vendlindja e tij, ne do të përqendrohemi vetëm te disa prej tyre, të cilat përveç vlerave estetike brenda vetes ngërthejnë edhe informacione domethënëse dokumentare. Meqenëse vlerat estetike u përfshinë deri diku në pjesë e mësipërme të tekstit kur folëm për veçoritë stilistike, në vazhdim do të përqendrohemi tek objekti tematik dhe sekuenca pamore që autori në fjalë i ka sjellë në disa nga veprat që do ti zbërthejmë në vijim.

Nga opusi i gjerë i krijimtarisë së tij, ne veçuan disa nga veprat, disa prej të cilave shfaqen si të veçanta dhe disa edhe si minicikle, përbëjnë bërthamën e krijimtarisë së piktorit, Vangell Koxhoman. Vepra më të përafërta me problematikën që po trajtojmë: “Kulla e Sahatit në Strugë” (1930); “Sokaku i lindjes” (1935); “Pazari i vjetër i drithit” (1940); “Shtëpia e familjes Shanto”, “Çarshia e Strugës” (1937) disa tablo me pamje nga çarshia e Strugës etj. (Н. У. Музеј „Д-р Никола Незлобински, 2008, f. 2-11) Këto vepra të Koxhomanit, por vepra të tjera, element të përbashkët e kanë tematikën e traditës, trashëgimisë arkitektonike (Величковски, 2004, f. 51) dhe përditshmërinë që shprehin frymën e nënqiellit strugan. Pikturat e lartpërmendura ruajnë dëshmi të gjalla realitetin multikulturor vendlindjes së tij, e paraqitur në mënyrë autentike, që në një farë mase e ka shprehur edhe altruizmin e tij prej artisti.

Figurat e pikturuara, të cilat më shumë përkojnë me zhanër-figurat, deri diku përbëjnë tipin e figurave etnografike (Peić, 1986, f. 194 – 209) të njerëzve të zakonshëm të qytetit të paraqitura me veshjet popullore të cilat në një masë të madhe e pasqyrojnë përkatësinë e tyre etnike. Kuptohet, se në këto tablo kompozicionale përplot kolorit, (Дамјановска, 1971, f. 4-24) dominojnë figurat me veshje popullore maqedonase, në veçanti bije në sy prania e gjinisë femërore, por nuk mungojnë as edhe figurave me veshje të përkatësive etnike shqiptare, turke etj. Kur jemi te kostumografia popullore që përmbajnë veprat e piktorit Koxhoman, mund të themi se ato përbëjnë edhe objekt për studime etnologjike. Imazhet e shumta të transponuar në pikturat e tij, ai në një mënyrë tejet të

fuqishme emocionale i përjeton dhe i percepton, duke i ndërlidhur me ambientin, apo edhe me arkitekturën e vjetër qytetare, (Величковски, 2004, f. 51) sokakët e shtrembëta të shtruara me kalldërma, pazari i qytetit, dajlanët e gjerë, ujin e kaltër të lumit dhe liqenit etj.

Një dëshmi në vetë padyshim që paraqet mënyra se si Koxhman, nëpërmjet disa vedutave të tij e ka sjellë arkitekturën e vjetër qytetare të Strugës, (Дамјановска, 1971, f. 4-24) e cila sa mbanë vulën e traditës orientale, akoma më shumë reflekton frymën dhe karakteristikat e arkitekturës së Mediteranit, traditë ndërtimore kjo e cila është mjaftë e pranishme në viset e Ballkanit. Po ashtu përshtypje bëjnë edhe dy pikturat e Koxhmanit, në të cilat ruhet njëra nga dëshmitë e rralla të kaluarës së qytetit buzëdrinas, atë të Kullës së Sahatit (Н. У. Музеј „Д-р Никола Незлобински, 2008, f. 2-11) e cila ka qenë e ngritur te vendi i godinës së sotshëm të Postës. Ke sahati është pikturuar në çift me xhaminë “Mustafa Çelebi” e ndërtuar në fund të shekullit XVI dhe fillimin e shekullit XVII në qytetin e Strugës. Krahas këtyre veprave piktori, Koxhoman ka realizuar edhe piktura tjera në të cilat reflektohet heterogjenia e një mjedisi siç ka qenë dhe është Struga, duke e siguruar kështu epitetin e artisti me proveniencë multikulturore.

### **Përfundimi**

Shumica e objekteve të këtyre motiveve janë shembur dhe sot janë zëvendësuar me arkitekturë moderne dhe bashkëkohore. Dhe pikërisht pikturat e tij, të mbuluara me shtresën e patinës, e cila reflekton vjetërsinë e tyre, marrin theksin dokumentar të korifeut të fundit siç është piktori Vangell Koxhoman të cilat përgjithmonë do të na përkujtojnë arkitekturën e vjetër qytetare, etën në çarshi dhe peizazhet idilike të nënqiellit strugan.

Kjo trashëgimi artistike ruan substancën e bashkëjetesën dhe kohezionin ndërkulturor ndërmjet shqiptarëve, maqedonasve, turqve, romëve, vlllehëve etj. Ndaj dhe, si përfundim del se, artet pamore e kanë ndihmuar mbijetesën e traditës ndërkulturore, kurse, artistët e kanë sprovuar veten në prezantimin e tjetrit pa nguruar se mund të anatemojnë nga publiku i cili ka opinione të ndarë rreth realiteti dhe funksionimit të një mjedisi multikulturor.

Nga ajo që u tha më lart, në fund fare do të konstatojmë se një pjesë e konsiderueshme e krijimtarisë së Vangell Koxhomanit, është një kontribut artistik që shkon në dobi të inkurajimit të

ndërkulturalizmin përballë të cilit qëndron asimilimi kulturor, i cili bashkimin ose shkrirjen e kulturave e konsideron si mundësi për të garantuar kohezionin social dhe demokracinë politike dhe elitarizmin kulturor. Ndonëse, elitarizmi kulturor konsideron se nëpërmjet relativizmit të vlerave, ndërkulturalizmi tenton që të banalizojë cilësitë dhe vlerat e mirëfillta kulturore, qofshin ato me domethënie artistike, apo me mbështetje shkencore, ky i fundit përpiqet që të shmang hegjemoninë e një kulture ndaj një tjetre. Pra pikërisht në këtë edhe qëndron korenspondimi i këtij artisti me fenomenin ndërkuturlizëm.

### Literatura

- Величковски, В., (2004) *100 години од раѓањето* (каталог), Скопје
- Величковски, В., (2009), *Современа македонска уметност*, Скопје
- Дамјановска, Л., (1976), *Вангел Коџоман* (каталог), Скопје
- Lear, E., (2008) *Edward Lear në Shqipëri: Ditar udhëtimesh, 1848-1849*, Tiranë
- Н. У. Музеј „Д-р Никола Незлобински, (2008), *Вангел Коџоман*, Галерија - Струга
- Peić, M., (1986), *Pristup Likovnom djelu*, IX izdanije, Skolska knjiga – Zagreb
- Pollozhani, M., (2019), *“Tradita jonë interkulturore në artet pamore”*, Interkultura, UNT, Shkup

## REPRODUKSIONE



Koxhoman, "Çarshia e Strugës" 2 (1937)



Koxhoman "Kulla e Sahatit në Strugë" (1930)



Koxhoman, "Çarshia e Strugës"



Koxhoman, "Shtëpia e familjes Shanto" (1940)

**Abstract:**

*In this paper, we will present and examine the role of art as a social activity from the perspective of interculturalism. Taking into consideration the wide range of arts, we have chosen visual art, namely fine art, which is undoubtedly one of the most direct and extremely productive promoters in the cultivation and promotion of multicultural values. We do not intend to comprehensively analyze the attempts to define art, nor to propose any new definition of art in relation to interculturalism. But our attention will be focused on the experience of a painter, who (unconsciously) presents a typical example of the function of art in the enrichment of interculturalism. The painter in question is the Macedonian painter, Vangell Kodjoman, who coming from a multiethnic and multiconfessional city, he has reflected that multicultural prosperity in most of his creative opus. Through his creativity we will show that the theory of representative art, the theory of artistic stylistics, the theory of open artistic concept, institutional artistic theory and historical artistic theory are what identify the intercultural character of the creative worldview of the painter, Kodjoman. Painted images and figures, which more closely coincide with the genre-figures, to some extent constitute the type of ethnographic figures of ordinary people of the city presented in folk costumes which largely reflect their ethnicity. Referring to the literature dedicated to his creativity, as well as analyzing some of the works that bring multicultural images and sequences, with aesthetic values and historical-narrative stamp of the documentary, we will highlight the intercultural role of the painter Kodjoman.*




*Keywords: art, visualization, landscape, veduta, multicultural, interculture*

**Abstrakti:**

*Në këtë punim, do të paraqesim dhe do të shqyrtojmë rolin e artit si veprimtari shoqërore nga këndvështrimi i interkulturalizmit. Nga tërë ajo gamë aq e gjerë artesh ne kemi zgjedhur artin pamor, përkatësisht artin figurativ, i cili padyshim që është një ndër promotorët tejet të drejtpërdrejtë dhe mjaft produktiv në kultivimit dhe promovimit e vlerave multikulturore. Nuk kemi ndërmend të analizojmë në mënyrë gjithëpërfshirëse përpjekjet për të përcaktuar artin, as të propozojmë ndonjë përkufizim të ri të artit në raport me interkulturalizmin. Por vëmendje jonë do të përqendrohet te përvoja e një piktori, i cili me*

mënyrë të (pa)vetëdijshme paraqet një shembull tipik funksionit të artit në begatimin e interkulturalizmit. Bëhet fjalë për piktorin maqedonas, Vangell Koxhoman, i cili duke qenë me prejardhje nga një qytet multietnik dhe multikonfesional, ai atë begati multikulturore e ka pasqyruar në pjesën më të madhe të opusit të tij krijues. Nëpërmjet krijimtarisë së tij do të tregojmë se teoria e artit përfaqësues, teoria e stilistikës artistike, teoria e konceptit të hapur artistik, teoria institucionale artistike dhe teoria historike artistike janë ato që e identifikojnë karakterin interkulturore të botëkuptimit krijues të piktorit, Koxhoman. Imazhet dhe figurat e pikturuara, të cilat më shumë përkojnë me zhanër-figurat, deri diku përbëjnë edhe tipin e figurave etnografike të njerëzve të zakonshëm të qytetit të paraqitura me veshjet popullore të cilat në masë të madhe e pasqyrojnë përkatësinë e tyre etnike. Duke iu referuar literaturës kushtuar krijimtarisë së tij, si dhe duke i zbërthyer disa nga veprat që sjellin imazhe dhe sekuenca multikulturore, me vlera estetike dhe me vlerë historiko-narrative të dokumentares, do ta nxjerrim në pah edhe rolin ndërkulturore të piktorit, Koxhoman.

*Keywords:* arti, vizualizimi, peizazhi, veduta, multikultura, interkultura

Revista <b>INTERKULTURA</b>	Përmbajtja
 <p>INTERKULTURA Koheshkrimi interkultural</p> <p>1</p>	<p><i>Zeqirja NEZIRI - Aspekte ndërkulturore të kancelarisë së Skënderbeut (7-14)</i>  <i>Mustafa IBRAHIMI - Koncepte, dallime dhe konflikte të multikulturalizmit përballë globalizmit (15-28)</i>  <i>Rizvan SULEJMANI- Zgjidhja e konflikteve ndëretnike – rasti i Maqedonisë (29-44)</i>  <i>Avzi MUSTAFA - Kufiri ndërmjet kulturave të ndryshme, vështruar përmes romanit “Ballkanbabilonasit” të Luan Starovës (45-52)</i>  <i>Gjylymsere KASAPI - dallimet dhe ngjashmëritë në kulturat e familjeve maqedonase dhe shqiptare në Maqedoni (53-60)</i>  <i>Sefer TAHIRI - Skicë për mbindërtimin e Maqedonisë shumëkulturore dhe ndërkulturore (61-80)</i>  <i>Rubin ZEMON - Sfidat bashkëkohore në drejtimin e shoqërive të diversitetit (81-92)</i>  <i>Mirjana MALESKA - Multikulturalizmi - koncepti pluralist dhe tolerues për integrim (93-100)</i>  <i>Kosta MILLKOV - I kujt është vendi? Kufizime kulturore dhe territoriale në kontekst të konflikteve ballkanike dhe kriza e refugjatëve në lindjen e mesme (101-113)</i></p>
 <p>INTERKULTURA Koheshkrimi interkultural</p> <p>2</p>	<p>Aziz POLLOZHANI (rektor) – Respekti i ndërsjell – bazament i një kohezioni social në shoqëri – fjalë përshëndetëse  <i>Zeqirja NEZIRI - Pjetër Bogdani afirmues i teozofisë baroke (9-26)</i>  <i>Vebi BEXHETI - Përmasa universale në poezinë e Migjenit (27-32)</i>  <i>Mustafa IBRAHIMI - Elemente etnografike dhe arti shqiptar në muret e kishave të Prilepit dhe Ballkanit nga piktori mesjetar Onufri (33-46)</i>  <i>Sunaj RAIMI - Jan Kukulzeli – kompozitori shqiptar mesjetar me dimensione botërore (47-60)</i>  <i>Avzi MUSTAFA - Grigor Përliçevi dhe kontributi i tij interkulturore (61-72)</i>  <i>Asllan HAMITI - Rëndësia e «Fjalorit tri gjuhësh» të Gjorgji Puleskit (73-88)</i>  <i>Nebi DERVISHI - Kontributi i Josif Bagerit për gjuhën dhe kulturën shqipe në Rekën e Epërme (89-98)</i>  <i>Mixhait POLLOZHANI - Tradita jonë interkulturore në artet pamore (99-112)</i>  <i>Rizvan SULEJMANI - Sa kanë ndikuar dallimet fetare dhe kulturore në formimin e kombit “modular” shqiptar? (113-130)</i></p>
 <p>INTERKULTURA Koheshkrimi interkultural</p> <p>3</p>	<p>Aziz POLLOZHANI (rektor) – Sistemi arsimor faktor i rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie interkulturore – fjalë përshëndetëse  <i>Don Lush GJERGJI, Nëna Tereze - simboli i paqes dhe dashurisë, mishërimi dhe paradigma e interkulturalizmit universal (</i>  <i>Rizvan SULEJMANI, Arsimi interkulturore dhe kultura në kohë Pandemie</i>  <i>Mustafa IBRAHIMI, Reformat gjuhësore në arsimin e shoqërive shumëkulturore - rasti Maqedonia e Veriut</i>  <i>Rubin ZEMON, Historia, antropologjia dhe kompetencat ndërkulturore</i>  <i>Ajten HAJDARI-QAMILI, Iterkulturalizmi në institucionet publike në RMV</i>  <i>Berton SULEJMANI, Interkulturalizmi gjuhësor nëpërmjet frazeologjizmave në gjuhën shqipe dhe maqedonase</i>  <i>Ismet OSMANI, Interkulturalizmi në procesin edukativo-arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut</i>  <i>Sunaj RAIMI, Disa komponentë interkulturore në folklorin e helenëve të lashtë dhe shqiptarëve të sotshëm</i>  <i>Mixhait POLLOZHANI, Arti si veprimtari e kultivimit të interkulturalizmit</i></p>

